

ROLI I POLITIKAVE MAKROFISKALE NË VENDET NË TRANZICION - KOSOVË

Valbona ZEQRARAJ

Dorëzuar në:
Universitetin Europian të Tiranës

Shkollën Doktorale

Në përmbushje të obligimeve të programit për Doktoratë në Shkenca
Ekonomike me profil Financa, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqëse shkencore: Prof. Dr. Flutura KALEMI

Numri i fjalëve: 57397

Tiranë, 2018

FALENDERIME

Falenderoj nga zemra të gjithë ata që me mbështetën dhe me këshilluan gjatë realizimit të kësaj teme të doktoratures. Një falenderim të veçantë i takon udhëheqëses time shkencore Prof. Dr. Flutura Kalem, e cili me ka qëndruar pranë, më ka mbështetur gjatë gjithë punës time, veçanërisht në ditet doktorale e cila ka qenë e gatshme të jap kontributin e saj, që për mua ishte shumë i rëndësisheme.

Një falenderim i veçantë i takon UET-së i cili me mundësoi që të avancohem në aspektin akademik, të pasurohem me dije, që të arrijme të kontribuoj sa do pak me studimin tim në rolin që luajne politikave fiskale në vendët në tranzicion siç është Kosova. Rast i tillë është vendi im i cili ka nevojë ta ndihmojmë të këshillojmë dhe të punojmë në rimekëmbjen dhe zhvillimin sa më të shpejtë ekonomik.

Gjithëashtu dua të falenderoj familjen time për mbështetjen, në veçanti vajzat e mija (Edren dhe Even) të cilat janë arsyeja dhe motivi im për një punë të pa lodhëshme. Gjithashtu falenderoj bashkëshortin i cili me durim e përkushtim më ka kuptuar, nxitur, ndihmuar gjatë punës për përfundimin e kësaj teme.

*Sinqerisht!
Valbona Zeqiraj*

DEKLARATË

Unë, Valbona Zeqiraj deklaroj se e kam shkruar vetë punimin e doktoratës dhe se nuk kam pranuar ndihmën e dikujt tjetër. Çdo fjali apo thëniet e personave të tjerë janë cituar, janë referuar dhe janë paraqitur, në fund të punimit, në pjesën e literaturës dhe bibliografisë.

Punim është origjinal dhe nuk ju është nënshtruar ndonjë komisioni vlerësues në formën e njëjtë dhe është i pa publikuar ndonjëherë.

Data:

Valbona Zeqiraj

Nënshkrimi:

PËRMBAJTJA

I HYRJE.....	7
II FIGURAT	10
III TABELAT	11
IV FJALORI	12
KAPITULLI I	14
1. QËLLIM, PËRMBAJTJA DHE METODAT	14
1.1. Qëllimi i studimit	14
1.2. Formulimi i përmbajtjes së punimit.....	14
1.4. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë	16
1.5. Metodat e analizës	17
1.6. Kufizimet e punimit	19
KAPITULLI II.....	20
2. RISHIKIMI I LITERATURES MBI POLITIKAT FISKALE, OBJEKTIVAT, INSTRUMENTET DHE EFEKTET	20
2.1. KONCEPTE HYRËSE	20
2.2. OBJEKTIVAT E POLITIKËS FISKALE	24
2.2.1. Instrumentet dhe efektet e politikës fiskale	24
2.2.2. Veprimi i politikës fiskale në shtimin ekonomik.....	25
2.2.3. Veprimi i politikës fiskale në punësim dhe nivelin e çmimeve	25
2.2.4. Veprimi i politikës fiskale në rishpërndarjen e të ardhurës dhe pasurisë	30
KAPITULLI III	31
3. TRANZICIONI DHE NDIKIMI I TIJ NË POLITIKAT FISKALE	31
3.1. NDËRTIMI I POLITIKAVE FISKALE NË SHETETET ME EKONOMI NË TRANZICION	31
3.2. STABILITETI POLITIK DHE TRANZICIONI NË BALLKAN	33
3.3. TRANZICIONI, PRIVATIZIMI, LLOJET DHE FORMAT E TIJ	36
3.3.1. Tranzicioni dhe kalimi i ekonomisë së centralizuar në ekonomi tregu	37
3.4. TRANZICIONI NË KOSOVË	37
3.4.1. Kosova – nën administrimin ish-Jugosllavisë	39
3.4.3. Ekonomia në Republikën e Kosovës, sot.....	40
3.5. ZHVILLIMET DHE PARASHIKIMET E EKONOMISË SË KOSOVËS	41
3.5.1. Mjedisi i jashtëm ekonomik.....	43
3.5.2. Pasqyra makroekonomike në Kosovë.....	45
3.5.3. Parashikimet makroekonomike në sektorin e jashtëm.....	Error! Bookmark not defined.
KAPITULLI IV.....	52
4. POLITIKAT FISKALE – ASPEKTI MAKROEKONOMIK	52
4.1. ASPEKTI MAKROEKONOMIK I TEORIVE NË POLITIKAT FISKALE	52
4.1.1. Llojet dhe teoritë e politikave fiskale	53
4.1.2. Politika fiskale – praktika dhe arsyshmerija	54
4.1.3. Teoritë më të rëndësishme të mbledhjes së tatimeve në politikën fiskale	55
4.1.4. Sistemet e politikave fiskale në ndarjen e tatimeve	57
4.2. PROBLEMI I ZGJEDHJES SË OBLIGUESIT TATIMOR	61
4.2.1. Metodat e përcaktimit të bazës tatimore	62
4.2.2. Parimet e tatimit dhe evolucioni i tyre në shtetet bashkëkohore	63
4.3. QËLLIMET, MASAT DHE EFEKTET TATIMORE	68

4.3.1. Transferimi ose kompensimi i tatimit.....	70
4.3.2. Efektet e tatimit në akumulim.....	71
4.3.3. Metoda direkte e TVSH-së	74
4.3.4. Efektet e tatimit në aktivitetin ekonomik.....	76
4.4.5. Sistemet tatimore bashkëkohore në ekonominë e tregut	79
4.5. DOGANAT, QËLLIMI DHE EFEKTI NË POLITIKËN FISKALE TË EKONOMISË VENDORE.....	82
KAITULLI V.....	84
5. QËNDRUESHMËRIA E FINANCAVE PUBLIKE DHE SISTEMI TATIMOR NË KOSOVË	84
5.1. QËNDRUESHMËRIA E FINANCAVE PUBLIKE.....	84
5.1.1. Analiza e qëndrueshmërisë së borxhit	85
5.2. SISTEMI TATIMOR NË KOSOVË	86
5.2.1. Tatimi në të ardhurat e korporatave (TAK).....	87
5.2.2. Tatimi në të ardhura personale (TAP)	93
5.2.3. Pagesat e tatimit nga veprimtaritë afariste	97
5.2.4. Pagesat e për të ardhurat nga qiratë	97
5.2.5. Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH).....	98
5.2.6. Shmangia e tatimit të dyfishtë	102
5.2.7. Detyrimet doganore	102
5.2.8. Akciza	103
5.3. TË HYRAT TATIMORE DHE RIMBURSIMET NË KOSOVË.....	106
5.4. PAKETA E RE FISKALE DHE NDIKIMI I SAJ NE EKONOMI.....	109
5.4.1. Efektet e shkallës së reduktuar të TVSH-së.....	113
5.4.2. Efektet e shkallës së rritur të TVSH-së.....	114
5.4.3. Ulja e pragut të regjistrimit.....	117
5.5. NDRYSHIMET TJERA FISKALE NË KOSOVË	118
KAPITULLI VI.....	120
6. POLITIKA FISKALE NË KOSOVË DHE BASHKIMIN EUROPIAN	120
6.1. PERSPEKTIVA DHE STRATEGJIA E POLITIKËS FISKALE NË EKONOMINË E KOSOVËS.....	120
6.2. TRENDET NË EUROZONA.....	130
6.3. TRENDET E PËRGJITHËSHME EKONOMIKE, KOSOVA DHE RAJONI	135
6.4. KARAKTERISTIKAT E SISTEMIT BANKAR BALLKANIK	137
6.4.1. Bruto Produkti Vendor në Kosovë.....	137
6.4.2. Qasja e prodhimit.....	140
6.5. RREGULLAT DHE PROCEDURAT E STRUKTURA BUXHETORE	144
6.5.1. Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.....	146
6.6. PËRSPEKTIVA DHE STRATEGJIA E POLITIKËS FISKALE NË UNIONIN EVROPIAN	147
6.6.1. TVSH-ja dhe roli i saj në UE.....	149
KAPITULLI VII.....	153
7. ANALIZA E NDIKIMIT TË POLITIKËS FISKALE NË EKONOMIN E KOSOVËS	153
7.1. VARIABLAT E PERDORURA NË STUDIM	153
7.1.2. Të dhënat e grumbulluara dhe perpunimi i tyre.....	154
7.1.3. Analiza regresive multivariable	154

7.1.4. Analiza e regresion - kuantil.....	156
7.1.5. Rast studimor i kontrollit tatimor dhe ndikimit ne efkasitet	156
7.1.6. Përpunimi i të dhënave me EVIEWS 7	156
7.2. HULUMTIMI MBI NDIKIMIN E POLITIKESE FISKALE NË BIZNESE	160
7.3.1. Të dhënat bazë nga hulumtimi.....	161
7.3. RRITJA E PAGAVE NE SEKTORIN PUBLIK DHE RRITJA E INFLACIONIT NE EKONOMINE KOSOVARE.	165
KAPITULLI VIII	172
8. DISKUTIME, PERFUNDIME DHE REKOMANDIME	172
8.1. DISKUTIM MBI GJETJET KRYESORE DHE KONKLuzionET	172
8.2. PËRFUNDIME.....	173
8.3. KONKLuzIONE.....	176
8.4. REKOMANDIMET.....	177
BIBLIOGRAFIA	179
1. Literatura Bazë.....	179
2. Publikime shkencore dhe raporte.....	180
3. Webfaqe dhe burime tjera.....	Error! Bookmark not defined.
ANEKSI 1:.....	183
ANALIZA E NDJESHMËRISË SË TË HYRAVE TATIMORE DHE E BORXHIT PUBLIK	183
1. Analiza e ndjeshmërisë së të hyrave tatimore.....	183
2. Analiza e qëndrueshmërisë së borxhit publik	185
ANEKSI 2	189
PYETSOR-ROLI DHE NDIKIMI I POLITIKAVE FISKALE TEK BIZNESET	189

I HYRJE

Roli i politikave makrofiskale në vëndet ne tranzicion dhe Kosove, është tema e cila une kam trajtuar në këtë punimin të doktoraturës dhe këtu jam përpjekur që të kontriboj në ndërlidhjen dhe pasqyrimin e qartë të ndikimit të tranzicionit në ndertimin e politikave fiskale në përgjithësi dhe në vecanti në ndertimin e politikave fiskale ne Kosovë.

Roli i politikës fiskale në rritjen ekonomike, ka nxitur shumë studime, si në aspektin teorik dhe atë empirik. Literatura bashkëkohore makroekonomike vë në dukje si objektivat afatshkurtër, ashtu dhe ato afatgjatë të politikave fiskale [Romer, (2006)]. Në periudhën afatshkurtër, politika fiskale mund të përdoret për të kontrolluar ciklin e prodhimit ose për të stabilizuar luhatshmërinë në treguesit makroekonomike, çka është e njëjtë me ndikimin afatshkurtër të politikës monetare. Po ashtu, për periudhën afatgjatë, politika fiskale dhe mënyrat e financimit të borxhit mund të ndikojnë gjithashtu kërkesën dhe ofertën agregate të ekonomisë. Diskutimi që lidhet me ndikimet e politikës fiskale në rritjen ekonomike është mjaft aktual, pasi zhvillimi i instrumenteve të duhur fiskalë mund të çojë në rritje ekonomike të vazhdueshme dhe të qëndrueshme

Gjatë gjithë punës sime kërkimore kam hasur në segmente të caktuara që e definojnë shumë qartë pozicionin e politikave fiskale dhe ndikimin e tyre në gjithë procesin jo vetem ekonomik dhe financiar të një vendi. Në Kosovë politikat fiskale janë rindertuar pas luftes çlirimtare te vitit 1999, pasi politikat e mëparshme ishin diskriminuese dhe të pa përshtashme jo vetëm për zhvillim dhe qëndrueshmeri ekonomike por tërsisht diskriminuese dhe me tendence shkaterruese për ekonomine e vendit.

Në kuadër të zhvillimit ekonomik të një vendi ndikim të madh në zhvillimin e forcave prodhuese dhe te kapaciteteve ekonomike në përgjithsi kanë edhe politikat fiskale që aplikojnë qeveritë e tij. Kur jemi te politikat fiskale, duhet pasur parasysh efektin dhe konsekuencat që mund të kenë llojet dhe normat e tatimeve, doganave, akcizat dhe taksave tjera në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, si dhe në akumulimin e mjeteve për investime të mëtejshme kapitale në vend. Politikat e mirëfillta fiskale do të mundësonin një zhvillim më të shpejte dhe me prosperuese drejt zhvillimit të vendit.

Duke e parë rendësinë e mbledhjes se tatimeve dhe efektet e tyre ne ekonomine e vendit kam hulumtuar me gjerësisht efektet e TVSH-se si nje nga tatimet qe ndikojen ne mbushjen e arkes se shtetit. Politika fiskale- objektivat, instrumentet dhe efektet është pjesa teorike e trajtimit dhe pershkrimi i literatures duke u munduar të argumentoj në të gjeturat

e mia gjatë studimit. Trajtimi i politikës fiskale si teori, si koncept, si mekanizem që funksionon, si dhe rolin dhe ndikimin e shtetit në të është një kënd tjetër që është trajtuar në punim. Politikat fiskale- aspekti makroekonomi është kapitull që ka një trajtim më të gjerë dhe kyc në këtë temë.

Formulimi i politikës fiskale kryesishtë bazohet nga instrumentet politike që percaktojnë subjektet politik qeverisëse në raste të fitores në zgjedhje. Pra shikuar nga aspekti praktik politika fiskale është mekanizem i realizimit të objektivave me qëllim të permbushjes së detyrimeve fiskale dhe nevojave publike. Përdorimi i instrumenteve të politikës fiskale nuk bazohet vetëm në rrjedhat afateshuktra por edhe në peridhat afategjata që kryeshite orjentohe në të ardhurat për kapita, ku edhe percaktohet apo thënë me mire orjentohet norma zhvillimore si synim baze i çdo qeverisje.

Tranzicioni dhe ndikimi i tij në politikat fiskale është trajtur gjerësisht me të gjithë faktorët që ndikojnë në të duke përfshirë këtu edhe procesin e privatizimit në gjithë vendet në tranzicion e deri të forma e privatizimit të shërbimeve në vendet kapitaliste.

Politikat ekonomike dhe pluralizmi ekonomik - është një provokim imi intelektual andaj mendoj se mund të shërbejë si një pjesë e nderlidhur për të qënë bazë për ndonjë studim në të. Këtu kam trajtuar këtë temë por që ka një kuptim dhe një domethënje shumë të madhe për procesin e transformimit dhe integritet të vendeve në tranzicion e vecmas të Kosovës në organizmat relevant ndërkombetare të ekonomisë, biznesit sigurisë dhe politikës.

Në fund kam paraqitur perspektivat dhe strategjinë e politikave fiskale në ekonominë e Kosovës dhe alternativat për një efikasitet dhe stabilitet makroekonomik.

Perspektiva dhe strategjia e politikave fiskale në Kosovë dhe Bashkimin Europian është kapitull përmbylles shkencorë ku janë të trajtuara orjentimet përmbajtësore të prespektives ekonomike dhe sociale të vendit ton drejtë synimeve integruise rajonale dhe globale. Kam përshkruar edhe strategjinë që e përdor unioni europjanë në këtë fushë me qëllim që të kem në funksion metoden e krahasimit dhe të kem një pasqyre realiste se si dhe çka duhet të bëhet që të kam vërtetë një prespektiv europjane të ekonomisë sonë në planë të parë që ti japim përgjigjë se: Çfarë politikash fiskale duhet të ndërtojmë që të jem në hap me BE-në dhe vendet tjera të interesit tonë nacional. Përfundimi, konkluzionet dhe literatura janë faza përmbyllëse e këtij punimi që mendoj se është një kontribut i vogël imi në këtë fushë.

“Politikat fiskale në vendet e tranzicionit dhe Kosova” është temë e trajtuar në disa dimensione dhe ka argumente të bollshme në këndëveshtimin e financave dhe strategjise se tyre në hartimin e politikave fiskale. Vendet në tranzicion, tranzicionin si koncept dhe ndikimin e tij në politikat fiskale është shtylla tjetër që unë kam dizajnuar në këtë temë ku kam përshkruar edhe faktoret dhe ecurite e kësaj sfere, duke e sqaruar edhe privatizimin si një prej çështjeve kryesore të kalimit nga koncepti shoqëror e ekonomine e tregut dhe kalimi i përgjegjshis dhe prones nga shoqëria tek individit.

Deficitit buxhetor dhe potencialet për mbulimi i tij janë sfida direkte të qeverisjese dhe si të tilla duhat pasur parasyshe që ndikojë në rritjen e inflacionit e që ky i fundit ndikon negativisht në rritjen e ekonomisë vendore.

Duke u bazuar në teorin shkencore ku politika fiskale ekspozohet si ekspansionise ajo mund të ndërtohet edhe politik fiskale shternguese. Pra sheti mund ti ule normen e taksave dhe të ngrite nivelin e shpenzimeve publike, duke e pasur si orjentim shtimin e konsumit dhe si rrejdhoje logjike kemi edhe kërkesë agregate të rritur.

Po ashtu pas hulumtimeve të bera mund të konkludojme se: tri segmente kyçe duke filluar nga aspekti makroekonomik i teorive në politikat fiskale, teoritë më të rëndësishëme të mbledhjes së tatimeve në politikën fiskale, sistemet e politikave fiskale në ndarjen e tatimeve, prblemi i zgjedhjes së obliguesit tatimorë në sistemet tatimore bashkëkohore, janψ fushat që Qeveria duhet te nderhujë dhe te jap nje zgjidhje me te pranusheme e ma pductive, posaqerishte ne sigurimin e nje ambiekti te te berit biznese dhe kalimin e te hyrave kyqe nga doganat ne te hgyrat vendore.

II FIGURAT

Figura 1. Mbyllja e hendekut të ekspansionit	26
Figura 2. Mbyllja e hendekut të recesionit	27
Figura 3. BVP në rajonin e Europese Juglindore.....	29
Figura 4. Të hyrat nga shkalla standarde e TVSH-së	33
Figura 5. Paraqitja grafike e të hyrat e ATK-së, gjithne duke u bazuar ne ndy.....	40
Figura 6. Rritja e Bruto Prodhimit Vendor	44
Figura 7. Rritja reale e BPV.....	46
Figura 8. Inflacioni dhe parashikimet	49
Figura 9. Ndelidhja e exportit te mallrave me kerkesat globale	Error! Bookmark not defined.
Figura 10. Komponentet e bilancit ne raport me BPV	Error! Bookmark not defined.
Figura 11. Trendit lineare për remitanca në Kosovë 2008-2013	125
Figura 12. Paraqitja grafike e IHD në Kosovë 2008-2013	126
Figura 13. IHD në Kosove 2008-2013.....	128
Figura 14. BPV-së, nga 1.9 sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.	134
Figura 15. Shkalla mesatare e inflacionit në Ballkanin Perendimor.....	136
Figura 16. Norma reale e rritjes së BPV-së	138
Figura 17. Struktura e komponentëve të BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve	140
Figura 18. Komponentët e BPV-së, sipas aktivitetit ekonomik, në miliard euro	141
Figura 19. Testi i normalitetit për modelin e parë	159
Figura 20. Cila është pozita në kompaninë ku punoni?.....	164
Figura 21. Shkalla e arsimimit.....	165
Figura 22. A besoni se një menaxhim i mirë i resurseve njerëzore	162
Figura 23. A mendoni se Kosova ka një menaxhim adekuat të duhur të politikave fiskale?.....	163
Figura 24 Roli pozitiv apo negativ misionet e BE-së në Kosovë	164
Figura 25. Si ka ndikuar mireqeverisja në menaxhime e politikave fiskale ne biznese? ...	165

III TABELAT

Tabela 1. Rritja e BPV-së dhe Inflacioni	45
Tabela 2. Normat e tatimit Tatimi	93
Tabela 3. Mbajtja e tatimit në burim në paga dhe pensione	96
Tabela 5. Trendet hyrese të ATK-se gjatë periudhës së analizuar	105
Tabela 6. Të hyrat tatimore dhe rimbursimet gjatë vitit 2010	106
Tabela 7. Të hyrat tatimore dhe rimbursimet gjatë vitit 2011	107
Tabela 8. Të hyrat tatimore dhe rimbursimet gjatë vitit 2012	107
Tabela 9. Të hyrat tatimore dhe rimbursimet gjatë vitit 2013	108
Tabela 10. Të hyrat tatimore dhe rimbursimet gjatë vitit 2014	108
Tabela 11. Numri I biznresen me TVSH para dhe pas Reformës fiskale	110
Tabela 12. Të hyrat nga shkalla standarde e TVSH-së, para dhe pas ndryshimeve	114
Tabela 13. Të hyrat nga ATK	115
Tabela 14. Lirimet nga TVSH nga Dogana e Kosovës janar-gusht 2016.....	116
Tabela 15. Analiza e trendit lineare për remitanca në Kosovë 2008-2013	123
Tabela 16. Investimet e Huaja Direkte në Kosovë 2008-2013	126
Tabela 17. Ndryshimi i IHD në Kosovë 2008-2013	127
Tabela 18. Trendi Linear IHD në Kosovë 2008-2013	127
Tabela 19. Paraqitja grafike e trendit për IHD në Kosovë 2008-2013	128
Tabela 20. Rritja reale vjetore e BPV-së	131
Tabela 21. Rritja reale vjetore e BPV-së në vendet e Ballkanit Perëndimor	135
Tabela 23. Treguesit kryesor makroekonomik në Kosovë	143
Tabela 24. Rezultatet e analizës së regresionit për modelin të parë	158
Tabela 27. Ndikimi i menaxhimit në politika fiskale	161
Tabela 28. Kosova me politikën fiskale	162
Tabela 29. Roli i BE-së në Kosovë në menaxhimit të politikave fiskale?.....	163
Tabela 30. A i shton vlerë biznesit sistemi i qeverisjes së kompanisë dhe harmonizimi i politikave fiskale	164

IV FJALORI

Fjalori dhe Akronimet

Akronimi	Emri zyrtarë i akronimit
AKK	Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit
AKP	Agjencia Kosovare e Pronave
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKP	Agjencia Kosovare e Pronave
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
ARRE	Asociacioni Regjional i Rregullatorëve të Energjisë
ART	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BK	Buxheti i Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BSL	Ndërtimi i Burgut të Sigurisë së Lartë
EPK	Ekipet Përgatitore Komunale
EU	Unioni Evropian
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HVK	Të Hyrat Vetanake të Komunave
ICO	Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IPA	Koordinimi i Programit të Asistencës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KKK	Komisioni Kosovar i Konkurrencës
KNJ	Komisioni për Ndihmë Juridike
KPM	Komisioni i Pavarur për Media
KPMM	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve
KREE	Këshilli i Rregullatorit të Energjisë Evropiane
LFPL	Ligji i Financave të Pushtetit Lokal
LMFPP	Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MF	Ministria e Financave
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MI	Ministria e Infrastrukturës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme

MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NSH	Ndërmarrjet Shoqërore
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PF	Politikat financiare
PIP	Programi për Investime Publike
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritetin Evropian
QIF	Qendra e Inteligjencës Financiare
RGJM	Rishikimi gjashtëmuor i Buxhetit
SFQ	Statistikat Financiare të Qeverisë
SZHMB	Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit
TI	Teknologjia Informative
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UP	Universiteti i Prishtinës
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

KAPITULLI I

1. QËLLIM, PËRMBAJTJA DHE METODAT

1.1. Qëllimi i studimit

Ky desertacion si qëllim parësor ka pasqyrimin e sistemit fiskal duke paraqitur një pasqyrë reale mbi politikat fiskale dhe ne veçanti ecurine e të hyrave dhe shpenzimeve publike në buxhet. Ndër objektivat kryesore të këtij punimi janë:

1. Pasqyrimi i politikave fiskale ne vendet ne tranzicion ne aspektin makroekonomik dhe analiza e ndikimit të tyre ne ekonominë vendore.
2. Hartimi i politikave fiskale dhe zhvillimi transformues i tatimeve ne Kosove. Specifikat, pengesat krahasimi me vendet e rajonit dhe sygjerimet ne këtë proces.
3. Perspektiva dhe strategjia e politikave fiskale të Kosoves per t'u integruar ne BE.
4. Analiza e shpenzimeve buxhetore sipas kategorive buxhetore dhe projeksioni i të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore.

Ne desertacioni me teme “Roli i politikave makrofiskale në vendet ne tranzicion dhe Kosova” shqyrtohet në mënyrë të detajuar kuptimi dhe karakteristikat e tatimeve, studimi i sistemit fiskal dhe i instrumenteve fiskale, kuptimi, karakteristikat dhe funksioni i buxhetit, studimi i ecurisë së të hyrave buxhetore, analizimi i shpenzimeve buxhetore sipas kategorive buxhetore dhe projeksioni i të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore.

1.2. Formulimi i përmbajtjes së punimit

Punimi “Roli i politikave makrofiskale në vendet në tranzicion - Kosovë”, është i ndarë në gjashtë kapituj dhe në secilin prej tyre ka baza të forta bibliografike dhe të dhëna të bollshme si nga literatura ashtu edhe nga pervoja personale, Tema është e ndarë në këto fusha specifike:

Politika fiskale, objektivat, instrumentet dhe efektet - është pjesa teorike e trajtimit të temes.

Trajtimi i politikës fiskale si teori, koncept, mekanizem që funksionon, menyra si funksionon si dhe roli e ndikimi i shtetit në të.

Punimit i kam shtuar edhe dimensionin tjetër duke përfshirë një strukturë relativisht të zgjeruar të procesit të privatizimit si fazë që ndikon drejtpërdrejt në transformimin e pronës dhe kapitalit nga centralizmi në ekonominë e hapur, nga pronësia e shtetit (shoqërisë) në pronësinë private.

Politikat fiskale - aspekti makroekonomik - është kapitull që ka një trajtim më të gjerë dhe kyç në këtë temë, ku kam ofruar argumente të ndërtimit të një politike fiskale të bazuar në koncepte moderne që kryesisht është e bazuar në politikat e vendeve të zhvilluara dhe BE-së.

Secili vend veç e veç paraqet objektivat që synon të realizojë me aplikimin e instrumenteve të politikës fiskale. Pra, kur flasim për objektivat e politikës fiskale kemi parasysh:

- ✓ Përbushjen e nevojave publike përmes një sistemi të shëndoshë të financimit publik
- ✓ Realizimin e punësimit të plotë
- ✓ Rritjen e normës së shtimit ekonomik
- ✓ Ruajtjen e stabilitetit të çmimeve
- ✓ Stabilitetin e bilancit të pagesave
- ✓ Përmirësimin e kushteve të punës duke përfshirë përmirësimin e strukturës kualifikuese të fuqisë punëtore dhe përparimin teknologjik
- ✓ Stimulimin e kursimeve
- ✓ Stimulimin e investimeve
- ✓ Rritjen e aftësisë konkurruese të produkteve dhe shërbimeve vendore
- ✓ Rritjen e cilësisë së shërbimeve në arsim dhe shëndetësi.

Tranzicioni dhe ndikimi i tij në politikat fiskale është trajtur gjerë dhe gjatë me të gjithë faktorët që ndikojnë në të, duke përfshirë këtu edhe procesin e privatizimit në gjithë vendet në tranzicion e deri të forma e privatizimit të shërbimeve në vendet kapitaliste.

Pluralizmi dhe politikat ekonomike - është një provokim imi intelektual prandaj mendova se mund të shërbejë si një kapitull i nderlidhur për të qënë bazë për ndonjë studim të ardhshëm

ku në mënyre të shkurtuar kam trajtuar këtë temë por që ka një kuptim dhe një domethenie shumë të madhe për procesin e transformimit dhe integritet të vendeve në tranzicion e vecmas të Kosovës në organizmat relevant ndërkombetare të ekonomisë, biznesit sigurisë dhe politikës.

Në fund kam paraqitur perspektivën dhe strategjinë e politikave fiskale në ekonominë e Kosovës dhe alternativat për një efikasitet dhe stabilitet makroekonomik.

Perspektiva dhe strategjia e politikave fiskale në Kosovë dhe Bashkimin Europian është kapitull përmblyës shkencor ku janë të trajtuara orientimet përmbajtësore të prespektivës ekonomike dhe sociale të vendit tone drejt synimeve integruese rajonale dhe globale.

Kam përshkruar edhe strategjinë që përdor unioni europjan në këtë fushë, më qëllim që të kem në funksion metoden e krahasimit dhe të kem një pasqyre realiste se si dhe çfarë duhet të bëhet që të kemi vërtet një prespektive europiane të ekonomisë sonë duke i dhënë përgjigje pyetjes se: Çfarë politikash fiskale duhet të ndërtojme që të jemi në një hap më BE-në dhe vendet e tjera të interesit tone nacional.

Përfundimi, konkluzionet dhe literatura janë faza përmblyëse e këtij punimi që mendoj se është një kontribut modest në këtë fushë.

1.3. Propozimi i metodologjisë së hulumtimit

Materiali

Në këtë punim unë kam shfrytëzuar si materiale bazë të dhënat e nxjerrera nga Institucionet kompetente e vecanerisht sa i përket politikave fiskale të dhënat që janë zyrtare nga MEF, nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe nga ESK. Gjithashtu në kapitujt tjerë unë kam aplikuar material fizik që ka të bëjë me procesin e privatizimit dhe të tranzicionit ku në bashkëpunim të ngushtë me AKM në Kosovë dhe me ASHP në Shqipëri kam pasqyren e qartë se si dhe çfarë do të bëhet. Buletinet dhe raportet e kompetentëve ekonomik të Europës Juglindore, janë të tjera materiale të përdorura në punim.

1.4. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë

Me qëllim të argumentimit dhe verifikimit të çështjeve të ngritura gjatë këtij disertacioni, kam parashtruar tre hipoteza duke parashtruar tërë pyetje kërkimore me qëllim të

verifikomit të tyre. Andaj mund të konstatoj se ka ndikim real, menaxhimi i drejte dhe harmonizimi i politikave fiskale në vendet në tranzicion dhe zhvillimin ekonomik.

Pyetjet:

P1. Cilat janë objektivat e politikës fiskale që po ndjek Qeveria e Kosovës?

P3. Çfarë politikash fiskale duhet të ndërtojme që të jemi në hap me BE-në dhe vendet tjera të interesit tonë nacional?

P4. Si reflekton pako aktuale e parapagimit të tatimit mbi vlerën e shtuar për bizneset?

P5. Çfarë orientimi duhet t’u japim politikave fiskale, me qëllim të tërheqjes së investimeve të huaja dhe njëkohësisht rritjes së punësimit?

P6. Politikatat tatimore në Kosove, a janë të drejta dhe si ndikon tek bizneset?

P7. Si dhe sa ndikon parapagimi i detyrimeve tatimore (TVSH, TF) para inkasimit të të hyrave nga transaksionet biznesore?

P8. A ndikon rritja e pagave në sektorin publik në rritjen e çmimeve dhe inflacionin?

Hipotezat:

H1: Harmonizimi i politikave fiskale të Kosovës me ato të BE do sjell rritjen e të ardhurave tatimore.

H2: Hartimi i politikave fiskale të konsoliduara do rrisë rolin e sektorit publik në ekonomine e Kosovës.

H3: Rritja e pagave në sektorin publik do ndikojë në rritjen e inflacionit në ekonomine kosovare.

1.5. Metodatat e analizës

Gjatë punës sime kërkimore domosdoshmerisht kam shfrytëzuar metodatat e analizës por edhe të sintezës pasi kam të bëjë në një pjesë të punimit edhe më procesin e tranzicionit dhe të privatizimit ku duhet të kalojmë nga individualja në të përgjithshmen. Metodatat kryesore të analizës që kam aplikuar janë: analiza logjike, analiza statistikore, metoda e mostres dhe të dhënat e publikuara në monografi të këtyre fushave nga institucionet relevante.

Metodatat e hulumtimit

Për të arritur qëllimet e synuara në këtë punim, ka qenë e domosdoshme aplikimi i disa metodave. Gjithashtu, për të qartësuar më tutje qasjen ndaj këtij procesi të hulumtimit, është

shfrytëzuar përvoja e gjatë personale në financa dhe kontabilitet, që ndërlidhet me njohuritë e duhura lidhur me këtë problematikë. Gjatë punimit të këtij studimi janë përdorur metodologji bashkëkohore shkencore dhe metodat e analizës kuantitative.

Metodologjia dhe metodat e përdorura janë:

1. Deduksioni - kjo metodë na mundëson që të arrijmë synimet e hulumtimit, duke filluar nga e përgjithshmja dhe duke arritur cakun e synuar, pra të veçantën. Në këtë rast është studiuar dhe është analizuar funksionimi i tatimit mbi vlerën e shtuar, i cili aplikohet në shumicën e shteteve të botës, në përgjithësi, dhe si fokus i veçantë ka qenë analiza e politikave fiskale në Kosovë dhe në regjion. Gjithashtu është analizuar më kujdes ndikimi i tyre në sektoret e ekonomisë, posaçërisht në sektorin publik. Rritja e pagave në sektorin publik mendoj se do të ndikojë në rritjen e inflacionit në ekonomine kosovare andaj duke marr për bazë studimin kam konstatuar se ka ndikim në këtë fushë.

2. Deskriptive – këtu janë mbledhur materiale dhe raporte të ndryshme, që janë marrë me studimin e tatimeve në përgjithësi e në veçanti me tatimin mbi vlerën e shtuar në Kosovë. Në këtë rast është përdorur literature nga autorë të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm, raporte, studime nga agjenci të ndryshme dhe hulumtime të publikuara nga organizma që merren me studime të kësaj sfere. Hartimi i këtij studimi është mbështetur në sa vijon:

Në shfrytëzimin e të dhënave të publikimeve vendore, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Këshillit Ekonomiko-Fiskal, Bankës Qendrore të Kosovës, Njësisë Makroekonomike të MEF-it dhe Agjencisë Statistikor të Kosovës, dhe Institucioneve të specializuara në këtë fushë. Për paraqitjen e të dhënave të jashtme janë shfrytëzuar burimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, të Bankës Botërore, të Institucioneve të Jashtme Shkencore dhe burime të tjera.

3. Analiza komparative - materialet e përdorura në këtë punim janë analizuar si dhe janë krahasuar njëri me tjetrin me qëllim që të jemi sa më objektiv në hulumtimin e bërë.

4. Modeli ekonometrik-është përdorur për testimin e faktorëve që e afektojnë GDP-në në Republikën e Kosovës. Më konkretisht, në këtë punim kemi analizuar se si TVSH-ja, akciza dhe doganat e afektojnë GDP-në. Si variabël endogjen është definuar GDP-ja, kurse si variabla ekzogjene janë definuar TVSH-ja, akciza dhe dogana.

1.6. Kufizimet e punimit

Jam e vetëdijshme se në një punim doktoral nuk mund të përshkruhen në përgjithësi të gjitha elementet që kanë të bëjnë me politikën fiskale të një vendi si dhe aspektet makro-fiskale. Por unë jam munduar që të paraqes një gjendje reale të këtyre politikave e veçanërisht me ndryshimet e shumta dhe thelbësore që kanë ndodhur në Kosovë. Ndërkufizimet me thelbësore lidhur me këtë punim doktoral mund të rëndisim: Punimi është i kufizuar në rolin e politikës fiskale në vendet në tranzicion ndërsa Kosova është marrë si shembull krahasues dhe analizuar në periudhën 2009-2015, edhe pse ka përshkrime dhe krahasime kryesisht jam ndalur në Kosovë. Është evident fakti se të dhënat në Kosovë por edhe shkalla e zhvillimit ekonomik është dukshëm më e ngadaltë se sa vendet tjera të rajonit. Edhe pse kam përshkruar rolin e bizneseve në politikën fiskale si dhe aspektet makroekonomike nuk mund të konstatojmë me saktësi se a janë relevante numri i bizneseve të anketuara në këtë fushë. Ndryshimet e shpeshta politike, paqëndrueshmëria qeverisëse dhe informaliteti i lartë i ekonomisë së Kosovës mund të jetë një problem me vetë sa i takon saktësinë e informacioneve të prezantuara.

KAPITULLI II

2. RISHIKIMI I LITERATURES MBI POLITIKAT FISKALE, OBJEKTIVAT, INSTRUMENTET DHE EFEKTET

2.1. KONCEPTE HYRËSE

Shkenca e financës si shkence ekonomike filloi të zhvillohet nga gjysma e parë e shekullit XIX. Mendimet e teoricienëve të njohur që kanë trajtuar problemet më financa dhe kanë paraqitur një zhvillim të shkences së financës, përpos në konceptin dhe pikpamjen teorike e që vite me parë është parshikuera gjejnë edhe një saktësi edhe aplikim edhe në ditet tona, qofte në pikpamjen teorike qoftë në atë të aspektit praktike. Ndërsa, teoritë mbi lëmin e financës kanë filluar të shqyrtohen që nga viti 1930, për të vazhduar me teoricienët bashkëkohorë, që dhanë kontribut të madh në shqyrtimin e kësaj sfere. (Henderson:2007:66).

Zhvillimi i financave publike duhet trajtuar me shumë nga aspekti makroekonomik për rëndësinë që kanë ato për ekonominë dhe për shtetin në përgjithësi. Kështu, përdorimi i parimeve standarde të analizave ekonomike për të kuptuar se si arrin të determinohet prodhimi total i një kombi (PBB), është periudha e lindjes dhe e zhvillimit nga makroekonomia e re klasike, kur edhe shohim natyrën e sotme të analizave ekonomike në sfera të ndryshme, në fushën e financave publike, tregtinë ndërkombëtare apo ekonominë e punës. Financa publike, si shkencë e ekonomiksit, përdor teoritë dhe metodat me qëllim që t'i shpjegojë programet qeveritare, politikat që aplikohen dhe problemet që mund të rrjedhin në këtë sferë. Në këtë drejtim, në atë periudhë, makroekonomia klasike, ashtu sikur në fushat e tjera të ekonomisë, edhe në financat publike ishte vetëm fillimi i trajtimit të modeleve matematikore dhe statistikore të sjelljes ekonomike. Madje, qasja e analizave dhe e studimeve të problemeve filloi të bëhej gjithnjë më e rëndësishme në diskutimet e politikave makroekonomike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe në vëndet e tjera të botës edhe gjatë viteve të fundit.

Financat publike i gjejmë si objekt të interesimit të autorëve anglezë që në shekullin XVI e deri në shekullin XIX dhe përfaqësuesit më të njohur janë: Hobsi, Loku, Hjumi, Rikardo dhe Milli.

Një numer i madhe i studimeve është orjentuar rreth rolit dhe ndikimit të politikës fiskale si në kontestin teorik ashtu edhe në atë empirikë. Romer në botimin e vitit 2006, në studimet e tija konstaton se: "politika fiskale mund të përdoret për të kontrolluar ciklin e prodhimit ose për të stabilizuar lekundjen në treguesit makroekonomik, e që është njesojë me ndikimet afatshkurtëra të politikës monetare" (Romer 2006)

Poashtu, nesë deshirojm të shohim rolin e saj në periudhën afatgjatë, atëher themi se: politikat fiskale dhe format e financimit të borxhit ndikojnë në kërkesën dhe ofertën përgjithshme të ekonomisë.

Edhe sot e kësaj dite, por edhe në shumicën e shkrimeve dhe publikimeve shkencore në lidhje me këtë temë roli dhe ndikimi i politikës fiskale në rrjedhat ekonomike është shumë aktual dhe jepen ide të ndryshme që si duhet qeverite të ndërtojne strategjit e tyre dhe të reformojne paketat fiskale me qëllim të një rimëkembje apo stabiliteti ekonomik. Në rastin tonë, pra në ekonominë e Kosovës ende kemi mendime të ndara sa i takonë kësaj qeshtje dhe çfarë politikash duhet ndjekur. Ekonomia e tregut të lire, orjentim drejt BE-se por veqanërisht antarsimi në CEFTA është edhe një lloj tjetër politike që detyrësisht nuk mund të jesh i pavarur në gartimin dhe zbatimin e masave apo instrumenteve të politikës fiskale strikte.

Tomas Hobsi pretendon se ngarkimi i drejtë me tatime mund të realizohet më së lehti me aplikimin e tatimeve indirekte, sepse, sipas tij në konsum pasqyrohet forca ekonomike e qytetarëve, Xhon Loku, duke argumentuar, mbron përparësitë e tatimeve direkte, si në bujqësi, kadastër etj. Dejvid Hjumi në punimet e veta shqyrtoi veprimtarinë financiare të shtetit, kujdesin themelor ia kushtoi veprimtarisë së huasë publike dhe njëherësh ishte kundërshtar i madh i borxhit publik si burim i të ardhurave. Hjumi, ndër të tjera, thotë: "Nëse shteti nuk e zhdukë huanë shtetërore, atëherë huaja shtetërore do ta zhdukë shtetin"(Filipoviç:19761)

Shikuar nga këndeveshtimi historik sa u përket tatimeve, Hjumi përkrah pikëpamjen që "detyrimet tatimor të obligohen pavarësisht përfitimeve që kanë nga shteti"(Hjumi). Ndersa, Adam Smiti është kufizuar në problemet e tatimit. Smiti duhet përmendur në radhë të parë se iu përkushtua shqyrtimit të parimeve tatimore, që përcakton karakteristikat dhe mbi bartjen e tatimeve. Në këtë kontest edhe David Rikardo, konsiderohet si arkitekt i

ekonomisë së tregut të lirë. Në politikën e financave publike është i njohur për trajtimin e sistemit të tatimeve, ngarkesave tatimore, pasojat që shkaktojnë ngarkesat tatimore, inkuadrimit dhe rritjen e prodhimit.

Mbi politiken fiskale edhe Xhon Stjuart Milli është kufizuar në problematikën e tatimit, parimin e barabarësisë tatimore. Mendimi i tij ishte për lirin e minimumit të tatimit për ekzistencë, ndërsa nga aspekti i politikës së normave tatimore është kundër caktimit të tatimeve me shkallë progresive.

Me fillimin e shekullit XX na paraqet një epokë të re në ekonominë kapitaliste po ashtu kemi shfaqjen e teoricienëve bashkëkohorë, ku në studimet e tyre iu përkushtuan zhvillimeve të financave publike, që rrjedhin si rezultat i ndryshimeve dhe reformave të mëdha ekonomiko-shoqërore. Këtu kemi një avancim të vlerësimeve dhe aplikim të metodave matematikore dhe statistikore, që shprehin pikëpamjet e tyre mbi financat moderne, por dhe mbi ekonominë moderne kapitaliste. Më të njohurit janë: Samuelson, Cuckerman, Friedman, Tanzi, Hyman, Rubin, Leccisetti, Barro, Rosen, Heller, Meltzer, Perotti, Aleksina, Dickinson, Blanchard, Krugman, Coorsetti, Stigliz e të tjerë. (HYMAN: 2010:05)

Nëse marrim për bazë kontributin e teoricienëve në zhvillimin e kësaj fushe, patjetër që nuk mund të anashkalojmë teoricientet Irving Fisher, i cili kundërshtoi taksimin e të ardhurave konvencionale, duke favorizuar zëvendësimin e tij me taksë mbi konsumin. Këtë arsyetim të Fisherit e përkrahin edhe ekonomistët e sotëm për vendosjen e taksave të konsumit si dhe të akcizave të ndryshme.

Jemi të vetedishëm se politika fiskale kryesisht bazohet në veprimet dhe vendimet e qeverive me qëllim të ofrimit të fakteve për ndryshime të nevojshme mbi të hyrat dhe të dalat apo shpenzimet publike, duke pasur për vëllim rritjen e kërkesave agregate, mirëmenaxhimin e tyre, që të vihen në dispozicion një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik. Gjithëashtu kjo politike të orjentohej uljen e borxhit publik, përmirësimin e bilancit të pagesave, pa inflacion dhe në synim permanent për zhdukjen e varferis dhe ngritjen e nivelit të punësimit.

Levizjet ekonomike apo format e qeverisjes në një vend pa marrë parasysh se si orjentohej, kemi dy koncepte baze mbi politiken fiskale, dhe ato si politike fiskale ekspansioniste dhe si politike fiskale të shtrënguar.

Shkurtim i normave të taksave apo rritje e të dalave publike që kanë për qëllim mbeshtetjen rreth ngritjese se ritmit të konsumit, thene ndryshe kur kemi rritje të kërkesës agregate. Zakonisht diqka e tille ndodhe kur Qeveria ka stagnim të zhvillimit ekonomike dhe një normë të lartë papunësie.

Kur kemi një rritje të shpenzimeve publike dhe ulje e taksash, qytetarve dhe bizneseve u krijohet nje hapësir me e mare qe te qarkullojne me masen monetare duke I orjentuuar ne konsum dhe ne investime biznesore. Si instumet faktikisht ndikon direct ne ngriljen e numrit të të punsuarve nje progresi ekonomik. Kurse, politikat fiskale shtrënguese ndikojne direct ne zvoglimin e shpenzimeve publike dhe ngritjen e tatimeve.

Para se qeveria të përcaktohet për politikën fiskale, ajo bën vlerësimin e një numri të madh faktorësh përfshirë dhe ecurinë e variablave dhe indikatorëve kryesore ekonomike dhe financiare, për shkak të ndikimit të tyre në shumën e të hyrave të grumbulluara përmes taksave me të cilat përmbushen nevojat e financimit të programeve qeveritare.

Deficitin buxhetor po ashtu na paraqitet me një delikates të veçantë sa i perketë politikave fiskale, sepse qeveria patjeter duhet te orjentohe ne mbulimin dhe uljen e nivelti të deficitit, dhe te mbulimit te shpenzimeve te pa planifikuare shtetrorre apo per ndonej parregullsi qe ndodhe en buxhetin e vendit, andaj marrja e huave nga jasht është po ashtu nje rrezik permanent kur ne si Kosove nuk mund te emitojme para dhe nuk kemi nje pavarsi monetare por varem nga eurozona.

Teori shkencor të pa kundërshtueshme (edhe në ditet tona) mbi deficitin buxhetor dhe ndikimin e tij në ekonomi dhe investime ka dhënë David Rikardo, i cili në relacionin e ndikimit të financimit të borxhit të qeverisë midis brezave, thotë janë vlera ekuivalente, ku forma e financimit të qeverisë është e parëndësishme dhe për këtë quhet modeli rikardian, por që edhe vetë ishte skeptik rreth teorisë së tij.

Relacionin në mes të borxhit të qeverisë dhe të brezave e shpreh edhe vetë Barro, ku thotë se: “në politikën fiskale, reduktimi i taksave që shoqërohet me rritje të deficitit buxhetor, por që nuk shkakton rritjen e konsumit nuk do të ketë ndonjë efekt ekspansionist në ekonomi”(Barro).

Bazuar në teorine dhe praktiken e finances është i njohur problemi se shpenzimet e qeverisë përdoren për dy qëllime kryesore; sigurimin e të mirave publike dhe rishpërndarjen e të ardhurave (Alex Cukierman & Allan H. Meltzer I -2010).

Ky përkufizim më tepër është një kontribut plotësues për punën që bëri Robert Barro (1979), i cili lidhur me borxhin publik propozoi si dhe përhapi teorinë e vet, duke bërë përpjekje për të minimizuar barrën e tepërt të tatimit të shoqërisë me kalimin e kohës.

Me qëllim të krijimit të një politike fiskale sa më të besueshme dhe të ballancuar atëherë duhet që të kemi në konsideratë besueshmerinë e qeverisjes dhe orjentimet qeveritare në zhvillimin ekonomik por edhe nga ajo sa sa opinioni publikë pranon sinje orjentim të drejtë e zhvillimore. Gjithashtu përveç besueshmerisë dhe opinionit zhvillimorë duhet parur parasysh edhe faktorët e jashtëm, levizjet ekonomike globale dhe orjentimet globale në ekonomi. Mbeshtetja e kompanive vendore dhe subvencionimi i tyre është një nga orjentimet më të mira për një ekonomi të orjentuara drejtë tregjeve globale e si e till mund të përmirësojë edhe bilancin tregtar dhe të kemi një ekonomi stabile duke përfshirë rritje të fuqisë puntore në vend.

2.2. OBJEKTIVA DHE INSTRUMENTET DHE VEPRIMET E POLITIKËS FISKALE

Duke u mbështetur në literaturën shkencore por edhe vërtetuar në praktiken financiare shteti përmes politikës fiskale mund të ndikojë drejtpërdrejt në ekonomi dhe zhvillimin e vendit duke ndërtuar politika të mirëfillta ekonomiko-financiare dhe stimuluar sektorë të vecantë me qëllim zhvillimorë.

Bazuar në faktin se shteti përmes politikës fiskale vendos për taksat që grumbullojnë, transfertat, të mirat dhe shërbimet që blenë, financimin deficitar dhe mbulimin e borxhit publik, në fakt angazhohet në politikën fiskale dhe ka si synim avancimin e saj në harmoni të plotë me konceptet zhvillimore.

Përcaktimi i objektivave dhe ndërtimi i instrumenteve mbi politiken ka efekt direkte në zhvillimin ekonomik në vend. Pra nëse objektive të politikës fiskale janë: Stabiliteti politikë efikasiteti ekonomik, menaxhimi i drejtë i financave publike, implementimi i politikave fiskale zhvillimore dhe mbështetja në një drejtësi dhe shpërndarje të barabartë të ardhurave, atëherë mund të themi se vendi ka një të ardhme të ndritur dhe ka një potencial ekonomik në zhvillim e sipërë.

Qeverisja, duke aplikuar instrumentet fikse të politikës fiskale, ka një ndikim direct në ujen e papunsisë dhe uljen apo ruajtjen e nivel të çmimeve, duke u bazuar në një rishpërndarje të të ardhurave në sektoret profitabil të ekonomisë, subvencionimin e bizneseve që investojnë në vend, duke investuar në infrastrukturë që vihen në shërbim të investitorëve të huaj direct, duke e ngritur nivelin e arsimit dhe investuar në shkencë dhe duke krijuar një shebim shëndetsor stabil dhe kredibil. Kjo e fundit duhet trajtuar me një delikatesë të veçantë sepse vetëm në sektorin e shëndetësisë parate publike që dalin jashtë vendi për intervenime të ndryshme janë me qindar miliona euro nga sektori public dhe privat në mungesë të një sektori shëndetësor kredibil dhe funksional.

2.2.2. Veprimi i politikës fiskale në shtimin ekonomik

Çdo vend ka si detyrë që të hartojë plane zhvillimore dhe të mbështesë koncepte dhe modele ekonomike që çojnë në zhvillimin të qëndrueshëm andaj duhet orjentohen në një politikë strikte e orjentuar drejtë zhvillimit.

Veprimi i politikës fiskale, paraqiten në rrjedhat afatshkurtra, por ato mund të parashikohen dhe drejtohen edhe në rritjet afatgjate të bruto produktit vendorë, konkretisht të të ardhurave për kokë banori. Kjo situatë na qonë në një normë të rritjes ekonomike në vend.

Matja kryesore e nivelit të rritjes ekonomike varet nga rritja e BPV-së brenda një afari të percaktuar kohore, e që zakonisht brenda një cikli ekonomik apo viti fiskal të caktuar. Atëherë mund të themi se një veprim i tillë e përmirson standardin jetësor dhe e ngrite nivelin e konsumit por që njëkohsisht edhe e gjithë nivelin e qarkullimit monetar dhe edhe ekonomik në vend.

Shteti duke implementuar politikën fiskale synon të mberrie një normë të kënaqshme të rritjes ekonomike, por jto edhe një rritje maksimaliste.

“Norma optimale e rritjes ekonomike do të thotë shfrytëzim i faktorëve të prodhimit duke marrë parasysh edhe faktorë tjerë me ndikim në interesat e përgjithshme shoqërore”(Krasniqi UET).

2.2.3. Veprimi i politikës fiskale në nivelin e çmimeve dhe punësim

Duke u mbështetur në literaturën moderne argumentojme se: Qeveria dhe organeve tjera të shtetit, përmes institucionet kryesore që kanë në përdorim masen më të madhe të mjeteve, dhe ato reflektohen përmes kërkesës në treg ku direkt mund të blejnë mallra dhe kontraktjnë shërbimet që i shfrytëzojnë, në të njëjten formë siq bëjnë edhe institucionet tjera jo publike. Mirëfillit dihet se qeveria nga këto të hyra paguan të gjitha nevojat që lindin në skemat sociale dhe mbështet skemën e punësimit të ri në vend. Pra kjo formë e pagesave direkte ndikon indirekt në rritjen në treg dhe të kërkesave të tij.

Shteti e ka si orjentim të tij që të ulë papunësinë dhe të zvogëlojë skemën sociale në vend dhe atë të zëvendësojë me punësim të rregullt dhe në kohë të plotë kjo formë ndikohet direkt në një rritje të terthorë të nivelit të pagesave dhe të kalimit nga të varurit nga taksat në kontribuesit e taksave, e që logjikisht ndikon edhe në një stabilitet dhe qëndrueshmëri më të madhe fiskale.

Masa që shteti merr me qëllim të uljes së shpenzimeve publike dhe rritjes së të ardhurave janë të definuara “si masa të politikës kontraktive fiskale” (Krasniqi M. UET).

Po ashtu, kur kemi një kërkesë agregate më të vogël se oferta, serishe na shpije në një ulje të çmimit. Me qëllim të balancimit të ofertes dhe kërkeses agregate, atëherë shteti i stimulon politikat fiskale në atë drejtim që të kemi një ulje të shpenzimeve dhe një rritje të të ardhurave publike.

Masat neutral që shteti aplikon në politikën fiskale orjentojnë kryesisht në ruajtjen e nivelit të punësimit dhe të çmimeve në normat e preferuara.





Figura 1. Ekspansionit dhe mbyllja e hendekut

Mbyllja e hendekut të ekspansionit të shkaktuar përmes rritjes së pakontrolluar të kërkesës agregate, implementohet përmes një politike fiskale shtrënguese. Shkurtimi i shpenzimeve publike ndikon në rënien e kërkesës agregate dhe rrethimisht reënja e kërkesës agregate ndikon në uljen e BPV dhe reënjen e nivelit të çmimeve.



Hendeku i recesionit

Figura 2. Recesionit dhe mbyllja e hendekut të tij

Kërkesat e pamjaftueshme gjithmonë na paraqesin hendekun e recesionit, i cili hendek mbyllet duke rrit kërkesën agregate dhe BPV deri në nivelin e punësimit të plotë.

Veprimi i multiplikatorit dhe akseleratorit është jetik në procesin e implementimit të politikës ekspansive dhe restriktive fiskale.

Duke përdorur veprimin konkret përmes multiplikatori i shpenzimeve publike atëherë ne e kemi të qartë se sa herë rriten apo zvogëlohen të ardhurat kur rriten apo zvogëlohen shpenzimet publike. Nga ky veprim që argumentohet duke u orvatur për të ulur papunësinë shteti organizon dhe ubensionon operatore të ndryshëm ekonomik kryesisht të sektorit public që të ketë të punësuar në përmasa sa më të mëdha. Kjo pastaj ka efektin domino ku me hapjen e vendeve të reja të punës, krijohen të ardhura të reja dhe me në këtë sektor dhe në formë zingjyrore rritet kërkesa për produkte dhe shërbime në treg.

Ndërsa, pjesë e kundërt e sajë është nëse me masat e politikës fiskale synohet ulja e kërkesës, shteti rritë barrën tatimore e që një gjë e tillë ndikon direktë në uljen e fuqisë

blerëse, e qe logjikisht e ndikon ne zvogëlimin e kërkesës, e qe zvogëlimi i kërkesës sjell deri të zvogëlimin e prodhimit.

Zvogëlimi i normes së prodhimit në menyre direkte dhe te vazhdueshme ndikon në uljen e numrit të punësuarve e qe automatikisht e zvogëlon edhe kërkesën. Pra kjo forem e funksionimit ka te bej me nje perseritje kontunuele deri sa te mos ulet dukshem ndikimi i ngritjese se barres tatimore. E tere kjo mund te perfundohet se ky process na paraqet nje multiplikatorin me tendenca rëse.

Ndërsa “akseleratori tregon raportin midis vlerës së investimeve neto dhe rritjes së kërkesës” (Nimani 2016). Kjo pastaj arrihet me mbështetje shpenzimeve publike shtese, si për shembull: subvencionimi e ndryshem, mbështetja dhe ofrimi i kredive me kushte të favorshme, mbështetja ne fusha te ndryshme ku shteti ndikon në mbështetjen direkte të operatorve te ndryshem ekonomike me qëllim të krijimit te nje baraspeshës te qendreshme. Veprim i akseleratorit identifikohet shpesh here edhe si veprim induktiv i shpenzimeve publike apo ndikim terciar i shpenzimeve publike.


Duke marre per baze shpenzimeve publike si një nga instrumentet e politikës fiskale ekzistojne të gjitha kushte që të ndikohet në nivelin kualifikuese të papunjesve duke mbështeture programe te veqanta e qe ato pastaj te ndimojne ne kualifikimin e puntorve dhe kjo te ndikoj ne punësimin e tyre sa me te shpejte dhe me kopetente per vendin e punes, Po ashtu ketu mund te perdoret edhe ulja e kohes se punes, vitet e pensionimit, heqja e mbinormave te punes me qëllim të krijimit te hapsirave te reja per pune dhe inkurajimit te për fuqi të re punëtore per te zene vendin e punes ne nje shoqeri, ku kjo ne kontujtet edhe ndikon ne mirqenje dhe rritje te nivelit të pergjithshme të mirqenjes dhe ngritje se nje konsumi te pergjithshem.

Rajoni ynë sin je rajon që është ne nje faze tranzicioni po thuaj te tere sferave te shoqerise perballat me problematika te tilla e qe kjo ndikon edhe nje rritjen e gjithmbarshem ekonomike, jo vetem te nivelit te punsimit por edhe të nje ekonomie me te qendrueshme, perball nje situatë te tregut te lire dhe marrveshjeve rajonale dhe globale mbi levizje e lire te mallrave dhe tregut.

Per ilustrim te nje realiteti ekonomik në Figuren 3. kemi paraqitur BPV në vendet e Ballkanit Perendimore apo EJT shofim se Krohacia është vedni që ka një ngritje solide dhe që ka një shpejtësi që premtion zhvillim ekonomik. Vendi ynë Kosova ka një BVP-në nominale po thuaj se me të ulten ne rajon, ku pas nese është vetem Mali i Zi, kjo është

normale pasi që si popollatë është sa 1/3 e Kosovës. Ketu se metode komperative mund të marrim Maqedonin e cila më nr banoreve po thuj se është e barabarte me ne, por qe vlera noinale e saj është dyfish me e madhe se sa Kosova. Ndonse kemi një norme me te ultet megjithate mund të kostatojme se vendi yne ka filluar te kete nje rimekembje dhe se trendet janë pozitive ndonshe hapat janë shumë te ngadaltë

Figura 3. BPV në rajonin e Europese Juglindore



Burimi: Raporti i Statistikave të FMN për Rajonin në 2011.

Me qellim te ofrimit te kushteve dhe harmonizimit te politikave rajonale BE ka lansuar projekte te ndryshem nje nder to është edhe Marrëveshjet e Stabilizimit dhe Asociimit qe synojnë që në mënyrë progresive krijojnë një zonë t ë t regt isë së lirë mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Ku tregtia është e shqetësuar, dhe ata fokusohen në liberalizimin e tregtisë në mallra, duke rradhitur rregullat me praktikat e BE dhe duke mbrojtur pronën intelekt uale CEFTA është një marrëveshje e tregt isë së lirë e vetme që lidh të gjitha ekonomit ë e Ballkanit Perëndimor dhe Moldavisë. Ajo zëvendëson një rrjet t ë mëparshëm për më shumë se 30 marrëveshje bilat erale t ë t regt isë së lirë, duke vendosur kësht u rregulla t ë njëjt rajt shme nëpër t ërë Evropën Juglindore. CEFTA ka hyrë në fuqi për t ë gjith ha palët në nëntor 2007.

2.2.4. Politika fiskale në rishpërndarjen e të ardhurës dhe pasurisë

Bazuar në instrumentin e politikës fiskale “shteti nuk ka për qëllim të ndikojë në barabarësinë e qytetarëve sa i përket fuqisë ekonomike, sepse kjo mund të ketë pasoja në humbjen e motivimit për punë më të mirë e me përpjekje më të mëdha dhe me përgjegjësi të madhe në vendin e punës, të realizohen të ardhura më të larta respektivisht pasuri” (Borina Beqirllari 2003).

Bazuar në këte orjentim identifikohen dhe aplikohen masat dhe politikat që duhet implikuar për të vendos në raporte të vlersuar mbi të pasurinë dhe ardhurat.

Po ashtu duhet pasur në konsiderate se rishpërndarja e të ardhurave po ashtu ndikon direktë në shpenzimet publike dhe të obligon që të aplikosh modele dhe rregulla duke me qëllim të mbajtjes në kontroll dhe mbeshtetjese për shtresën që ka të ardhk atë të ulta.

Ketu duhet të merret parasysh edhe ndikimi i tatimeve indirekte në këto skema e që janë në interes të vetë qytetarve dhe qeverive.

Roli që paraqitet çdo instrument i politikës fiskale, mund të aplikohen edhe për qëllime tjera gjithnjë duke u bazuar në të mirën e përbashkët dhe nevojat që dalin në të gjitha kategoritë shoqërore si edukimi, shëndetsia, mbeshtetja direkte stimulit etj.

Përmes politikës fiskale tentohet që të rritet ndikimi edhe në zhvillimin regional dhe në përmirësimin e tërë strukturës ekonomike.

KAPITULLI III

3. TRANZICIONI DHE NDIKIMI I TIJ NË POLITIKAT FISKALE

3.1. NDËRTIMI I POLITIKAVE FISKALE NË SHTETET ME EKONOMI NË TRANZICION

Në fillim të procesit të tranzicionit vendet ish-socialiste realizuan një serë reformash të domosdoshme për funksionimin e ekonomisë së lirë të tregut.

Në kuader të këtyre reformave apo politikave, një vend kyç i takon reformave, në kuader të politikës fiskale.

Mëqenëse vendet ish-socialiste kishin një strukturë tatimore të dizajnuar për ekonominë e planifikuar e cila ishte jokompatibile me ekonominë e tregut, si dhe një administratë tatimore që kishte nevojë për reformim dhe riorganizim të plotë, duhet të operohet sukseshëm në kushte të reja.

Në mesin e ekonomistëve ka tendenca që suksesin apo dështimin e vendeve ish – socialiste, gjatë tranzicionit ta shpjegojnë me ecurinë e reformave fiskale. Vendet si Polonia, Republika Çeke, Sllovenia, Hungaria, Lituania e të ngjajshme, kanë qenë më të sukseshme në reformimin e sistemit tatimor dhe të administratës tatimore. Ato kanë një ligjshmeri më të avancuar që u mundëson implementimin më efikas të ligjeve tatimore dhe kanë arritur një shkallë më të lartë të zhvillimit ekonomik që përfaqëson u ofrohet vendeve të Evropës Përendimore. Vendet në tranzicion kanë ndjekur rrugë të ndryshme në përzgjedhjen e strukturës së tatimeve dhe rëndësise që i jepet një tatimi të caktuar.

Të gjitha përvojat e deritashme lidhur me futjen e tatimit mbi vlerën e shtuar në çdo shtetë, pavarësisht nga niveli i zhvillimit ekonomik ose dallimet në sistemin ekonomik-shoqëror, dëshmojnë se për aplikimin e sukseshëm, kusht kryesor është përgaditja adekuate e administratës tatimore. Nuk është e tepërt të theksohet mendimi i disa ekspertëve të FMN-së se brendia e politikës tatimore është e përfaqësuar nëpërmjet funksionimit të administratës tatimore (Cosanegro de Jantscher 1990:171-179).

Me qëllim të një ilustrimi sa më të mirë e që të kuptohet tranzicioni edhe në skemat fiskale kam paraqitur vendet që kanë kaluar këtë fazë para vendit tonë. Shtetet që kanë një

kohe me te gjate te kalimit të tranzicionin janë me mirë të organizuara dhe kane perbaluar me lete ndikimin negativ qe vije nga ky proces. Kryeshite keto vende të europes kanë marr për model shtetet e zhvilluara dhe me nje kulture te lartë politiko-ekonomike siq jane dhe vet vendet themeluese te BE-së. Por ky orjentim kryeshit perveq që ishte deshire ishet edhe obligim nese vendet done te aderojne brenda unionit. Pra perveq orjetimeve kane marr ghapa konkret që të harmonizojne politikat me vendet e BE-se dhe të marrin modelin e tyre ne implementim.

Ndonse të gjitha vendet pos komuniste kishin orjentim BE-në, secila nga to ka ruajture specifikat e veta dhe ka pershtatur politiken fiskale me nevojat vendit te vete. Sii pasoj e nderhyrjeve me qellim te harmonizimit te politikave nacionale me ato te BE-se shtetet shume shpeshe kane nderruar norma, llojet dhe format e taksimit.

TVSH po thuaj se ne të gjitha vendet ishte tatimi që me se shumti ka rezistuar ne konceptin nacional ndonse shume vende shume shpesh i kane levizur kufijet e keti tatimi indirekt. Për shembull: Polonia, që në vitit 1993, tatimi mbi qarkullimin e ka shenderruar në TVSH-në ,dhe ate duke e shkallzuar në: 22% ,7% dhe 0% .

Republiken Çeke është një shembull tjetër ku po thuaj se ka te njejtat tatime por qe ka shkalle tjera taksimi. Ketu tatimi në fitim ka shkallën prej 35% dhe një norem tjetër për bizneset që operojne nga fondet investive me 25%

Bullgaria nga viti 1999 aplikohet TVSH-ja me shkallë unike më 20%, ketu nuk tatohet vetem ari i importuar nga banka qëndrore.

Hungaria, TVSH-në obligon te renditur në dy norm: me 25% si dhe me 12% per mallra dhe sherbime specifike .

Kroaci ka aplikuar TVSH-në ne vitin 1998 me shkallë të vëtme prej 22% ketu lirohen vetëm mallrave e jeteses si buka, qumështi, literatura, ilaçet specifike ,impiantet etj.

3.2. STABILITETI POLITIK DHE TRANZICIONI NË BALLKAN

Ballkani, si term gjeografik i shtetve të Europës juglindore është pjesë mjaftë specifike dhe me një histori të ndertuar me problem, kriza, lufta dhe pushtime të ndersjellta por edhe nga jashtë ballkanit. Po thua se sa kanë të përbashkët vendet e Ballkanit po thuaj se aq kanë edhe dallime si në kulturë, traditë, gjuhë, fe, ekonomi por edhe kembimesh e bashkëpunimesh ekonomike. Vitet e fundit kanë dalë në shumë vështësi dhe shumë problem sa që ky lokalitet ka përjetuar dhunë, terror dhe deri në gjenocid nga popujt që jetojnë dhe bashkëjetojnë këtu, prandaj edhe ekonomia më e flasim për politikën fiskale ishin po thuaj se në shumicën e kohës armiqësore mes veti.

Bazuar në këto pikpamje, qytetarët ballkanas që mendojnë të jetojnë në këto treva, duhet të investojnë dhe të jenë të interesuar për stabilitetin dhe sigurinë në rajon, kusht i domosdoshëm për përparimin ekonomik e njerëzor, madje dhe për integrimin e tyre në Evropë dhe bashkësinë euroatlantike.

E tillë ka qënë dhe politika e qeverisë shqiptare në shekullin e kaluar dhe disa qeverive tjera të rajonit në përjashtim të politikës shoviniste të udhëhequr nga Beogradi. Jam e bindur që pa një stabilitet politik, pa demokraci dhe siguri në vendet e veçanta dhe rajonin, nuk mund të këtë përparim në Ballkan, por dhe se pa zhvillim ekonomik e rend demokratik në secilin nga vendet, kontradiktat dhe krizat do të jenë të përvetshme. Kam qënë dhe jam gjithashtu e bindur që pa stabilitet, nuk mund të këtë bashkëpunim ekonomik e njerëzor ndërmjet vendeve ballkanike, që më të drejtë është përcaktuar si parakusht për përfshirjen e tyre në strukturë më të gjëra se sa rajoni si në aspektin ekonomik, ashtu dhe atë ushtarak, prandaj edhe bashkësi ndërkombëtare ka aplikuar instrumente të ndryshme integrale.

Stabiliteti dhe siguria në Ballkan do të jenë përherë në pikëpyetje përderisa ndërmjet vendeve ballkanike ka nga ata që përdorin dhunën dhe pastrimin etnik, gjenocidin dhe kampet e përqendrimit, që i mohojnë popujve të drejtat më elementare, natyrore, deri dhe ato që thuhet në dokumentat ndërkombëtare.

Të gjithë e kuptojmë se jashtë strukturave evropiane dhe pa bashkëpunuar me to është tëjet e vështirë, në mos e pamundur, për të përparuar me shpejtësi. Por, në cilindo rast, duhet stabilitet i brendshëm dhe i rajonit dhe marrëdhënie të qëndrueshme me fqinjët. Këtë

e kërkojnë dhe donatorët dhe investuesit e huaj. Këto arrihen vetëm në kuadrin e një shteti pluralist e demokratik e me struktura ekonomike të tregut të lirë. Kjo vlenë pa përjashtime për të gjitha vendet në zhvillim në rajon.

Në të tilla rrethana, është mjaft evidente absurditeti i destabilizimit me metoda jo demokratike të njërit nga vendet ballkanike, për cilëndo "arsye" qoftë, për të "siguruar" stabilitet në Ballkan. Destabilizimi, veç humbjeve materiale e njerëzore në vendin përkatës, bie shtimin e ndjeshëm të emigracionit në vendet fqinje dhe të kriminalitetit në to. Kjo është për t'u patur parasysh. Synimi për integrim kërkon jashtë çdo dyshimi besimin në strukturat evropiane dhe deri diku "detyrimin" për t'iu "bindur" e dëgjuar fjalën kur gjykohet se nuk cënohen interesat kombëtare. Por në këtë rast, zërat apo propozimet duhet të jenë zyrtare e të autorizuara nga struktura e jo nga njerëz të veçantë dhe kërkesat e pasojat eventuale duhet t'i njohi opinioni publikë dhe gjithnjë në kuadrin e një zgjidhje afatgjatë.

Përparimi i vendeve të Ballkanit në veçanti dhe i rajonit në tërësi, kërkon dhe siguri për stabilitetin, garanci e mbështetje më të madhe për më të dobëtit apo të vegjlit, trajtim të njëjtë jo me kritere të ndryshme për të njëjtat çështje apo probleme. Duhet të pranojmë, për fat të keq, se nuk ndëshkohen, veçohen apo dënohen si duhet ata që ushtrojnë dhunë mbi të tjerët (dhuna është dhunë dhe asnjëherë nuk vlejné justifikimet apo pretekstet), ata që paraqesin pretendime apo ndërhyjnë tek fqinjët, qoftë dhe nën petkun e ultranacionalizmit "të pakontrolluar". Unë mendoj se përfitimi momental për ata që përdorin këto rrugë, është afatshkurtër, mbartë e krijon rreziqe më të mëdha. Shembuj tragjikë të shekullit të kualuar janë mjaft domethënëse. Sot bashkësia ndërkombëtare duhet të ndërhyjë në formën që e gjykon të arsyeshme, për deri kur e "gjykon" të tillë; në rajone të tjera ka ndërhyrë dhe njekohësishtë të investoj në një stabilitet jo vetëm politik por gjithnjë të ndërlidhur me aktivitete ekonomike të përbashkta dhe projekte rajonale ku secili vend i Ballkani i she interesat e tija brenda këtij investimi.

Interesat e vërteta apo reale të popujve të Ballkanit janë të tilla dhe për të tjerët, përderisa ne bëjmë pjesë në zonat e tyre të interesimit. Po kështu, prania ushtarake shumëkombëshe mund të jetë e nevojshme në disa vatra për të garantuar paqen dhe të drejtat e popujve, por gjithmonë duke integruar dhe bashkëpunuar mes komuniteteve.

Ne, si qytetaret të Europës Juglindore jemi thellësishtë të bindur se, duhet të kuptojmë se zgjidhjet tona duhet domosdo të inkuadrohen në zgjidhje e skema mbirajonale, mbi një

vështrim gjeopolitik më të gjerë për vetë pozitën e vendeve Ballkanike, si udhëkryq midis kontinenteve, fakt i evidentuar gjatë shekujve. Përveqse këto zgjidhje dhe kur imponohen, duhet të vlejnjë për të gjithë, pra të jenë të paanëshme. Gjë që ne sotë ende nuk po e shohim në realitet.

Qytetaret e Evropes Juglindore (në shumë dokumete dhe emertes njihen edhe si Ballkan Perendimorë) që ende nuk janë integruar në BE mund të konsiderohen të denjë për Evropën, duke i ndihmuar e orientuar ata në të gjitha aspektet, veçse i afron me Evropën, i evropianizon më tepër. Dikujt i duhet dhënë ndihmë ekonomike (me këtë shmangjet dhe emigracioni ilegal e krimi), dikujt leksione demokracie, dikujt i bihet duarve kur dhunon të tjerët e dikush do demaskuar kur jep shfaqje ultranacionalizmi të sëmurë. Po kështu, më seriozisht duhet punuar për të zgjidhur drejt e përfundimisht problemet etnike që bëhet vetëm duke i bërë të pamundura konfliktet.

Kur flasim për tranzicionin nga sistemi komunist në atë të shtetit ligjor e të ekonomisë së tregut të lirë, duhet të kuptojmë një periudhë jo të shkurtër e jo të njëjtë si kohëzgjatje, ecuri dhe vështirësi për të gjitha vendet dhe për pasojë mbështetja nga jashtë, në format dhe përmasat, detyrimisht duhet të jetë e ndryshme. Mbasë këtyre viteve përvoja bindemi që për të zgjidhur dhe probleme që ekzistojnë në aspektin rajonal, politik dhe të zhvillimit ekonomik, duhen mbështetur dhe më shumë e me më tepër mirëkuptim vendet më të prapambetura, që vuajtën më shumë nën komunizmin, për ta kapërcyer në një kohë sa më të shkurtër këtë prapambetje. Vetëm në këtë mënyrë do të mënjanohej tensionet sociale të brendëshme, tendencat migratore, veprimtaritë e ndaluara, vetëm në këtë mënyrë integrimi rajonal dhe më tej në Evropë do të jenë më të shpejtë. Kur flasim për ndihmë të huaj për të përballuar sfidat e tranzicionit dhe për të siguruar ritme të shpejta zhvillimi, që të mënjanohet prapambetja, ata që ofrojnë dhe japin ndihmë, duhet dhe të thonë nëse ndihmë përfituesi po ecën në rrugë të drejtë, nëse po ndërton struktura demokratike dhe të ekonomisë së tregut të lirë, nëse po i shpenzon drejtë fondet, nëse janë të nevojshme projektet, nëse po kualifikohen kuadrot dhe a po përdoren drejtë ata dhe se ata nuk duhen larguar, nëse po hartohen ligje të drejta, nëse po deformohen ato që janë hartuar më parë, nëse janë ndarë realisht nga e kaluara komuniste etj. etj.

Shqiptarëve në të dy shtetet (Shqipëri dhe Kosovë) iu duhen mësuar rregullat e demokracisë dhe zbatimi i tyre, por jo t'u "përzgjidhen" e imponohen drejtuesit. Kjo po rezulton e pasuksesshme dhe tërthorazi po ndikon edhe në qeveri të varuara nga interesat e

të tjerëve. Politikat ekonomike rajonale duhet të jenë me integruese dhe me të përgjegjshme karrshi njëri – tjetrit dhe të kenë me shumë pika bashkimi se sa ndarje, posaqërisht në sektoret ekonomik dhe të tregtisë së lire.

3.3. TRANZICIONI, PRIVATIZIMI, LLOJET DHE FORMAT E TIJ

Bazuar në literaturën shkencore dhe situatat e njohura gjatë një procesi, tranzitorë ku kemi të bëjmë me ndryshim të tërsishme të një sistemi politio-ekonomik, mund të themi se, na paraqiten rrethana të reja dhe konfigurim komplet tjetër i qasjes ekonomike, jo vetëm në vend por edhe në aspektin ndërkombëtar. Ky proces paraqet kushteve specifike dhe një ndërtimi të ri të sistemit ekonomik.

Literatura moderne dhe ajo e bazuar nga verdet e origjines të cilat kanë kaluar këtë proces arrim në një perfundim se: privatizimi mund të jetë i plotë, i perzier dhe masiv.

Privatizimi i plotë – Ky lloji i privatizimit ka të bëjë me përdorimin e metodave nëpërmes shitjes direkte të ofertuesit. Kjo metodë e privatizimit ka pasur si pasojë rrjedhen e procesit ku ndërmarrjet më së shumti i blejnë investitorët e huaj. Këtë më së miri e tregon rasti i Hungarisë dhe Estonisë, ku investimet e huaja kishin rol të madh.

Privatizimi perzier – në anën tjetër ka sjellë si rezultat dominimin e investitorëve të brendshëm. Në këtë lloj privatizimi kanë dominuar ofertat e menaxherëve. Por, shpesh ky privatizim është karakterizuar me mbetjen e përqindjes së madhe të aksioneve në shtet. Shembuj të tillë janë Rumania dhe Sllovenia.

Privatizimi masivë – ka të bëjë me metodën e privatizimit ku aksionet u jepën shtresave të gjëra nëpërmes vauçerëve si punëtorëve, shtetit apo edhe popullatës. Është treguar më kompleks sa i përket natyrës së dominimit pronësor. Përderisa në Rusi dhe Ukrainë dominuan investitorët e brendshëm, në Çeki dhe Poloni privatizimi masivë kishte rrjedhur në drejtim të dominimit të investitorëve të jashtëm.

Në Kosovë përdoret privatizimi i plotë. Por, me anë të këtij privatizimi dominim kanë pasur investitorët e brendshëm për shkakë të statusit të pazgjidhur shtetëror dhe frikës së investitorëve të jashtëm.

3.3.1. Tranzicioni dhe kalimi i ekonomisë së centralizuar në ekonomi tregu

Kosova, si një vend i vogël dhe ballkanik, i cili e ka përjetuar këtë “smundje” ka bërë hapa të mirë për të hapur si ekonomi dhe treg sipas kërkesave të një ekonomie evropiane dhe botërore, duke miratuar një bazë të mirë ligjore që bazohet në një liberalizim ekonomik.

Shtetit është përqendruar në rregullimin makro-ekonomik që të siguroi një qendrueshmeri ekonomik dhe ndërtoi politika zhvillimore të qendreshme.

Çdo vend sistemi e tij politiko-ekonomik ka obligim që të bazoj në institucionet demokratike, shoqërinë e hapur, ekonomi të lirë të tregut por edhe në bashkpunim rajonal e ndërkombëtar, gjithmonë duke e ruajtur interesin e tij ekonomiko-shoqëror.

Tranzicioni është një proces i ndryshimeve thelbësore ekonomiko-politike të një vendi me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe performancës së vendit e posaqërisht të ekonomisë së tij.

Pra, kur themi se kemi të bëjmë një reformim të thellë deri në ringritje themelsh të një sistemi të ri atëherë duhet ditur se ky proces nuk mund të “qeveriset nga rasti në rast, aq më pak në mënyrë stihie” (Selmanaj 2012:12), por duhet të sendërojmë strategjinë nacionale për përbalimin e pasojave që mund të lindin nga kalimi nga një sistem në një të ri. Kjo do të thotë gjetja e optimumit, duke patur parasysh oportunitetin politik, oportunitetin ekonomik dhe oportunitetin social. Përvoja e zhvillimit të tranzicionit në vendet ish socialiste dëshmon se mungesa e kësaj strategjie dhe këtij optimumi e forcon rezistencën ndaj ndryshimeve dhe ushqen inercionin më të fuqishëm të elementeve të sistemit të vjetër.

Rezultat i tranzicionit në Kosovë duhet të jetë ndryshimi kompleks i gjendjes, që nënkupton zgjidhjen e statusit të Kosovës.

3.4. TRANZICIONI NË KOSOVË

Në lidhje me tranzicionin Kosova ishte në fazën përgatitore dhe shumë ekspertë të fushave ekonomike kanë asistuar dhe janë munduar që më punën e tyre, qoftë brenda institucioneve paralele që funksiononin para luftës çlirimtare të UÇK-se qoftë duke botuar apo mbajtur leksione studenteve para luftës. Lidhur me privatizimin në Kosovë kryesisht

është marrë profwaor Selmanaj, i cile e parashi që Kosova duhet të të ketë, kushtet specifike në të cilat zhvillohet tranzicioni. Në vendi tone tanzicioni politio-ekonomik zanafillen e tije e ka ne në fund të viteve 80-ta te shekullit te kalua, saktesisht me lëvizjen për liri dhe demokraci, kjo levizje synim kishte që Kosovën ta transferonte nga nje sistem politiko-ekonomik në një sistem tjetër dhe nga okopimi në liri dhe Pavarsi.

“Përpyekjet e Kosovës për liri dhe pavarasi do të jenë kuptimplote e të suksesshme nëse kurorëzohen me ndërtimin e institucioneve të pavarura demokratike të shoqërisë së hapur. Së këndejmi, tranzicioni në Kosovë është komponent i rezistencës aktive, veprim aktiv dhe pjesë e aktiviteteve çlirimtare në kushtet e tashme. Kjo është specifika më e rëndësishme që karakterizon tranzicionin në Kosovë”.(Nimani: 2010:28)

Mirëpo gjithçka ka ndryshuar në Kosovë në fillim të vitit 1998 kur popullata ishte e ngopur nga krimet dhe terrorizimi që i bëhej nga shteti Jugosllav dhe po përgaditej për luftë çlirimtare. Më fillimin e luftës së UÇK-se kundër makinerisë se Jugosllavisë për mendimin tim ishte edhe faza më evolutive e tranzicionit në Kosove jo vetëm ekonomik por edhe moral, politik dhe në të gjitha sferat.

Kosova se bashku më lirine e ka kaluar edhe krizën që sjell tranzicioni në të gjitha vendet, por njëherit popullata vendore që konsiderohet nga treguesit e Bankës Botërore që është një nder më të varferat në rajon , u detyrua që krahas dhimbjeve që shkaktoi lufta dhe humbjeve jo vetëm në njerëz por edhe në ekonomit familjare ti bëjë ballë veshtirësive të tranzicionit.

Kosova ka kaluar dhe po thuhet se shumicen e procesit te privatizimit dhe mendoj se të të hyrat nga privatizimi që mbahen të bllokuara në banka jashtë Kosovës më Vendim të Zyrës ligjore të OKB dhe më harmoni më rregullore mbi AKM-në të investohen ne sektoret zhvillimit të ekonomise së Kosovës.

Mendoj se po të futen në qarkullim në Kosovë apo ti jepen në huazim bankave komerciale (që është edhe kërkesë e Qeverisë) do të kontribuonin dukshëm në zhvillimin ekonomisë se mjerë të Kosovës.

Popullsia me e re ne Europe, si pasoj e rrethanave politiko-shoqerore u detyrua te migroj dhe rreth 20% e jane edhe sot është e perqendruar ne adresa residente në dhe Amerike. Fillimisht, qytetaret tane qe migruan ne perendim ishin meshkuj qe dmth se ishin kra pune, e kjo ndodhi po thuhet njetrajtshme deri ne perfun dim te luftes se Kosoves ne vitin 1999. Kjo fuqi puntore sote është nje gjenerues i te ardhurave dhe ne baza vjetore ne

fiore remitançave kimi mbi 600 milion euro që hyne në vend në rrugë dhe forma të ndryshme qofte si kesh qofte si mall. Kapitali i kësaj pjesë të popullatës mund të angazhohet në forma të ndryshme dhe mund të krijohen ura ndërlidhëse bashkëpunimi me vendet ku ata jetojnë, për të krijuar kushte për ri integrimin e tyre në atdhe. Ky mund të jetë një injeksion pozitiv për ecuritë e tranzicionit.

3.4.1. Kosova – nën administrimin ish-Jugosllavisë

Varësisht nga pozita ekonomiko-shoqërore që kishte Kosova në ish-Jugosllavi zhvillimin ekonomik të saj mund ta ndajmë në tri periudha:

Zhvillimin ekonomik në periudhën 1947-1965

Zhvillimin ekonomik në periudhën 1966-1989

Zhvillimin ekonomik në periudhën 1989-1999

Zhvillimi ekonomik i çdo vendi, po ashtu edhe i Kosovës, shprehet nëpërmjet dinamikës së zhvillimit ekonomik kurse dinamika shprehet përmes normave të shtimit të produktit shoqëror, si tregues më relevant makroekonomik.

Deri në vitin 1970 zhvillimi ekonomiko-shoqëror u koncentrua kryesisht në qendrat më të mëdha urbane që dalloheshin me infrastrukture ekonomike e shoqërore në krahasim me qendrat e tjera. Ngritja e objekteve ekonomike dhe industriale në këto qendra bëri të mundur zhvillimin më të shpejtë ekonomiko-shoqëror të tyre në krahasim me qendrat e tjera komunale të Kosovës. Politika konkrete dhe aktive e zhvillimit rajonal në Kosovë fillon nga Plani shoqëror në periudhën 1971-1975.

Kjo periudhë për Kosovën ishte koha kur hartoj masa konkrete në kuadër të politikës ekonomike për zhvillimin territorial ndonse ishte nën një pushtim të egër Jugosllav.

Institucionet autonome të Kosovës, në atë kohë si krahin autonome e ish-Jugosllavisë hartuan dy ligje që ishin kyqë, si:

1. Ligji i cili themelon një Fond për Nxitimin dhe Zhvillimin më të shpejtuar të komunave ekonomikisht jo të zhvilluara.
2. Ligji i cili përcakton kriteret se cial komune njihet si komune jo mjaft të zhvilluara.

Kjo ishte një masë ku si përcaktues u morr koeficienti relativ i zhvillimit duke u llogaritur në bazë të treguesve kryesorë ekonomike të poshteshnuar:

- ✓ Të të ardhurat kombëtare për një banorë,

- ✓ Pjesëmarja e të ardhurave të industrisë në të ardhurat kombëtare të përgjithshme,
- ✓ Vlera e fondeve kryesore të sektorit shoqëror për një banor,
- ✓ Norma e punësimit në sektorin shoqëror (numri i të punësuarve në 100 banorë)
- ✓ Madhësia e të hyrave vetjake buxhetore për një banor.

3.4.2. Zhvillimi ekonomik i Kosovës në periudhën e pasluftës

Duke e pasur para syshë se Kosova, kaloi një periudhë shumë të vështirë, gjatë aparteidit serb (edhe në ekonomi) që polullata përveq që humbi të afërmit e tyre atyre ju shkatërrua edhe ekonomia familjare dhe bizneset e pakta që operonin. Institucionet që vepronin në Kosovë gjatë kohës së luftës ishin kryesisht ato të okupatorit dhe po thuaj se edhe ekonomia ishte e orjentuar në financin e luftës, në të dy krahet. Bizneset që punonin në "I;egalitetin; e asja kohe kryesisht plaqekiteshin nga forcat serbe ndërsa popullata shqiptare tër kapacitetin e saj e vendosi në shërbim të luftës çlirimtare të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Edhe dërgesat e mërgimtarëve u ndërpre në këtë kohë pasi që edhe ata financonin kryesisht fondet e luftës dhe të afërmit e tyre që ndodheshin refugjat anë e kënd botës.

3.4.3. Ekonomia në Republikën e Kosovës, sot

Ekonomia e Kosovës është një ekonomi e re dhe e lidhur ngushtë me vendet e tjera e posaçërisht me ato rajonale pasi lufta e vitit 1998-1999, dhe pushtimi i gjatë pothuajse shkateroi në tërësi sistemin ekonomik të vendit. Vendi ynë kryesisht bazohet në të hyrat doganore, që është një tregues jo shumë i mirë i zhvillimit ekonomik. Kur kësaj i shtojmë edhe problemet rajonale dhe globale që ndërliken edhe me krizën globale e bëjnë edhe më të vështirë situatën ekonomike në vend.

Republika e Kosovës evidentoi një seri të metash në sistemin e saj ekonomik kur vendet e fuqishme ekonomike i përfshiu kriza ekonomiko-financiare globale e që më shumë se sa ndikimi i drejtpërdrejt i saj në ekonominë ose financat publike, nxori në pahë dhe disa probleme kardinale, dhe shtoi disa pyetje tepër përmbajtës edhe domethënëse:

1. Sa e qëndrueshme është rritja jonë ekonomike?
2. A kemi modelin e përshtatshëm ekonomik për të garantuar ritmet e rritjes në vitet e ardhshme?

3. A kemi një ekonomi të strukturuar, me të cilën mund të shkonim drejt një zhvillimi të qëndrueshëm e afatgjatë?

Këto dilema janë problem i një ekonomie të brishtë kur ke para sysh, se vendi përballet me tranzicionin dhe pasojat e një ekonomie dhe të shkatërruar nga sistemi dhe lufta apo eksplatomimi masiv i shkaktuar nga okupimi i fundit serb.

Zhvillimi i ri nuk paraqet utopi, në qoftë së utopinë e kuptojmë si vizion të së ardhmes, që po ndodhë sot, vizionin në të cilin civilizimi bashkëkohor bazohet dhe po ndërton projektin e vetë të qëllimit të ri.

3.5. ZHVILLIMET DHE PARASHIKIMET E EKONOMISË SË KOSOVËS

Mbështetur në raportet e publikuara nga Institucionet kompetente të Republikës së Kosovës, konstatojmë se vendi ynë është prekur nga kriza e tregjeve ndëkombetare financiare në dijsa segmente, por jo në një masë të madhe sa vendet e zhvilluara ekonomikisht.

Ndonse vendi ynë, i takon Europës si gjeografi dhe në viti 2012 euro-zona u karakterizua me një krizë më të madhe të borxheve ajo nuk reflektoj shumë në Kosovë. Ndonse masa e ndikimit të krizes ishte e kufizuar, efektet e saj u reflektuan edhe në Kosovë, kryesisht duke shkaktuar uljen e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve të caktuara si dhe një rënie të dukshme të investimeve direkte nga vendet e huaja.

Siç jemi në dijeni se remitencat kanë një ndikim të madhe në mirqenjen e qytetarve dhe duke e ditur se dergesat kryesisht vijnë nga Gjermania dhe Konfederata e Zvicëres, si dhe duke u mbështetur në raportet e BQK-së vërejmë se ndikimi më i madhe i krizes financiare globale u reflektuar në remitencat e që kjo direkt ndikon në uljen e shportës së konsumatorve duke e zvogëluar fuqinë blerëse të qytetarve të Kosovës.

Baza e evidentuar e importit në Kosovë tregon një pasqyrë të qartë të nivelit të konsumit të përgjithshëm dhe kjo kryesisht paraqet një rritje të theksuar në sasisë të mallrave të importuar për konsumim. Kjo tregon se në kohën e analizës sime kemi pasur një rritje prej mbi 10% të sasisë së mallrave konsumuese të importuara. Këtu duhet të theksojmë se një rritje e tillë është mundësuar nga rritja e të ardhurave nga punëtorët kosovarë

që janë të angazhuar në punojn në vëndet e Lindjes së Mesme¹. Po ashtu kesaj rritje te konsumit I ka ndikuar edhe rritja e kredive individuale për familjare. Por egziston edhe nje e dhen nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) se kjo ngritje pjesërisht është mundesuar edhe nga ulja e lehtë e çmimit të produkteve ushqimore, dhe gjithsesi se ka ndikuar në rritjen e sasisë së konsumit te perditshme dhe në pergjithsi në shporten familjare.

Element tjetër që ka ndikuar ne kete rritje është shpërndarja e fondeve të rezervuara për punëtorë nga procesi i privatizimi dhe I likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore, siç njhet tek ne si: 20%-shi i masës monetare të inkasuar nga shitja e asetëve të ketyre ndermarrjve shoqerore.

Të dhënat argumentojnë tendencen se: “struktura e mallrave të importuara në vazhdimësi po tregon një tendencë të zhvëmndosjes drejtë mallrave që përdoren si lëndë e parë e prodhimit si dhe drejtë mallrave që përdoren për investime. Kjo konfirmon edhe faktin e rritjes së vazhdueshme të investimeve në Kosovë gjë që pritët të përmirësoje edhe nivelin e zëvendësimit të mallrave të importuara me ato vendore”.²

Nga kjo shihet qartë se në periudhen e analizes sime që është pesë vjeqare, vërehet se kemi një rritje prej 19% e sasisë së importit të mallrave investuese. Kjo na mundeson të themi se rritja e investimeve nga sektori private, saktësishte ka ardhur si rezultat i avancimit kontuniel të politikave subvencionuese të të bërit biznes, e që qeveria kete avancim e ka letesuar duke e sherbyer me politika të letesuese tatimore. Gjithashtu kemi apsur edhe renje teçmimeve per mallrat që ishin ne target te investimeve ne kete periudhe (2008-2012). Duke u mbestetur ne të dhenat e BQK-se, investimet e përgjithshme ne kete perudhe kohere rriten ne masen e 8.0%-e bazuar në norma reale.

Po ashtu konstatojm se një role dominante ne keto permirsime apo kete ngritje te investimeve kishte edhe sektori public apo rrija në investimet publike e që kryesisht keto investime ishin në projekte infrastrukturore, (ndertimi i një numeri shumë të madhe të objekteve shkollore, shendetsor administrative, dhe investimet në sektorin e rrugeve perfshire edhe autostradatë).

Trendet e rritjes ekonomike gjatë kesaj periudhe e ka ngadalësuar në masë të madhe uljen e eksportit të mallrave. Gjithmone duke u thirrur në burimet origjinale të raportuera

¹ Bazuar në të dhënat aktuale të BQK-së, të hyrat nga kjo kompenzimi i punëtorve

² Raporti I BQK-se mbi Importin e mallrave dhe qendrushmerin ekonomike te Kosoves, 2012.

nga BQK, sasia e eksportuar e mallrave ka shënuar rënie prej mbi 20%, kjo tregon se përveç metaleve, eksporti i produkteve të tjera ka shënuar rritje të konsiderueshme edhe për shkak të bazës së ulët të rritjes së eksportit të këtyre produkteve. Saktësisht eksporti i mallrave identifikohet të shënoj ulje reale në masen rreth 22% të mesatare në kohën e analizës sime.

Sektori i shërbimeve në Kosovë ka qënë ai që është prekur nga efektet e krizës në euro-zonë duke shfaqur shenja të qarta të rënies. Kjo është vërejtur në sektorin e shërbimeve të eksportit të shërbimeve të udhëtimit është shtytësi kryesor i eksportit të përgjithshëm të shërbimeve, rënia në këtë komponent, që vlerësohet të ketë ardhur si pasojë e numrit më të vogël të lëvizjeve të mërgimtarëve nga vendet e Europës, dhe kjo ka reflektuar në rënien e eksportit të shërbimeve në përgjithësi. Kjo rënie në kohën e analizës sime 2008-2012 është në masen mesatare të 16% të eksportit të shërbimeve. Mirpo kjo situatë është përmirësuar në vite në vijim dhe në përditën pas viti 2012 kemi një përmirësim dhe rritje edhe të këtij sektori. Si përmbledhje mund të themi se: trendet e një rritje të ngadalsuar ekonomike në Kosovë ndikuan në rënien e importit të shërbimeve dhe si rrjedhim, për vitet 2008-2012 importi i shërbimeve ra me mesatarisht në masen 2.6%.

3.5.1. Mjedis i jashtëm ekonomik

Ekonomia e vogël e Kosovës ndonjëherë me një masë të papërfillshme në euro-zonë është pjesë e një rimekëmbjeje edhe ndaj paqartësive të mëdha përcjellin këto zhvillime. Periudha afat-mesme shpre paqartësi kryesisht në lëvizjet ekonomike internacionale në një mjedis i cili është karakterizuar me borxhe publike të një mase të madhe, por kjo reflekton dukeshë nga fakti se se ekonomitë në zhvillim, si shtytës të rritjes ekonomike globale, do të vazhdojnë me rritje të tyre pa u shqetsuar shumë nga lëvizjet në shtetet me ekonomi të avancuara”³. Në këtë kontest, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) parashikoj një rritjen ekonomike me rreth 1.5 përqind e jo 2 përqind sa ishte mendimi i mëhershëm rreth rritjes dhe 5.6 përqind në ekonomitë në zhvillim⁴ nga 6.0% sa ishin parashikimi fillestarë.

³ Vendet që llogarites si të zhvilluara: SHBA, EU, Japoni, Britani e Madhe, Kanada


⁴ Listën e shteteve në zhvillim sipas klasifikimit të FMN-së

Treguesit me te rendesishem qe evidentohen si penguese të rritjes ekonomike në vende të caktuara dhe në nivel global, vlerësohen të jenë shkurtimet në shpenzime qeveritare si dhe kreditimi ende i ulët i sektorit financiar ndaj sektorit real. Edhe pse i domosdoshëm, ndikimi i tkurrjes së shpenzimeve qeveritare në kërkesën agregate dha efektet e saj në ngadalësimin e rritjes ekonomike. Ky konsolidim fiskal bëhet me qëllim të uljes së deficiteve buxhetore me qëllim të uljes së borxheve publike, madhesia e të cilave rrezikoi stabilitetin makro fiskal në vende te caktuara, me theks të veçante në vendet e ashtuquajtura periferike të euro zonës.

Po thuajse e njejta gjendje si gjatë peridhes se me hershme, ekonomitë në zhvillim paten një normë më të lartë të zgjerimit të aktiviteteve ekonomike, më saktësisht gjatë vitit 2013 fuqit ekonomike qe njihen si në zhvillim rriten me rreth 5.6% nga 5.3% sa vlerësohet të ishte rritja ekonomike përgjatë viti paraprak. Pra, nga ky kendeveshtrim shihet qarte se viti 2012, ku kishte një Bruto Prodhimi Vendor që pësoi rënie prej -0.4% kjo e ndikuar saktësisht nga ulja reale e BPV-së në Itali dhe Spanjë ndersa gjatë vitit 2013 euro zona kaloi në territor pozitiv, me një rritje të lehtë prej 0.2%.

Shtetet që posedojnë një ekonomi të zhvilluar vazhduan me një ngritje q.7 e kape shifren e rreth 1.5% nga vitit 2013 e tutje e qe paraqes ne figuren 6 .

Figura 6. Ecuria e Bruto Prodhimit Vendor në peridhen 2010-15



Burimi: WEO,FMN Tetore 2012

Po thuaj se edhe vendeve në Ballkanit Perendimore, kaluan një rrugë të njejte me vetet dhe ekonomitë e eurozonës, dhe kjo si pasoje e njëlidhje te fortë apo të një integrimin ekonomik të shkalles se parë që regjion une ka me vendet në europiane.

Pra, mesatarishte vendet e Ballkanit Perendimore u rriten me rreth 2.5% gjatë vitit 2013 dhe u përballen me një rritje të çmimeve prej rreth 3% në mesatare.

Bazuar në te dhenat e FMN-së nga të gjitha vendet erajonit, IRJ e Maqedonise realizoj një rritje me të lartë në vitit 2013 dhe atë ne masen rreth 3.5% ku kishte po ashtu një norme inflacion të rreth 2% e qe njihet si nje inflkacion i moderuar. Ndersa shkallën më e lartë në rritjen e çmimeve e perjetoj Republika e Serbise, dhe kishte nje norme te inflacionirku niveli i inflacionit rreth 4.5% e që njihet si nje mase relativisht shqetsuese per nje ekonomi që pretendon rimëkembje dhe rritje.

Tabela 1. Rritja e BPV-së dhe Inflacioni për vende të përzgjedhura, në %

	Projeksionet Makroekonomike						Inflacioni, në përqindje					
	Rritja e BPV, në përqindje											
	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	3.5	3.0	0.5	1.7	2.5	2.5	3.6	3.4	2.0	3.0	3.0	3.0
Bosnia dhe Hercegovina	0.7	1.3	0.0	1.0	2.5	3.5	2.1	3.7	2.2	2.1	2.2	2.4
Bullgaria	0.4	1.7	1.0	1.5	2.5	3.5	3.0	3.4	1.9	2.3	2.8	3.0
Kroacia	-1.4	0.0	-1.1	1.0	1.5	2.0	1.0	2.3	3.0	3.0	3.0	3.0
Maqedonia	2.9	3.1	1.0	2.0	3.5	4.2	1.5	3.9	2.0	2.0	2.0	2.0
Mali I Zi	2.5	2.5	0.2	1.5	2.0	2.0	0.7	3.1	3.4	3.0	3.5	3.4
Rumania	-1.6	2.5	0.9	2.5	3.0	3.3	6.1	5.8	2.9	3.2	3.0	2.9
Serbia	1.0	1.6	-0.5	2.0	2.5	2.2	6.2	11.1	5.9	7.5	4.5	4.0

Burimi: BQK 2014

3.5.2. Pasqyra makroekonomike në Kosovë

Përmirësimi i ekonomisë së euro-zonës jep sinjale pozitive edhe për rritjen ekonomike në Republikën e Kosovës. Pra kemi një rritjen ekonomike për periudhën e lartecekur kryesishtë duke u bazuar në ngritjen e konsumit, investimeve publike dhe nga diaspora dhe e eksportit në përgjithësi. Sipas ASK-së konsumi i ekonomive familjare u rrit mesatare ne nje norem reale prej 5.4% dresa konsumi per capita u rrit me 3.2% mesatarisht, gjithmonë duke u bazuar në projeksionet, apo censuset që nenkuptonë se popullsia rritet me një normë mesatare prej 1.6%.


Ashtu siq e përshkruam me lartë pra nje rol shumë domethenës në rritjen ekonomike gjatë periudhes se analizuar e dhane edhe investimet.

“Kontributi i investimeve në rritjen e BPV-së u ngritën gradualisht duke ngritur pjesëmarrjen e tyre në mbi 33% të BPV-së” thuhet në raportin e BQK-se për këtë periudhë. Investimet insdividuale nga qytetaret tanë u ngriten në pjesëmarrjen e tyre nga 21 perqind sa ishte në vitin 2011 në normen prej 21.8% të BPV-së në vitin 2015, pra kemi një rritje prej 0.8% që ne aspektin ekonomik ka nje domethnjete te madhe. Edhe, kontibuti I investimeve publike, ndonse kishte një rritje me të vogel gjatë kesaj periudhe ato vazhdojnë me një norm pjesëmarrje prej 11 perqind të BPV-së.

Rënia e eksportit të mallrave dhe shërbimeve u rrit me një normë mesatare prej 8.6% ndersa rritja e eksportit të përgjithshëm ishte ne pergjithesi si pasoj e eksporti i mallrave ndonse pjesmarrja e eksportit të shërbimeve në rritjen e eksportit të përgjithshëm ishte i konsiderueshëm. Saktesishtë eksporti i mallrave pati nje baze te mire te rritjes ate në një mesatare prej rreth 13.5% në vit, ndersa eksporti i shërbimeve u rrit me një normë mesatare reale prej 6.4 perqind. Ndersa importi i mallrave vazhdoi të ngritet me një normë prej 4% si rrjedhojë e ngritjes ekonomike, e po ashtu edhe ndryshimit të strukturës së saj, Në anën tjetër, duke u bazuar në trendin rënës të importit të shërbimeve në vitet e kaluara si dhe reduktimit të vazhdueshëm të funksioneve të organizatave të ndryshme ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe, importi i sherbimeve ra me një normë reale prej 0.4%.

Këto zhvillime reflektojnë në përmirësimin të bilancit tregtar gjatë periudhës 2013-2015 i cili në fund të periudhës arriti në -41.4% të BPV-së. Ndërkohë bilanci i mallrave dhe shërbimeve arriti në -34.6% në vitin 2015 nga -36.6% në vitin 2011. Bilanci i llogarisë rrjedhëse, si rrjedhim i këtyre zhvillimeve, u përmirësua nga -15.7% sa ishte në vitin 2011 në -14.9% në vitin 2015.

Figura 7. Rritja reale e BPV



Burimi: ASK 2014

Bazuar ne parashikimet e FMN-së⁵ për lëvizjet e cmimeve nderkombetare te ushqimit, naftes dhe produkteve tjera, të cilat kane rëndësi të madhe në import, niveli i cmimeve per vitin 2013 u rrit me 1.5% ndaj mesatares për periudhën 2013-2015 qe ishte 1.7%. Ky stabilizim i cmimeve vjen si pasoje e parashikimeve per renie te metejshme te cmimit te ushqimit shoqeruar, me renie te parashikuar te cmimeve te naftes.

Zhvillimet ne sektoret real ekonomike- Duke u bazuar në të dhënat e fundit për zhvillimet si në vend ashtu edhe në vendet e euro-zones si dhe në parashikimet e institucioneve të ndryshme ndërkombëtare për zhvillimet gjatë periudhës vijuese rritja ekonomike për vitin 2013 ishte 4.5% ndërkohë që mesatarja vjetore për periudhën 2013-2015 ishte rreth 5.2%. Rritja ekonomike përgjatë kësaj periudhe u mbështet nga investimet private, konsumi dhe eksporti në përgjithësi.

Parashikimet tregojne se konsumi i përgjithshëm u rrit me një normë reale mesatare prej 3.8%. Ky argument është bazuar në pritjet për rritjen e dërgesave nga diaspora që pritet të vije si rrjedhojë e rimëkëmbjës së ekonomisë së eurozonës, rritjen e të hyrave nga kompensimi i punëtoreve, vazhdimin e kompensimit të 20% nga procesi i privatizimit, ngritjen e pensioneve, vazhdimin e kreditimit të ekonomive shtëpiake, krijimin e vendeve të punës në bujqësi dhe në përgjithësi në rritjen e aktivitetit ekonomik në vend. Ndërsa, gjatë vitit 2013, konsumi i përgjithshëm u rrit me 4.1% në norma reale.

Sipase te dhenave te FMN se dhe te analizuara edhe nga Agjencia e Statistikat e Kosovese dhe Ministria e Financave, investimet private u ngriten me 7.7% në norma reale, përgjatë periudhës 2013-2015 ndërkohë që kjo rritje ne vitin 2013 ishte mbi 8 %. Rritja e investimeve private erdhi si rrjedhojë e efekteve indirekte të investimeve të mëdha publike si dhe investimeve të parapara Publiko-Private.

Realisht, investimet private u rriten si rrjedhojë e angazhimeve të Qeverisë për permiresimin e ambientit të të bërit biznes (përmes ofrimit të lehtësirave procedurale si dhe lehtësirave të ndryshme tatimore). Në mesin e iniciativave të reja vlen të permendet fakti i shkurtimit dhe eliminimit të një sërë procedurash për regjistrim të biznesve si dhe shkurtimit të procedurave për zhdoganim të mallit si ne rastin e importit, efektet e të cilave u ndjen gjatë vitit 2013 e tutje.

⁵ Projeksione te WEO, Prill 2012


Qeveria e Kosovës, gjatë vitit 2012, miratoi Ligjin mbi Lirimet Doganore, i cili hyri në fuqi nga fillimi i vitit 2013, përmes të cilit (përfshin një listë të gjerë të mallrave që përdoren si lëndë e parë për prodhim dhe makineri)u synua të përkrahen investimet private në Kosovë duke eliminuar tatimin doganor të inpueteve dhe makinerive që përdreshin direkt në procesin e prodhimit dhe qe nuk prodhoheshin në Kosovë.

Ndersa gjatë vitit 2013 e tutje u vazhdua me përkrahjen direkte te bujqesisë si nga ana e Qeverisë ashtu edhe donatorëve të ndryshëm, duke kontribuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë në rritjen e prodhimtarisë dhe investimeve në këtë sektor, rëndësia e të cilit është duke u rikthyer gradualisht në ekonominë e Kosovës. Krahas rritjes së investimeve në sektorin bujqësisë, u rrit edhe investimet në industrinë përpunuese, si rezultat i rritjes së vazhdueshme të bashkëpunimit dhe nderlidhjes në mes të kompanive prodhuese kosovare me kompani të njohura ndërkombëtare. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe u rriten investimet private, në sektorin e shpërndarjes së energjisë elektrike, si rezultat i zotimeve të investitorit privat pas privatizimit të këtij aseti publik.

Eksporti i mallrave dhe shërbimeve u rriten me një normë reale mesatare prej 9.4%. Duke u bazuar në faktin që kompanitë eksportuese në Kosovë janë ende në fazën e ngritjes së kapaciteteve të tyre dhe kane rriten eksportit, në vitet vijuese këto kompani rriten eksportin e prodhimeve të tyre dhe të shoqëruara me lehtësira tatimore të ngrisin edhe pjesëmarrjen në nivelin e përgjithshëm të eksportit. Historikisht, eksporti i mallrave ka qenë i lidhur ngushtë me lëvizjen e çmimeve botërore të metaleve, kjo për arsye se pjesa me e madhe e eksportit përbehet nga metalet si dhe produktet që si lëndë të parë përdorin metalin. Andaj, parashikimi për lëvizjen e çmimeve botërore te metaleve si dhe të kërkesës për metale të vendeve në të cilat Kosova eksporton do të vazhdoje të ketë ndikim, edhe pse në masë të zvogëluar, në lëvizjen e eksportit të mallrave në Kosovë. Si rezultat, eksporti i mallrave u rrit me një normë reale prej 13.5% gjatë periudhës 2013-2015. Ne anën tjetër, rimëkëmbja e vendeve të euro-zonës ndikoi pozitivisht edhe në eksportin e shërbimeve. Si rrjedhim, eksporti i shërbimeve u ngriten me një normë reale prej 6.6% në periudhën vijuese. Importi në Kosovë stimulohet nga lëvizjet në konsum, eksport dhe investime. Gjatë periudhës së vrojtuar parashikua se ngritje e vazhdueshme e importit te mallrave. Kjo ngritje njëkohësisht mbështetet edhe nga ngritja e importit të mallrave që shërbejnë si lëndë e parë dhe produkteve tjera investive sic janë ato të ndërtimtarisë. Si rrjedhim, importi u ngriten me 4.0% në normë reale përgjatë periudhës së vrojtuar. Pavarësisht ngritjes

parashikimeve për ngritje të theksuar të eksportit të mallrave, mbulueshmëria e importit nga eksporti mbetet e ulët, e tërë kjo si rrjedhojë e bazës shumë më të lartë të importit të mallrave. Ndërkohë, këto zhvillime paten ndikim të moderuar edhe në bilancin tregtar dhe rrjedhimisht në bilancin rrjedhës.

Figura 8. Inflacioni dhe parashikimet



Burimi: FMN, ASK, divizioni për politika makroekonomike, Prishtine 2014

Kjo rritje erdhi kryesisht si rezultat i faktorëve të natyrës kalimtare dhe nuk pati efekte të qëndrueshme. Në veçanti, kjo rritje rezulton nga ngritja e çmimeve botërore të produkteve ushqimore, ndikuar nga thatësitrat, dhe ngritja e çmimeve botërore të naftës. Duke marrë parasysh peshën e madhe që kanë këto produkte në shportën e konsumatorit, kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e inflacionit në ekonominë e Kosovës. Në vazhden e këtyre zhvillimeve, inflacioni vendor në fund të vitit 2012 ishte në nivel prej rreth 2.1%. (FMN:2014)

Parashikimet e fundit për ekonominë botërore treguan për një stabilizim të çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Si rrjedhojë, parashikimet për inflacionin në Kosovë sinjalizuan për një stabilizim të çmimeve përgjatë periudhës së parashikimit duke arritur mesataren vjetore prej 1.5% gjatë vitit 2013 ndërsa për periudhën 2014-2015 norma e inflacionit ishte në mesatare 1.9%.

Edhe Kosova është pjese e nje ndikimi të jashtem sa i perket çmimeve dhe kjo bazohet tek e: lëvizja e çmimeve vendore janë thellësisht të determinuara nga lëvizja e çmimeve të naftës dhe ushqimit në nivel global.

Realisht ky ndikim vjen si rezultat i peshës së lartë që këto dy grupe të produkteve kanë në shportën e konsumatorit vendor.

Parashikimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar flasin për një stabilizim të çmimeve në vitet vijuese, megjithatë, duhet pasur parasysh që këto të mira ndikohen thellësisht nga kushtet klimatike dhe lëvizjet gjeo-politike, faktore të cilët mund të ndryshojnë lehtësisht tendencën e lëvizjes.

Duke e bazuar ne keto indikacione mund te themi se: për vitet në vijim kjo kategori e financimit si përqindje e BPV-së vazhdoje te bjere gradualisht.

Ndikimi i tranzicionit ne privatizim, dhe anasjelltas, është i pashmangshem sepse i terë procesi që ka të bëjë me kalimin nga ekonomia e centralizuar apo gjysem e kontrolluar kalon ne ekonomine e hapur dhe pronesia është çelësi kyc i cili e përcakton formen dhe veprimtarine e një sistemi ekonomik.

Privatizimi është një nder hapat më të rëndesishme që kane të bëjnë më eliminimin e ekonomise së kontrolluar nga shteti dhe kalimin në ekonomine e lire ku prona shtetërore shnderrohet ne pronë private dhe si subjekt ka individin e jo shtetin .

3.6. PRIVATIZIMI DHE ORIGJINA E TIJ

Termi privatizim është përdorur ne literaturën ekonomike nga Piter Draker për ta zëvendësuar “denacionalizimin”. Privatizimi në kuptimin më të thjeshtë, nënkupton transferimin e pronës shtetërore apo shoqërore në atë private.

Kryesisht studimet mbi privatizimin si politikë ekonomike, e lidhin atë me programet e qeverisë Konservatore në Britaninë e Madhe të udhëhequr nga Margaret Thaçer në fund të viteve 70-te. Mirëpo në realitet qeveria e Republikës Federale Gjermane kishte shitur shumicën e fletë aksioneve te prodhuesit të automobilave Volksëagen në vitin 1961.

Edhe në Britaninë e Madhe, Partia Laburiste e kishte filluar privatizimin para Konservatorëve. Kështu që, qeveria Konservatore e Thaçerit ndoshta nuk ka qenë e para e cila ka zbatuar programin e privatizimit, por historikisht ka qenë më e rëndësishmja për shkak të përmasave të mëdha dhe mësimet që ka ofruar për pjesën tjetër të botës⁶.

Britania e Madhe në shekullin XX njihet si eksportuesja kryesore e këtij zbulimi të madhë e të emërtuar privatizim, këtë shembull shumë shpejt e kanë ndjekur edhe

⁶ Privatizimi në Kosovë - Isa Mulaj, www.kosova.com, Prishtinë

Gjermania, Franca, Italia dhe vendet e tjera të Evropës. Deri në fund të viteve të 90-te po thuaj se të gjitha vendet e Evropës me përjashtime të vogla në pjesen Juglindore për shkak të luftrave dhe konflikteve ndëretnike, të shkaktuara kryesisht nga shovinizmi serb.

Privatizimi paraqet transformimin pronësor nga prona shoqërore (publike, shtetërore) në atë private. Që nga fillimi i transformimit të ekonomisë në vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe vendeve nga ish – Bashkimi Sovjetik, nga socializmi drejt kapitalizmit, procesi i privatizimit është konsideruar komponent qendror i reformave. Ky proces filloi të zbatohet në vendet e lartshënuara që nga viti 1989. Në dallim nga këto vende, privatizimi në Kosovë filloi faktikisht në korrik të vitit 2002, me themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM). Pra, Kosova ka hyrë në këtë proces 13 vite me vonesë, dhe me specifika që nuk janë hasur në vendet tjera ish socialiste, kjo kjo bërë që shumica e ndërmarrjeve të jenë jashtë funksioni dhe të jente të shkatërruara nga lufta dhe pasojat e sajë.

Privatizimi sot është bërë fenomen mbarë botëror. Prej vitit 1990, ai u ka sjellë qeverive të ndryshme të ardhura prej më shumë se 700 miliardë dollarë sipas të dhënave të OECD-së (Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, institucioni më i njohur për të dhënat ekonomike). Prej vitit 1989 në Evropën Qendrore dhe Lindore janë privatizuar më shumë se 70 mijë ndërmarrje. Kosova ka 500 ndërmarrje shoqërore të cilat janë privatizuar ose janë në proces të privatizimi si dhe 55 ndërmarrje publike të cilat janë në procesin e korporatizimit.

Privatizimi është gjithashtu prioriteti kryesor në axhendën politike të Kinës, Indisë, si dhe i shumë ekonomive tjera në zhvillim.

KAPITULLI IV

4. POLITIKAT FISKALE – ASPEKTI MAKROEKONOMIK

4.1. ASPEKTI MAKROEKONOMIK I TEORIVE NË POLITIKAT FISKALE

Politika fiskale, posacerisht politika tatimore është pjesë jashtëzakonisht e rëndësishme e qendrueshme dhe qeverisjes së Kosovës si dhe rritjes ekonomike, pasi mjetet e politikës monetare nuk mund të përdoren për shkak të pranimi të euros si monedhë e vendit. Për të ndërmarrë investime të mëdha dhe për të ofruar shërbime vitale publike, Kosova ka nevojë për një sasi të konsiderueshme të burimeve, të cilat mund të arrihen pjesërisht përmes një politike të përshtatshme fiskale (BB 89195 XK).

Kështu, sistemi tatimor i Kosovës është pjesë e pandashme e ekonomisë, pasi mund të rrisë të hyrat për shpenzimet qeveritare

Rregullimi makro-ekonomik në ekonominë e Kosovës do të bazohet në qëllimet themelore të rregullimit makro-ekonomik e që janë:

1. Rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik dhe eliminimi i vatrave të recesionit
2. Konsolidimi dhe ekuilibri ekonomik në kushtet e tranzicionit
3. Krijimi dhe stabilizimi i barazpeshës ekonomike në mes të efikasitetit dhe zhvillimit social
4. Stabiliteti monetar, buxhetor, fiskal
5. Konsolidimi dhe ekuilibri i bilancit tregtar, të pagesave dhe servisimi i borxheve
6. Krijimi i ekuilibrit zhvillimor dhe ekologjik.

4.1.1. Llojet dhe teoritë e politikave fiskale

Mbeshtetur në literaturën e fundi, që kam konsultuar gjatë nderimit të këtij disertacioni arrij në konkluzion se vende të ndryshme aplikojnë politika të ndryshme me qëllim të realizimit të qëllimeve të veta, për një qëndrueshmëri financiare dhe një zhvillim ekonomik solid.

Megjithatë edhe pse kanë dallime në politika kryesisht bazohen në këto politika përgjithësuese:

1. Politika e konkurrencës
2. Politika e liberalizimit
3. Politika monetare dhe kreditore
4. Politika buxhetore dhe fiskale
5. Politika e çmimeve
6. Politika sociale

Secila nga këto politika ka, lidhje direkte apo indirekte me politiken fiskale që ndërtohet nga vendi, specifikisht.

Kur e dimi se ndoshta në një ekonomi tregu ku kush është konkurrenca atëherë ky kriter është bazë e çdo ekonomie. Po ashtu si politike orjentuese zhvillimore duhet ndërhyrë që dhe tregu jonë i brenshëm orjentimisht duhet të bazohet në politiken që nxitë rregullimin e monopoleve natyrore, administrimin e mirë të pronës publike, rregulloni në operputhje me standardet e BE procesin e falimentimit apo mbylljes së bizneseve, si dhe duke ndërtuar politika strikete sa i kufizimeve buxhetore dhe financiare. Gjithmone duhet të i kushtohet një kujdes i veçantë edhe konkurrencës së jashtme, respektivisht ndikimi i saj në ekonomi.

Politika e liberalizimit, politika monetare dhe kreditore, politika buxhetore dhe fiskale, politika e çmimeve dhe politika sociale janë po ashtu kriter bazë i një stabiliteti financiarë, dhe se Politikat fiskal duhet të plotesojnë njera trjetren me qëllimin e vetëm që vendi të ketë një stabilitet financiarë dhe një zhvillim ekonomik.

4.1.2. Politika fiskale – praktika dhe arsyshmerija

Me paraqitjen e tatimeve janë shprehur edhe mendime,opinione të ndryshme mbi arsyetimin e mbledhjes së tatimit. Kjo ka ndodhur për faktin se subjekti ekonomik ose personi fizik duke paguar tatimin e ka zvogluar potencialin e vet ekonomik ,duke penguar zhvillimin normal ekonomik.

Zvogelimi i potencialit ekonomik të obligusit me rastin e pagimit të tatimit e cila paraqitet si barrë shtron nevojën e gjetjes së rrugëve të ndryshme për të shmangur kësaj barre.

Autore të ndryshëm, në kohera të ndryshme janë munduar të japin kontributin e tyre për të ardhur deri te një pëpëgjigje sa më të saktë mbi arsyshmerine e mbledhjes së tatimit.

Mirpo kjo barrë ka qenë si e caktuar ashtu edhe e arsyetuar ndryshe varsisht nga sistemet ekonomike-shoqerore të një vendi.

Logjika dhe arsyesheria e tatimit si problematike komplekse është trajtuar nëpër kohë të ndryshme jo vetëm nga teoriciene financiare,te ekonomistet e gjerë por edhe nga filozofë,eksperte të së drejtës për çeshtje kushtetuse,teologet.Teologët në mënyrë të vecante trajtuan këtë çështje,si p.sh Tom Akuinin (1226-1274) i cili në punimin e tij mbron mendimin: A mundë të ketë plaçkë pa mekat? Përgjegjet se kjo është e mundur vetëm atëherë kur mendimtari nuk mund të plotësoje nevojat vetëm nga të hyrat e veta.Teologët mbeshtetjen e shtetit që ta caktoje tatimin e arsyetojnë në bazë të maksimës së njohur Mbretit ajo qe i takon-mbretit-zotit ajo qe i takon zotit. Si rezultat i angazhimit të shumë autorëve,ekonomisteve,financiereve,filozofeve,teknologeve si dhe autorëve të tjerë,sot në botë kemi literature dhe teori të shumta e të ndryshme që e arsyetojnë këtë çështje.

4.1.3. Teoritë më të rëndësishme të mbledhjes së tatimeve në politikën fiskale

Në bazë të shkencës mbi financat, e cila ka mbledhur shumë terori mbi caktimin dhe mbledhjen e tyre si dhe duke marrë për bazë ngjashmëritë e shumta që egzistojnë në mes të këtyre teorive , do të ndalem në disa më kryesore në kuptimin e rëndësisë së trajtimit e këto janë:

1. Teoria e të fortit (e fuqisë)
2. Teoria e çmimit
3. Teoria e sakrificës
4. Teoria organike
5. Teoria e riprodhimit të tatimeve.

Teoria e të fortit-fuqisë- Sipas kësaj teorie tatimin e caktojnë dhe e mbledhin të fortit, individë ose sundues ata të cilët dalin sundues në front. Ata mund ta caktojnë vetë shumën e tatimit mbi të sunduarit. Ata mund t'ua marrin edhe jetën të mundurëve, pa pyetur fare. Kjo teori është aplikuar në kohën e vjetër e deri diku edhe në mesjetë.

Sipas kësaj teorie shteti, me fuqinë e vet pushtetin, tatimin e cakton sipas dëshirës pa e pyetur fare qytetarin dhe këtë të drejtë e arsyeton në fuqinë e vet. Vlen të theksohet se për këtë çështje nuk është e nevojshme as pëlqimi i qytetarit, dhe as arsyetimi para tij

Teoria e çmimit- Sic dihet shteti me mekanizmat e tij kryen një varg shërbimesh në dobi të qytetarëve të vet, ndërsa për të bërë këtë atij i duhet një shumë e caktuar e shpenzimeve e për mbulimin e tyre ai cakton tatimet me anë të të cilave i mbulon shpenzimet e krijuara. Sipas kësaj teorie shumën e tatimit mbi obliguesin është e mvarur nga shpenzimet e shtetit ose është çmim që obliguesi tatimor i paguan shtetit për shërbimin e bërë.

Ky çmim do të jetë më i lartë apo më i ulët mvarësisht nga ajo se a do të jenë më të larëta apo më të ulëta shpenzimet e shtetit për shërbimin e ofruar. Kjo teori është mbizotëruese në kohën e kapitalizmit liberal.

Sipas kësaj teorie shteti në treg paraqitet si çdo subjekt tjetër i cili ofron shërbime për të cilat nën kompensimin adekuat ose thënë më së miri çmimin.

Ndër përfaqësuesit kryesore të kësaj teorie numërojmë një varg teoricienësh: Volteri, A. Smithi, D. Rikardo, Ruso, Monteskye, I. S. Mollit etj. Si variant të teorisë së çmimit dallohen:

1. Teoria e sigurimit
2. Teoria e shfrytëzimit
3. Teoria e riprodhimit të tatimeve
4. Teoria e sakrificës
5. Teoria e organike

1. **Teoria e sigurimit**-Sipas variantit të parë shteti i ngjan një kompanie të sigurimit, ndërsa obliguesi si i siguruar në atë kompani nga rreziqet e ndryshme dhe i cili varësisht nga niveli i sigurisë që i ofrohet paguan edhe çmimin.

Mirëpo kjo teori ka edhe të metat e veta sepse nuk mund ti përgjigjet disa pyetjeve vetëvetiu sepse organet e shtetit ruajnë jetën dhe pasurinë e qytetarit pasi ato nuk e sigurojnë atë, sepse ajo pasuri përkundër ruajtjes nga organet shtetërore mund të vidhet ose keqëpërdoret. Këto organe nuk paguajnë kurrfarë kompensimi për të por vetëm ndjekin kryerësin e veprës. Ndërsa kompania e sigurimit e paguan dëmin e bërë.

2. **Teoria e shfrytëzimit** – Arësyetimi i pagimit sipas kësaj teorie qëndron në faktin se, shteti me mekanizmin e vet siguron vendin, ligjin, shëndetësinë etj. të qytetarëve për të cilën ata duhen të paguajnë një çmim në formë të tatimit. Por ky çmim nuk është i njëjtë për të gjithë për të gjithë sepse pagesa e tij mvaret nga niveli i të ardhurave që do të thotë: sa më të madhe qytetarët ta kenë pagën aq më shumë do të paguajnë tatimin, sepse pasuria më e madhe dhe të ardhurat më të mëdha u mundësojnë edhe shfrytëzimin më të madh të këtyre shërbimeve.

3. **Teoria e sakrificës**- Me kalimin në kapitalizmin monopolist doli nevoja e ndërrimit të raporteve të shtetit dhe obliguesit. Këtu kemi konkurrencën e kufizuar dhe forcimin e shtetit, kjo teori ndryshe njihet edhe si teori e obligimit.

Sipas teoricienëve të kësaj teorie tatimi nga qytetari duhet paguar sipas nevojës së qytetarit për shtetin edhe pse kjo nuk është absolute për arsye se ka edhe në mesin e tyre që thanë se sakrificat (obligimi) duhet paguar i njëjtë nga të gjithë, të tjerët thonë se të gjithë duhet të paguajnë % të njëjtë nga baza e vet si dhe sakrificë minimale.

Përfaqësues më të njohur të kësaj teorie janë: Ehenbergu, Milli, Carvesi, Edgervorthi, Pigou.

4. **Teoria organike** - Arsyeshmëria e pagesës së tatimit rrjedh në bazë të lidhshmërisë së shtetit dhe qytetarit. Këtu shteti paraqitet figurativisht si trup ndërsa tatimi si gjobë e domosdoshme për ushqimin e këtij trupi. Dihet se trupi nuk mund të lëvize pa gjobë ashtu edhe shteti pa inkastru një shumë të caktuar të tatimeve për mbulimin e nevojave të domosdoshme.

E metë e kësaj teorie është se nuk jepet përgjigje mbi shumën e tatimeve të nevojshme e të domosdoshme për funksionimin e shtetit.

Përfaqësuesi më i njohur i kësaj teorie është gjermani Albert Shefle.

5. **Teoria e riprodhimit të tatimeve**- Në kapitalizmin liberal vërehet një përzierje më të madhe të shtetit në jetën ekonomike të pjestareve të vetë-qytetareve. Ky rol solli teorite mbi arsyetimin e mbledhjes së tatimeve .Sipas kësaj teorie arsyetimi i mbledhjes së tatimeve gjendet në shpenzimin e shumës së mbledhur për qëllime të rritjes ekonomike ,apo rritjes së të ardhurave për kohë të baronit e cila do të rezultojë më pas me një rritje të përgjithshme ekonomike të standartit të jetësës së qytetareve. Që të arrihet te kjo rritje,shuma e tatimeve të mbledhura duhet të investohet nga ana e shtetit vetëm në ato veprimtari të cilat mundësojnë rritje ekonomike.E metë e kësaj teorie është se ajo injoron plotësimin e nevojave të shtetit të cilat nuk mundësojnë rritje të zhvillimit ekonomik e që për funksionimin e shtetit janë të domosdoshme si investimi në ushtri, polici, gjykata etj. Përfaqësues të kësaj teorie janë: Lorenc Fon Shtajni, Adolf Vagmenri etj.

4.1.4. Sistemet e politikave fiskale në ndarjen e tatimeve

Në zhvillimin ekonomik të shpejtë,në shtetet e forta ekonomike hasim në shumë forma të ndryshme të shfaqjes së tatimeve.Përfshirja e plote e mënyres së paraqitjes së tyre së bashku me studimin dhe analizat është pothuaj e pamundur gjatë një punimi shkencor por do të ndalemi te klasifikimi i tyre më i arsyshëm.Ndarja e tatimeve sipas cilësive të përbashkëta është jo vetëm në interesin shkencor por edhe në atë praktikë.E rëndësishmja gjatë ndarjes është që kjo të bëhet në bazë të elementeve të qarta dhe më kryesore,dhe

lidhëshmërise që kanë tatimet që i takojnë grupit të caktuar. Kemi shumë forma të ndarjes së tatimeve por ndarja më e njohur është:

1. Tatimi direkt dhe indirekt
2. Tatimi subjektiv dhe objektiv (personal dhe real)
3. Tatime sintetike dhe analitike
4. Tatime e përgjithshme dhe destinuese
5. Tatime katastroale dhe tarifore
6. Tatime të supozuara dhe faktike
7. Tatime sipas vlerës dhe specifike
8. Tatime të funduara dhe të pa funduara
9. Tatime të rregullta dhe jo të rregullta
10. Tatime themelore dhe plotesuese
11. Tatime të participimit dhe të kuotës
12. Tatimet qendrore dhe lokale.

Kriteri i ndarjes së tatimeve direkte dhe indirekte- Kriteri i ndarjes së tatimeve direkte dhe indirekte meriton një kujdes të madh sepse ky është problemi më i madh me të cilin ndeshet shkenca e financave sot .Për këtë çështje janë dhënë mendime të shumta të cilat nuk mund të themi se ia kanë dalë ende deri te një përfundim preciz dhe i saktë. Ka edhe prej tyre që mund të themi se janë të paqëndrueshëm për kah mënyra dhe e trajtimit dhe përfundimeve që nxjerrin mbi këtë çështje.Bazë për ndarjen e tatimeve si direkte dhe indirekte është fakti se a është tatimi i bartur në dikë tjetër ose jo.Tatime direkte janë ato të cilat nuk barten në dikë tjetër ,ndërsa indirekte janë ato të cilat barten. Teoricienet të cilët mbrojnë këtë teori janë : Vambani,I. S. Milli, A. Vagneri, B. Molli etj.

1. Tatimet subjektive dhe objektive - Tatimet tek të cilat nuk merret parasysh fuqia ekonomike e obliguesit tatimor jane tatime subjektive ose personale në kuptimin e gjerë. Si shembull të ketyre tatimeve kemi taksën ushtarake për kokë. Te tatimet subjektive shumica e pagesës së tatimit caktohet në bazë të forcës ekonomike që posedon obliguesi tatimor por përveç kësaj element tjetër i rëndësishëm është p.sh.mosha e obliguesit tatimor,gjendja martesore,numri i anëtareve të familjes që ka obligim të mbaje,gjendja shendetesore etj.

Tatimet objektive(reale) janë ato të cilat gjatë caktimit të madhësisë së tatimit nuk merret për bazë personaliteti i subjektit si obligues tatimor. Këtu cilësi të personale janë jo të rëndësishme.

Sipas këtij lloji ose grupi të tatimit madhësia e tatimit caktohet nga rezultatet që arrihen dhe ndarjes nga veprimtaritë tjera. Ky lloj i tatimit mund të themi se është më real për veprimtarinë e caktuar por jo edhe me gjendjen më reale të obliguesit tatimor në kuptimin e gjërë të fjalës .

2. Tatimet sintetike dhe analitike -Kjo ndarje ka ngjashmëri të madhe me atë të lartëpërmendur(personale dhe reale)Ajo që dallonë është se në tatimet sintetike nuk janë përfshirë edhe tatimet subjektive në kuptim të ngushtë.

3. Tatimet e përgjithshme dhe të vecanta apo të destinuara- Ndarja në këto tatime është bërë nga vetë fakti se destinimi i tatimeve është bërë më parë(para inkasimit)apo nuk është bërë fare, d.m.th. caktimi i shumës së obliguesit tatimor është bërë për plotësimin e nevojave të përgjithshme, pa i determinuar fare ato.Për të sqaruar më mirë tatimet e destinuara janë ato të cilat mblidhen me qëllim të caktuar dhe destinohen për qëllim të caktuar më parë p.sh: tatimet që inkasohen nga derivatet e naftës, mirëmbajtjen e tyre etj. Ndërsa tatimet e përgjithshme apo të destinuara caktohen, mblidhen dhe destinohen sipas nevojave të shtetit, të cilat i cakton ai, pra këto tatime shpenzohen pa u diktuar fare nga të hyrat.

4. Tatimet kadastrale dhe tarifore - Ndarja e tyre bëhet në bazë të teknikës së mbledhjes.Tatimet kadastrale, caktohen në bazë të librave kadastrale, p.sh. tatimi mbi pronën, fakteve të tjera juridike të ofruara si dëshmi të nevojshme për këtë çështje. Këto të dhëna iu shërbejnë si bazë e mirë e vërtetuar punëtorëve të autorizuar për të determinuar shumën e tatimeve. Vlen të theksohet se rrënjët e këtij lloji të tatimit janë tejet të vjetra në aspektin e kohës.

Tatimet tarifore- caktimi i tatimeve tarifore në këtë rast bëhet në bazë të elementëve që përmban tarifa (fatura).

Në rastet më të shpeshta për caktimin e tatimit përdoret tarifa e mallrave në qarkullim dhe tarifa doganore.

5. Tatimet e supozuara dhe faktike - Një ndarje e tillë është bërë nga fakti se organet tatimore për caktimin e madhësisë së shumës së obliguesit tatimor marrin për bazë presupozimin së obliguesi tatimor ka mundur të realizojë këtë apo atë shumë të caktuar të

mjeteve gjatë realizimit të veprimtarisë dhe në bazë të saj më pas është caktuar tatimi. Ndërsa tatimet faktike janë tatime të bazuara në fakte të caktuara që ka pasur një subjekt në një periudhë kohe të caktuar dhe në bazë të cilit i është caktuar shumën e tatimit.

6. Tatimet sipas vlerës dhe specifike- Kjo ndarje është bërë sipas llojit në bazë tatimore kur dihet vlera e objektit të tatimit. Keto tatime janë lehtë të realizueshme që do të thotë që në këtë rast tatimi caktohet sipas vlerës, ndërsa tek tatimet specifike ka më shumë vështirësi gjatë caktimit të tyre. Ato kryesisht caktohen në bazë të njësis që merret si p.sh njësia e gjatësisë, metri, numri i kuajfuqive të automjeteve, sipërfaqja e tokës, ari, hektar, klasa e kualitetit të tokës dhe në bazë të kësaj mase caktohet shumën e obliguesit tatimor .

7. Tatimet e funduara dhe të pafunduara - Kjo formë e të hyrave historikisht ka qenë e paraqitur në formë më ekstreme në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX, atëherë kur ekonomia ishte në hapat e parë dhe të hovshëm në mes të dy koncepteve bazë të ekonomisë ajo kapitaliste dhe sistemet socialiste.

8. Tatimet e rregullta dhe jo të rregullta- Kjo ndarje është bërë në bazë të kohës së caktimit dhe të realizimit të tyre. Dihet se tatimi i të hyrave bëhet në bazë të një plani të caktuar të nevojave të caktuara. Për plotësimin e nevojave të rregullta inkasohen të hyra të rregullta apo tatime të rregullta mirëpo ka raste të jashtëzakonshme si gjatë fatëkeqësive të ndryshme natyrore dhe shoqërore si: tërmetet, breshëri, luftërat, çrregullimet në vend, e për tejkalimin e tyre duhen mjete shtesë të jashtëzakonshme. Ndaj për mbulimin e tyre shteti në mënyrë jo të rregullt që do të thotë që përveç tatimit të rregullt obliguesit tatimor i caktohet edhe një shumë e caktuar për t'i mbuluar nevojat .

8. Tatimet themelore dhe plotësuese- Kjo formë e ndarjes së tatimeve bëhet bazuar në faktin se egzistojnë shumë tatime si burime të nevojshme për plotësimin e nevojave të shtetit për disa prej tyre janë themelore, bazike e disa janë plotësuese p.sh. vetëm disa tatime plotësojnë më se 60-70% të nevojave të shtetit, ndërsa shumë të tjera plotësojnë 20-30%. Ndaj kjo formë e tatimit është bërë në bazë të peshës që kanë tatimet e caktuara në kuptimin e mbushjes së arkës së shtetit.

10. Tatimet e reparticipimit dhe të kuotës - Kjo ndarje është bërë në bazë të mënyrës së ndarjes së barrës së tatimeve.

11. Tatimet e participimit – shteti më parë cakton nevojat të cilat duhen mbuluar për një periudhë kohe të caktuar, e më pas përgatit planin e plotësimit të këtyre nevojave në baza territoriale apo nëpër njësi komunale. Kjo barrë dihet se nuk mund të jetë e njëjtë per

secilën komunë për faktin se fuqia e tyre ekonomike është e ndryshme. Ndaj kujdes i vecantë këtu i duhet kushtuar mënyrës së shpërndarjes së tatimeve që ajo të jetë e drejtë. Këto tatime gjatë historisë kanë qenë jo të drejta ndaj është më praktike caktimi i tatimeve në bazë të kuotës ku obliguesi tatimor e di qysh më parë shumën e tatimit që do të paguaje dhe kjo formë është më e drejtë.

12. Tatimet qëndrore dhe lokale - Këto tatime marrin emrin qëndrore ose lokale varësisht nga fakti se kush e bën caktimin e tatimit, e bëjnë organet shtetërore apo lokale. Tatimet qëndrore- gjatë caktimit të tatimit duhet të kihet parasysh fakti se disa tatime janë kompetencë e niveleve më të larta p.sh. të Kosovës e këto i cakton MEF e të cilat caktohen në bazë të kriterëve të njëjta. Meqënesë i cakton niveli qëndror si të tilla quhen tatime qëndrore. Por përveq tatimeve të nivelit qëndror kemi edhe tatime të nivelit lokal apo komunal për caktimin e të cilave është niveli lokal ndaj si të tilla quhet taime lokale.

4.2. PROBLEMI I ZGJEDHJES SË OBLIGUESIT TATIMOR

Padyshim ndër vështirësitë më të mëdha që has shteti është identifikimi dhe zgjedhja e obliguesit tatimor apo thënë më mirë identifikimi i aftësive të obliguesit tatimor që më pas të caktojë barrën në bazë të kësaj aftësie. Obliguesi tatimor mund të paraqitet si person fizik dhe juridik si p.sh. te obliguesi tatimor fizik paraqitet problemi se kush duhet të merret si obligues individ ose grupi (bashkëshortët, familja) ndërsa të personi juridik çështja më e rëndësishme që shtrohet është arsyetimi i tatimit.

Te personi-obliguesi fizik ky problem nuk është zgjidhur në mënyrë unike por në këtë drejtim ka pasur harmoni varësisht nga sistemi i caktuar i tatimeve. Me rastin e përcaktimit të obliguesit tatimor ka mendime të ndryshme p.sh. idhtarët e zgjedhjes së tatimit sipas së cilës obliguesi duhet të jetë familja dhe jo individ theksojnë se obligimi tatimor duhet bërë në bazë të aftësisë. Kur bëhet obligimi tatimor në bazë të familjes kjo vetëvetiu tregon se ky obligim nuk caktohet vec e vec për çdo anëtar por këtu mbledhet aftësia e familjes si tërësi duke pasur për bazë edhe shpenzimet e tyre të jetës dhe më pas nxirret aftësia tatimore e personit fizik .Në këtë rast familja më pas tatimohet, ndërsa një pjesë e ekspertëve shkojnë skajshmërisht në favor të asaj që secili të tatohet sipas aftësive që posedon, është fjala pra për tatim individual për person.

Po qe se e shikojmë tatimin e personit fizik si bashkëshort historikisht në vendet ku është paraqitur vërejmë se jo rrallë herë caktimi i tatimit për bashkëshortësi ka paraqitur probleme të caktuara në mes të bashkëshortëve, kjo për faktin se me rritjen e bazës tatimore është rritur edhe përqindja e tatimit, ndanjëherë deri në atë shkallë sa që e ka eliminuar nevojën e punës për njërin bashkëshort, ndërsa tek përcaktimi i obliguesit tatimor si person juridik.

Këtu problemet më të mëdha për organet tatimore paraqiten të kësaj natyre p.sh si të identifikohet më saktësisht fuqia ekonomike e personit fizik. Gjithashtu rëndësi e vecantë i kushtohet madhësisë së përqindjeve tatimore të aftësisë së obliguesit tatimor si dhe aplikimi i lirive lehtësuese të ndryshme të personit juridik p.sh. sa duhet të jetë kjo madhësi.

Si përfundim mund të themi se identifikimi, zgjedhja e obliguesit tatimor është problem i cili meriton trajtim të vecantë dhe tejet të rëndësishëm në çdo sistem tatimor.

4.2.1. Metodatat e përcaktimit të bazës tatimore

Për organet e sistemit tatimor një problem të vecantë e tejet relevant paraqet përcaktimi i bazës tatimore. Nga baza tatimore, lehtësimet dhe përqindjet e caktuara varen ngarkimi tatimor pas së cilit rëndësi duhet kushtuar fuqisë së mbetur të obliguesit tatimor. Baza tatimore shërben për llogaritjen e tatimit ndaj duke e njohur këtë këtë problem i kushtohet vëmendje e vecantë jo vetëm teorike por edhe praktike. Kjo bazë caktohet në të shumtën e rasteve në mjete monetare por ka raste kur caktohet edhe në forma të mallit. Problem i vecantë te përcaktimi i bazës është përcaktimi i lartësisë së saj. Njotim shumë metoda të përcaktimit të bazës tatimore e këto janë:

1. Metoda e indikacionit
2. Metoda direkte
3. Metoda indirekte
4. Metoda zyrtare
5. Metoda e pasifikimit

Metoda e indikacionit-caktimi i tatimit sipas kësaj metode bëhet në bazë të fakteve që mund të vërehen lehtë prej së jashtmi. Kjo metode ka shërbyer për caktimin e bazës tatimore në shekullin XIX por shumë rrallë e takojmë edhe sot. Caktimi i kësaj baze tatimore bëhet përmes dyerve, dritareve, sipas gjatësisë së objektit të tatimit etj. Por kjo

metodë se është e njëanshme gjatë përcaktimit të fitimit për arsye se nuk i kanë edhe faktet e brendshme relevante të domosdoshme për të ardhur deri te një konstatim i qëlluar ,dhe ndryshe njihet si metodë automatike .

Metoda direkte - Sipas kësaj metode baza tatimore përcaktohet në bazë të të dhënave që ia ka paraqitur vetë organi financiar obliguesi tatimor në formë të librave, evidencave.

Ky obligim për obliguesin buron nga ligji meqë në të është paraparë që të mbajë evidencë për fuqinë ekonomike që posedon dhe ta paraqesë atë në formë pasqyre para organit kompetent të sistemit tatimor.

Metoda indirekte - Të dhënat bazë organet kompetente të sistemit tatimor mund t'i sigurojë jo vetëm nga obliguesi tatimor por edhe nga ndonjë person i tretë, e të cilat janë mjaft të rëndësishme për caktimin e madhësisë së tatimit p.sh. këtë punë mund ta bëjë banka të cilës ky obligim mund t'i caktohet me ligj, pastaj gjykata, ndonjë organ administrativ ose person i tretë qoftë furnizuesi ose blerësi i subjektit të caktuar juridik.

Metoda zyrtare - Kjo metodë përdoret atëherë kur organi financiar i sistemit tatimor nuk iu beson të dhënave të ofruara nga subjekti juridik apo fizik por as nga personi i tretë. Atëhere bazën tatimore ta caktojë organi kompetent, inkasant tatimor i cili vlerëson këtë përmes njohurive që disponon. Kjo metodë ndryshe quhet edhe si metoda administrative.

Metoda e parafillimit - Kjo metodë përdoret atëherë kur mungojnë të dhënat nga subjekti i caktuar mbi veprimtarinë nga personi i tretë, atëherë kryhet vlerësimi në këtë mënyrë:

Për shembull: për caktimin e bazës së një subjekti të caktuar merret një subjekt i cili ushtron një veprimtari përafërsisht në kushte të njëjta dhe në vend të njëjtë dhe në bazë saj caktohet baza e tatimit të këtij subjekti.

4.2.2. Parimet e tatimit dhe evolucioni i tyre në shtetet bashkëkohore

Roli dhe rëndësia e mbledhjes së tatimeve qëndron në faktin se përmes tyre shteti krijon të hyrat e nevojshme të cilat mundësojnë kryerjen e shumë nevojave nga kompetenca e tyre si në aspektin kulturor, social, ekonomik, ushtarak, politik, demografik etj. Në anën

tjetër duke marrë një shumë të caktuar të mjeteve nga subjektet fizike dhe juridike atyre i'u zovogëlohet për atë shumë fuqia ekonomike e cila për ta është një situatë e dhimbshme.

Ndaj kjo situatë i ka imponuar shkencës mbi financat detyrën që t'i përcaktoj rregullat- parimet e caktuara të cilave duhet tu përmbahen ne rastin e aplikimit të masave të politikës fiskale.

Shkenca mbi financat ka evluar vazhdimisht dhe është e kuptueshme se edhe këto parime kanë qenë temë e shqyrtimit dhe e ndryshimeve të vazhdueshme me qëllimin e vetëm që të jenë sa më lehtë të aplikueshme dhe sa më pak të dhimbshme për subjektet e ndryshme fizike dhe juridike.

Disa parime nuk janë të përputhura në mes tyre me parimet tjera në të cilat bazohet sistemi tatimor.

Autorë të ndryshëm kanë dhënë mendime të ndryshme mbi këtë çështje. Vlen të përmenden vetëm disa prej tyre: Turgot, Vauban, Smithi i cili bënë studimin më të vecant.

Mirëpo në studimin tim do të ndalem në parimet dhe klasifikimin që bëri Vagneri dhe këto parime sipas tij do t'i elaborojmë më detalisht:

1. Parimet financiare-politike të tatimit
2. Parimet ekonomike-politike të tatimit
3. Parimet socialo-politike të tatimit
4. Parimet tatimor-teknike të tatimit

1. Parimet financiare-politike të tatimit - Në raport me parimet tjera Vagneri i'u jep përparësi absolute parimeve financiare-politike dhe sipas tij të gjitha parimet e tjera duhet ti nënshtrohen këtyre parimeve. Rëndësia e këtyre parimeve është e madhe se për të realizuar parimet tjera të poshtëpërmendura në radhe të parë duhet mbushur arka e shtetit e cila mundëson dhe garanton realizimin e parimeve te tjera. Në sistemet e meparshme ka qenë parimi i vetëm ai i financimit i cili është ruajtur dhe është respektuar.

Ky parim edhe pse ka qenë i tillë në sistemin skllavopronar, feudal dhe kapitalizimin liberal nuk e ka këtë ndikim dhe fare pak dallohet nga parimet e tjera. Këtë ndikim i'a ka humbur koha, zhvillimi ekonomik, shoqëror e teknologjik nëpër të cilin ka kaluar shoqëria.

Kemi dy parime financiare politike:

- a) bollshmëria (mjaftueshmëria)
- b) përshtatëshmëria (elasticitetshmëria)

a) Bollshmëria (mjaftueshmëria)- Sipas këtij parimi shteti duhet të mbledhë mjete të mjaftueshme, të bollshme, të cilat bashkë me të hyrat e tjera që shteti i inkastron si mjete për plotësimin e nevojave të tij, duhet të sigurojë funksionimin normal të mekanizmave të tij.

b) Përshtatëshmëria (elasticitetshmëria) - Eshte mundësia e sistemit tatimor për tju përshtatur sa më shpejt dhe me sukses ndryshimeve në lartësinë e shpenzimeve shtetërore. Kjo mundësi ka të bëjë me sistemin në tërësi. Rritja e vazhdueshme e nevojave të shtetit dhe lindja në vazhdimësi të tyre, parashtron nevojën për rritje të vazhdueshme të të hyrave, e cila është kusht për plotësimin e tyre. Për këtë është e nevojshme përshtatshmëria dhe elasticiteti ndërmjet shpenzimeve dhe nevojave për mjetet. Respektimi i një parimi i tillë krijon parakushte të nevojshme për një funksionim normal të shtetit.

2. Parimet ekonomike-politike të tatimit- Me qëne se pagesa e mjeteve nga ana e subjektit fizik dhe juridik, si obligim për plotësimin e nevojave të shtetit zvogelon fuqine ekonomike të atij që e paguan këtë, atëherë ky parim duhet shqyrtuar dhe analizuar me një kujdes të vecantë, sidomos ndaj masës apo kufirit të sipërm të ngarkesës i cili pengon funksionimin normal të subjektit që paguan dhe ndikon në mënyrë drastike në standardin jetësor, dhe rregullime ekonomike të padëshiruara për sistemin në tërësi. Sistemi tatimor, përmes instrumenteve të tij mund të ndikojë në luftën kundër inflacionit, rregullimeve në treg në vendosjen e ekuilibrit të në ekonomi, në stimulimin e eksporti, apo i importit, mbron prodhimet e vendit etj.

Kemi dy parime kryesore ekonomike-politike:

1. Zgjedhja e burimit tatimor
2. Zgjedhja e formës tatimore

Zgjedhja e burimit tatimor - Duhet mbuluar nevojat e shtetit përmes inkasimit të tatimeve dhe burimeve tjera të cilat shërbejnë si të hyra. Por bashkë me këtë i duhet kushtuar kujdes i vecantë zgjedhjes së burimit tatimor. Sipas Vagnerit mund dhe guxohen të tatohen vetëm ato burime të cilat përsëriten vazhdimisht. Në këtë rast duhet t'i kushtohet kujdes i vecantë ngarkimit tatimor dhe përmasave të tij. Është e vërtetë se ky kufi varet nga shumë faktorë si: sistemet ekonomike-shoqerore të vendit ku aplikohet etj. Por nëse dëshirohet që të arrihet sukses në nxitjen e zhvillimit ekonomik atëherë ky kufijë duhet të jetë në nivelin më

të ulët të mundshëm. Ky parim nuk do të thotë të respektohet në situata të jashtëzakonshme nëpër të cilat kalon vendi si në luftë, gjatë fatkeqësive natyrore etj.

Zgjedhja e formës tatimore- Se sa dhe si do të realizohet politika tatimore varet në një masë të madhe nga zgjedhja e formës tatimore, te ciles organet tatimore duhet ti kushtojne një vëmendje të vecante. Ka mendime se zgjedhja e formës tatimore ka vetëm ndikim teknik por kjo nuk qëndron sepse forma e tatimit ka ndikim të madh në këtë praktikë bile shpeshherë është determinant i caktuar. Në realizimin e politikave ekonomike ndikim të madh ka bartja e tatimit, e cila mund të bëhet si bartje me qëllim dhe pa qëllim.

3. Parimet socialo-politike të tatimit - Këto parime janë të një periudhe te mevonshme, por rëndësia e tyre ka ardhur duke u rritur dhe sot ato pothuajse janë bërë pjesë e pandashme me parimet tjera të sipërpërmendura megjithse zbatimi i tyre ndryshon në vende dhe sisteme të ndryshme. Ndër këto parime Vagneri numeronte:

1. Karakterin universal të tatimeve
2. Barazinë në tatime

Karakterin universal apo i përgjithshëm i tatimeve-Vagneri thekson nevojën për tatimin universal. Esenca e këtij parimi qëndron në faktin se në tatim duhen përfshirë të gjitha kategoritë e shoqërisë pa dallime politike, fetare, klasore, racore, gjinia, përkatësia etnike, gjuhaetj. Këto dukuri nuk mund të paraqiten si pengesë as për caktimin e tatimit e as për madhesine e tatimit. Përkundër rëndësisë dhe nevojës për respektim të këtij parimi ndonjëherë bëhet përjashtim nga ky tatim. Në caktimin e tatimit duhet të këtë edhe përjashtime por vetëm për ato kategori të shoqërisë të cilat nuk mund të sigurojnë minimumin egzistencial, që do të thotë jetojnë në varfëri të skajshme. Sot në këtë drejtim është shënuar përparim sepse në disa jo vetem qe nuk taten kategoritë me gjendje të rëndë sociale por edhe ndihmohen këto kategori me një shumë të caktuar të mjeteve nga ana e shtetit.

Barazia në tatim – Është e vërtetë se për subjektet që e paguajnë tatimin ai është një barrë e cila sipas këtij parimi duhet ndarë në mënyrë të drejtë. Ajo do të thotë se secili duhet ngarkuar aq sa mund të mbajë e jo më shumë. Ky parim nuk është zbatuar si duhet në shoqëri apo në një sistem kundrejt kërkesës së vazhdueshme. Inkasimi i tatimeve ose më

mirë përbindja në inkasim varet në një masë të madhe nga barazia e ndarre së kësaj barreje por për realizimin e këtij tatimi duhet angazhuar çdo sistem.

4. Parimet tatimore-teknike të tatimit - Këto parime për nga rëndësia, kanë një peshe më të vogël sesa parimet e tjera dhe janë në përputhje të plotë me të sipërpërmendurën. Realizimi i këtij parimi varet shumë nga niveli, përgatitja dhe kontrolli i arkëtimit të mjeteve në arkën e shtetit. Në këtë grup bëjnë pjesë këto parime:

1. përcaktueshmëria e tatimit
2. pëlqyeshmëria e pagimit të tatimit
3. lirësia e mbledhjes së tatimit

Përcaktueshmëria e tatimit – kjo na shpie në zvogëlimin e fuqisë ekonomike të subjektit fizik apo juridik dhe ndikon jo vetëm në punën e subjektit të caktuar por edhe në pozitën e tij në shoqëri, prandaj në këtë aspekt duhet të ketë maturi dhe menduri të vecantë. Tatimi duhet bërë sipas ligjit, nuk duhet të ketë tatime jashtë dhe kundër tij në asnjë mënyrë. Kjo është e qartë kur kihet parasysh se obligimi i tatimit për ata që paguajnë rrjedh me ligj. Parimi i përcaktueshmërisë kërkon që obligimi për paguesin të jetë i ditur më parë, gjithashtu të jetë i njoftuar me kohë dhe shuma të jetë precize etj.

Pëlqyeshmëria e tatimit – Duke ditur që tatimi është barrë është e qartë se nuk mund të pritët pëlqimi prej obliguesit tatimor, por ajo duhet caktuar. Këtu duhet parë me kujdes dhe duhen gjetur disa lehtësi për obliguesin tatimor p.sh. koha, shuma dhe mënyra e pagesës mund ta zgjedhin bashkërisht organet financiare dhe obliguesit tatimorë, pastaj sqarimet duhet të bëhen në çdo kohë dhe për çdo detaj. Gjithashtu korrektësia dhe sjellja me palë është obligim i organeve financiare e cila duhet respektuar . Një vëmendje e vecantë duhet të kushtohet dinjitetit personal të obliguesit tatimor . Gjithashtu ruajtja e sekreteve nga ana e organeve financiare është obligim.

Lirësia e mbledhjes së të tatimeve – Gjatë mbledhjes së tatimeve i duhet kushtuar një kujdes i vecantë që kjo të arrihet me një çmim sa më të lirë të mundshëm. Kjo mund të realizohet përmes një administrate të organizuar dhe të përgatitur mirë me një shfrytëzim sa më racional të kohës, dhe me një posedim të paisjeve sa më me nivel.

4.3. QËLLIMET, MASAT DHE EFEKTET TATIMORE

Qëllimi dhe roli i tatimeve ka pësuar ndryshime të vazhdueshme p.sh.në sistemin skllavopronar qëllimi dhe motivi i vetëm i tatimit ishte që përmes tij të mblidhen sa më shumë mjete për të plotësuar sa më kënaqshëm nevojat e sundimitarit.

Mbledhja e tatimit është i lidhur ngushtë me rolin e shtetit në shoqëri. Në kapitalizmin liberal roli i shtetit ishte i kufizuar sikurse dhe qëllimi i mbledhjes së taimeve ishte vetëm fiskal. Tatimeve krahas instrumenteve të tjera të rëndësishme të politikës ekonomike, iu është besuar një rol i madh dhe tejet aktiv. Me tatimet gjithnjë e më shpesh realizoheshin disa nga qëllimet e politikës ekonomike. Këto tatime bëhen instrument efikas i politikës së çmimeve dhe bëhet përpjekje që përmes tyre të ekuilibrohet oferta dhe kërkesa. Me pas ndikohet në orientimin e investimeve, që të pengohet inflacioni si dhe të eliminohen të gjithë faktorët që kanë ndikim negativ në ekuilibrin e tregut. Rol tjetër që arrihet me tatimet është që të stimulohet eksporti, të zvogëlohet konsumi, të rritet produktiviteti i punës. Gjithashtu përmes tatimit dëshirohet që të pengohet importi i mallit nga jashtë duke dashur që të stimulohet prodhimi i brendshëm. Krahas qëllimeve ekonomike tatimet shërbejnë edhe si instrument i politikës sociale, duke mbrojtur një kategori të shoqërisë që të mund të sigurojnë egzistencën e tyre duke i lehtësuar ata nga pagesa e tatimeve. Përmes tatimeve mund të arrihen edhe efekte të tjera ekonomike vaeësisht nga qëllimi i politikës së një vendi p.sh. përmes tatimit mund të stimulohet prodhimi i caktuar,ndërtimi apo edhe ndonjë veprimtari e caktuar e ekonomise për të cilën është e interesuar politika qeveritare e një vendi të caktuar. Duke pasur pasoja serioze nga pagesa e tatimeve subjektet e ndryshme janë të interesuara që të gjejnë forma dhe mënyra për t'i ikur kësaj barre qofshin ato të ligjeshme apo edhe të paligjshme. Krahas këtyre edhe organet financiare të sistemit fiskal, të ndikuara nga gjykatat, përgatisin masa të caktuara, të cilat i ndëshkojnë subjektet që e bëjnë këtë. Këto masa fillojnë nga përgatitja dhe aftësimi i kuadrove të sistemit fiskal në aspektin më të lartë e deri te përgatitja e pajisjeve të punës të nivelit bashkëkohor .

Për ti penguar këto shmangje janë paraparë edhe masa të ndryshme të cilat e kanë burimin e vet nga ligji, i cili ndëshkon këtë kategori të papërgjegjshme ndaj vendit dhe sistemit fiskal. Këto masa përfshijnë dënimin me të holla, dënimet me burg, etj. Masat e

tilla, krahas përsosjes dhe ndryshimit të vazhdueshëm të sistemit fiskal, janë duke shënuar përparim të vazhdueshëm duke u shfaqur në forma dhe mënyra gjithnjë e më të përsosura. Ndaj për këtë arsye subjekti fizik dhe juridik duhet ta ketë kujdesin e shtuar.

Tatimpaguesit me pagimin e tatimit, i zvoglohen të ardhurat e tij. Në këtë aspekt ai për të mbrojtur të ardhurat e tij bën bartjen e tatimit. Bartja e tatimit paraqet dukurinë kur obliguesi tatimor me qëllim që ti shmanget ngarkesës tatimore e bart atë në tëresi apo pjesërisht në personin tjetër ose këta persona tatimin e bartur përseri e bartin në tëresi ose pjesërisht në personat e tretë(Komoni,S:1998:23).

Bartja e tatimit paraqitet si rezultat i dëshirës së tatimpaguesit që efektet e padëshirueshme të largojë nga vetja, duke e bartur ngarkesën tatimore në ndonjë person tjetër.

Bartja e tatimit si dukuri paraqitet kur tatimpaguesi me qëllim që ti shmanget ngarkesës tatimore e bartë atë në personin tjetër. Tatimpaguesi është paraparë me ligj që të pagujë tatimin, mirpo për të mbrojtur të ardhurat e veta ai i shmanget ngarkesës tatimore duke e bartur tatimin në personin tjetër, i cili për shkak të bartjes së tatimit dëmtohet.

Bartja e tatimit është rezultat i shmangies së ngarkesës tatimore nga tatimpaguesi në personin tjetër.

Bartja e tatimit është dukuri prezente në ekonomine e tregut e cila realizohet në procesin e këmbimit të mallrave dhe shërbimeve.

Bartja e tatimit bëhet kryesisht nëpërmjet çmimeve në treg. Në këtë mënyrë tatimpaguesi përmes çmimit të mallrave dhe shërbimeve të shitura (në çmime llogaritin edhe obligimin tatimor) e bartin tatimin tek konsumatorët, të cilët nëpërmjet çmimit të mallrave apo shërbimeve të blera përveq që paguajnë çmimin e mallrave apo shërbimeve por ata paguajnë edhe tatimin.

Ekonomia e tregut konsiderohet mjet i përshtatshëm për bartjen e tatimit. Bartja e tatimit kryesisht varet nga elasticiteti i ofertes dhe kërkeses. Në treg, kur kërkesa është më e madhe se oferta shitësit si tatimpagues mund të bartin tatimin tek blersit(konsumatorët) dhe anasjelltas. Bartja e tatimit si dukuri nuk ndikon në zvoglimin e të hyrave buxhetore të shtetit por vetëm ndryshon paguesin e fundit të tatimit. Bartja e tatimit varet nga llojet e tatimeve, pasi të gjitha tatimet nuk janë të përshtatshme për bartje. Tatimet indirekte (TVSH, doganat) janë të përshtatshme dhe barten me lehtë, ndërsa tatimet e drejtëpërdrejta (tatimi në të ardhura) nuk janë të përshtatshme për bartje sepse barten me vështiresi.

4.3.1. Transferimi ose kompensimi i tatimit

Përpjekjet e tatimpaguesit për ti menjanuar efektet e padëshirushme të tatimit përmes bartjes së tatimit në personin tjetër nuk kanë gjithnjë sukses. Atëherë një nga mënyrat për tu liruar prej efekteve negative të tatimit është transferimi ose kompensimi i tatimit.

Transferimi ose kompensimi i tatimit nuk bazohet në bartjen e tatimit ose shmangien nga pagimi i tatimit, por në aftësinë e tatimpaguesit që gjatë procesit të prodhimit të realizojë të ardhura më të mëdha, në mënyrë që ti zvogëlonte efektet e padëshirushme të ngarkesës tatimore.

Tatimpaguesi, transferimin ose kompensimin e tatimit e realizojnë duke modernizuar procesin e prodhimit, zvogëluar shpenzimet që kanë si rezultat rritjen e prodhimit dhe të ardhurave përmes të cilave mbulohet shuma e tatimit të paguar dhe zvogëlohen efektet negative të pagimit të tatimit.

Tatimpaguesi përmes përmirësimit të organizimit, modernizimit të prodhimit arrin efekte pozitive ekonomike, me të cilat do të zvogëlonte shpenzimet e ngarkesës tatimore.

Transferimi ose kompensimi i tatimit konsiderohet një prej efekteve pozitive të tatimit, sepse e nxit tatimpaguesin që përmes modernizimit dhe rritjes së aktivitetit ekonomik të realizojë të ardhura më të mëdha nga të cilat jo vetëm që e paguan tatimin por edhe i zvogëlon efektet negative të ngarkesës tatimore.

Efektet e tatimit në rishpërndarjen e të ardhurave nacionale

Të ardhurat kombetare paraqesin shumën e përgjithshme të vlerës së rikrijuar në ekonomine e një vendi gjatë vitit përkatës.

Në literaturën ekonomike të ardhurat kombetare ndryshe quhen edhe neto produkt. Konkretisht të ardhurat kombetare fitohen kur nga produkti shoqëror zbrisim amortizimin (TK=PSH-A). (Limani, M: 1994:376)

Në ekonomine e tregut shpërndarja e të ardhurave në mes të subjekteve të cilat marrin pjesë në prodhim bëhet përmes tregut.

Shpërndarja parësore paraqet fazën e parë dhe kryesore të shpërndarjes së të ardhurave kombetare midis pjesëmarrësve në prodhimin material.

Prandaj shpërndarja e të ardhurave, e cila bëhet përmes tregut në mes të subjekteve të cilat marrin pjesë në prodhim, paraqet shpërndarjen e parë (primare) të të ardhurave nacionale.

Në ekonomine e tregut, ku vepron ligji i vlerës, në shpërndarjen parësore të të ardhurave kombetare marrin pjesë të gjithë prodhuesit e mallrave nëpërmjet tregut. Me shpërndarjen

parësore nënkuptojmë atë shpërndarje të të ardhurave kombtare e cila realizohet në ekonomin e një vendi nëpërmjet realizimit të mallrave sipas çmimit në treg.

Me shpërndarjen parësore subjektet ekonomike krijojnë bazën e tyre materiale ,përkatësisht fitojnë pozitë ekonomike në kuadër të ekonomise së vendit.

Pas shpërndarjes së parë (primare) të të ardhurave nacionale në të cilën marrin pjesë vetëm subjektet prezente në prodhim, e cila realizohet përmes tregut ,fillon shpërndarja dytësore e të ardhurave nacionale.

Shpërndarja dytësore e të ardhurave kombetare në literaturën ekonomike quhet edhe rishpërndarja e të ardhurave kombetare.

Mëqenëse një pjesë e popullsisë,nuk është e angazhuar në prodhim të drejtëpërdrejtë (si arsimi,shëndetësia ,shkenca,administrata etj),një pjesë tjetër janë pasive e të paaftë për punë (si pleqtë ,foshnjat, invalidët etj), shoqëria duhet të sigurojë mjete për ekzistencë. Në rishpërndarjen e të ardhurave nacionale marrin pjesë shumë subjekte të cilat janë jashtë sferës së prodhimit.

Shpërndarja dytësore ka të bëjë me ndarjen e një pjese të të ardhurave kombetare nga shpërndarja parësore me qëllim që ajo pjesë të rishpërndahet më tej për nevojat e anetarëve aktivë joprodhues popullatës pasive dhe nevojave të tjera të shoqërisë në tërësi. Instrumenti kryesor, përmes të cilit shteti bën rishpërndarjen e të ardhurave kombetare, janë tatimet.

Tatimi si instrument fiskal ka ndikim të madhë në rishpërndarjen e të ardhurave nacionale.Shteti për të zhvilluar ekonomin ,përveq stimulimit të prodhimit duhet ti kushtoj vëmendje edhe nxitjes së sferës joprodhuse (arsimit,shkencës,kulturës ,shëndetësis etj),të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në ekonomin e vendit.

Tatimi ka efektet e saj përmes rishpërndarjës së të ardhurave nacionale në sferën joprodhuse, duke ndikuar në stimulimin dhe zhvillimin e kësaj sfere.

4.3.2. Efektet e tatimit në akumulim

Akumulimi është një faktor mjaft i rëndësishëm pasi prej tij varet zhvillimi ekonomik. Prandaj shtetet e ndryshme, sidomos ato në zhvillim, duhet të ndajnë mjete financiare për akumulim dhe përmes shfrytëzimit racional të tyre të nxisin zhvillimin ekonomik.

Meqenëse në shtetet bashkehojë tatimet janë një burim mjaft i rëndësishëm i të hyrave buxhetore, të cilat ndikojnë në rritjen ose zvogëlimin e vëllimit të akumulimit. Ai përmes politikës tatimore ndikon në akumulim në dy mënyra:

1. Në mënyrë të drejtëpërdrejtë ku mjetet të cilat mbliidhen me anë të tatimit përmes fondit të akumulimit të krijuar shfrytëzohen për qëllime investive dhe
2. Në mënyrë indirekte shteti përmes politikës tatimore ndikon në subjektet ekonomike që të ardhurat e tyre të akumulohen.

Efektet e tatimit në akumulim mund të jenë pozitive dhe negative.

Efektet e tatimit në akumulim janë pozitive nëse me mjetet e mbledhura me anë të tatimit krijohet fondi i akumulimit, i cili shërben për investime në ekonomi, të cilat kanë efekte pozitive pasi ndikojnë në përshpejtimin e zhvillimit ekonomik.

Efektet e tatimit në akumulim janë negative nëse tatimet rriten jo për qëllime investive, dhe ndikojnë në mënyrë negative të tatimpagusi dhe në zhvillimin ekonomik. Shtetet në zhvillim, për të shpejtuar zhvillimin ekonomik, duhet të kushtojnë kujdes të posaçëm krijimit të fondit të akumulimit.

Prandaj shteti, përmes caktimit të normave të uletësive tatimore ose lehtësive tatimore u mundëson subjekteve ekonomike që një pjesë të fitimit ta ndajnë për akumulim i cili shërben për qëllime investive.

Efektet e tatimit në këmbimin ndërkombëtar - Zhvillimi i teknikës dhe teknologjisë ka mundësuar prodhimin masiv, i cili për tu realizuar duhet të plasohet në tregun e jashtëm.

Në këmbimin ndërkombëtar midis shteteve, tatimi ka një ndikim mjaft të madh në sigurinë e sferës së këmbimit të tregtisë së jashtme. Këmbimi ekonomik ndërkombëtar mund të stimulohet përmes instrumenteve të politikës fiskale ku një nga instrumentet e rëndësishme është tatimi përmes të cilit ndikohet në procesin e këmbimit ndërkombëtar.

Ndikimi i tatimit në këmbimin ndërkombëtar varet nga gjendja dhe qëllimi i ekonomisë kombëtare. Ndikimi i tatimit në këmbimin ndërkombëtar shprehet përmes efektit të tij në çmimin e mallrave dhe shërbimeve gjatë eksportit dhe importit.

Në këtë aspekt tatimi ndikon si në eksportin ashtu edhe në importin e ekonomisë kombëtare. Efekti i tatimit në eksportin e mallrave dhe të shërbimeve shprehet përmes stimulimit ose destimulimit të eksportit me anë të masave të politikës tatimore.

Tatimi meqenëse llogaritet në çmimin e mallrave dhe të shërbimeve ndikon në ngritjen ose uljen e çmimit të tyre. Shteti për të stimuluar eksportin e mallrave dhe

shërbimeve të vendit në tregun e jashtëm aplikon normë më të ultë tatimore (uljen e normës së TVSH-së), lirime nga tatimi ose kthimin e tatimit të paguar eksportuesve. Shteti për të stimuluar (nxitur) eksportin me anë të tatimit duhet që eksportuesit të lirojnë përpara nga tatimi ose përmes kthimit të tatimit të paguar, pasi të kryhet eksporti. Në këto dy mënyra të stimulimit të eksportit shteti bazohet në tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH-në). Në mënyrën e parë eksportuesit për mallrat dhe shërbimet e eksportura lirohen përpara nga TVSH-ja. Në mënyrën e dytë eksportuesit për mallrat dhe shërbimet e eksportura paguajnë TVSH-në, ndërsa pasi të kryhet eksporti i cili duhet të argumentohet me dokumente të eksportit, eksportuesit i kthehet tatimi i paguar. Shteti përmes politikës tatimore respektivisht TVSH-së, duke liruar nga TVSH-ja apo kthimit të TVSH-së së paguar eksportuesit ndikon në stimulimin e eksportit, me qëllim që çmimet e mallrave dhe shërbimeve të vendit të jenë më të ulta dhe më konkurrente në tregun e jashtëm. Në këtë drejtim efekti i tatimit në stimulimin e eksportit shprehet përmes normave të ulta, liritimit nga tatimi ose kthimit të tatimit të paguar eksportuesve.

Tatimi ka efekt edhe në importin e mallrave dhe të shërbimeve, duke ndikuar në ngadalësimin ose pengimin e importit. Shteti për të mbrojtur prodhuesit e vendit ose ndonjë degë të caktuar ekonomike nga konkurrenca e jashtme, aplikon masa të rrepta të politikës, fiskale respektivisht rrit taksat doganore, normën e TVSH-së në importe me qëllim që të rritet çmimi i mallrave të importura në tregun e vendit duke pasur për bazë mbrojtjen e prodhuesve të vendit.

Nga aspekti i tiparit organizativ të administrimit të tatimit mbi vlerën e shtuar në shtetet me ekonomi të zhvilluar të tregut si dhe në shtetet në zhvillim, ka zgjidhje dhe përvoja të ndryshme praktike. Ndonëse ekzistojnë dallime, në mënyrë të përgjithshme ekzistojnë edhe disa formularë të përbashkët, të cilët kanë të bëjnë me skemën e përgjithshme organizative në administrimin e këtij tatimi. Në të gjitha shtetet administrimi i tatimit mbi vlerën e shtuar është i organizuar në njërin nga këto mënyra⁷:

- ✓ Është i vendosur nën juridiksionin e njësisë organizative për dogana dhe akciza;
- ✓ Administrative - bëhet së bashku me tatimin mbi të ardhurat dhe
- ✓ Ekziston seksioni i veçantë vetëm për këtë lloj tatimi.

⁷ Krahaso me shtetet "Tax Administration: The Structure and Responsibilities of Assessment, Enforcement and Collection Branches". OECD, Paris, 1991 dhe (Value Added Taxation in Developing Countries), the World Bank, Washington, 1990.

Zgjedhja e njërës prej mënyrave të theksuara të administrimit të tatimit mbi vlerën e shtuar në të gjitha shtetet varet kryesisht prej traditës, kualifikimit të personelit, kushteve lokale dhe faktorëve të tjerë specifikë të çdo shteti, të cilët kanë pasur ndikim e arritjen e efikasiteti në punën e administratës tatimore. Megjithatë, duke gjykuar nga numri i rasteve, më shpesh hasim organizimin e administrimit të përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitim. Një ndër përparësitë kryesore të integritit të administrimit të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe të tatimit mbi fitimin është shfrytëzimi i dokumentacionit të përbashkët, me mundësi të shfrytëzimit të tij për kontroll të kryqëzuar për nevoja të këtyre llojeve të tatimeve. Ky integrim është i pranishëm posaçërisht në shtetet në zhvillim, mirëpo ka edhe shtete të cilat kanë themeluar seksione të veçanta për TVSH-në, me qëllim të shmangies së problemit të llogaritjes dhe të arkëtimit lidhur me tatimet e tjera. Kështu, për shembull, në Kore administrata tatimore është e organizuar me seksion të veçantë për tatimet e tërthorta (TVSH dhe akciza) dhe seksion të veçantë për tatime direkte (tatimi mbi fitimin).

4.3.3. Metoda direkte e TVSH-së

Sipas metodës direkte, obligimi tatimor caktohet me aplikimin e shkallës tatimore në shumën e mbledhur të të gjitha elementeve, të cilat e përmbajnë vlerën e shtuar ose në shumën e diferencës ndërmjet shumës së tërësishme të qarkullimit dhe shumës së tërësishme të furnizimit.

Nga sa u tha më lart, shihet se gjatë caktimit të tatimit direkt të vlerës së shtuar zbatohen këto dy mënyra të llogaritjes së vlerës së shtuar (JELÇIQ: 1998:284)

- ✓ Metoda direkte e mbledhjes së TVSH-së
- ✓ Metoda direkte e zbritjes së TVSH-së.

Metoda direkte e mbledhjes së TVSH-së - Një ndër mënyrat direkte të caktimit të vlerës së shtuar është metoda e mbledhjes. Te mënyra e mbledhjes, baza tatimore përcaktohet nga veprimi që ushtrojnë faktorët e prodhimit, të cilët përfitojnë një shpërblim në trajtë pagash, fitimesh, interesash, rentash, shuma e të cilave është e barabartë me vlerën e shtuar. Kjo mund të llogaritet me anë të mbledhjes, duke mbledhur bashkë në çdo fazë ose në çdo hallkë shpërblimet ndaj faktorëve të prodhimit.

Metoda direkte e mbledhjes së tatimit mbi vlerën e shtuar shprehet në të ashtuquajturën formë të tatimit mbi vlerën e shtuar në të ardhura. Vlera e shtuar si bazë tatimore kuantifikohet si shumë e elementeve vijuese të çmimit.

$$VSH = a+b+c+d+e(f+g)$$

a = pagat dhe mëditjet ; b = tatimet dhe kontributet; c = kamata dhe qiratë ; ç = kamata në kapitalin vetjak; d = fitimi neto ; dh = zhvlerësimi dhe amortizimi; f = shpenzimet reale të afarizmit

Metoda direkte e zbritjes së TVSH-së - Obligimi tatimor, sipas mënyrës direkte të zbritjes së TVSH-së, caktohet duke aplikuar shkallën tatimore në shumën e diferencës ndërmjet shumës së tërësishme të qarkullimit dhe shumës së tërësishme të furnizimit

Tatimi i vlerës së shtuar me aplikimin e metodës direkte të zbritjes shprehet në të ashtuquajturën formë të TVSH-së mbi konsumin dhe bazën tatimore e përbëjnë elementet vijuese: (JELÇIQ: 1977:43)

$$VSH = VT - a + b + c + d + e (+c)$$

a = lënda e parë dhe materiali ndihmës

b = gjysmëproduktet

c = mëditjet e punëtorëve jashtë ndërmarrjes

ç = zhvlerësimi dhe amortizimi

d = shpenzimet reale të afarizmit

VT = Vlera Totale e prodhimit

Metoda indirekte e vlerës së shtuar - Përveç përdorimit të dy mënyrave të caktuara direkte të vlerës së shtuar, të theksuara më lart, parapëlqehet të përdoret edhe metoda indirekte. Gjatë tatimit indirekt të vlerës së shtuar nuk tatóhet vlera e shtuar, por përdoret metoda e zbritjes së tatimit nga tatimi, që do të thotë se obligimi tatimor llogaritet duke zbritur tatimin e paguar në fazën e mëparshme të qarkullimit prej shumës së tatimit të llogaritur mbi vlerën e tërësishme në fazën e të tatuarit (JELÇIQ: 1998:14)

$$BT = TTQ - TPQ$$

BT = baza tatimore

TTQ = tatimi total mbi qarkullimin

TPQ = tatimi i paguar mbi qarkullim në fazën e mëparshme

Në shembullin tonë të marrë më parë shihet se shuma e autputeve të fazës së parë, pa tatimin mbi vlerën e shtuar është 1.000 njësi monetare dhe supozojmë se obliguesi tatimor i fazës së parë nuk blen inpute dhe kështu ka sendërtuar “vlerën e shtuar”

Format e tatimit mbi vlerën e shtuar -Një ndër problemet më të rëndësishme gjatë të tatuarit të qarkullimit duke aplikuar TVSH-në është trajtimi tatimor i aktiveve afatgjata, domethënë i pajimeve investuese. Nga ky trajtim varet mundësia e paraqitjes së gatishmërisë së obliguesit tatimor që t'i modernizojë dhe që t'i zgjerojë kapacitetet prodhuese, duke krijuar kushtet për shtimin e prodhimtarisë si dhe për ngritjen e produktivitetit të punës në një shkallë më të lartë etj.

Varësisht nga trajtimi i të mirave kapitale, për caktimin e bazës tatimore dallojmë këto katër forma (modalitete) të tatimit mbi vlerën e shtuar: (Shoup C.: 2010:251-257)

- ✓ Forma e TVSH-së mbi vlerën e shtuar bruto
- ✓ Forma e TVSH-së mbi të ardhurat
- ✓ Forma e TVSH-së mbi TVSH neto
- ✓ Forma e TVSH-së mbi konsumin.

4.3.4. Efektet e tatimit në aktivitetin ekonomik

Tatimi ndikon dhe ka efektet e tij në aktivitetin ekonomik të vendit. Shumica e vendeve në botë përmes tatimit përkatësisht politikës tatimore synojnë të realizojnë objektivat e caktura ekonomike me qëllim të nxitjes së zhvillimit ekonomik. Për arritjen e qëllimeve zhvillimore, masat e politikës tatimore i përdorin vendet në zhvillim të cilat bëjnë përpjekje të vazhdueshme që të nxisin zhvillimin ekonomik si dhe vendet e zhvilluara.

Efektet e tatimit në aktivitetin ekonomik, respektivisht në nxitjen e zhvillimit ekonomik janë evidente përmes uljes së tatimit apo lirimit nga tatimi të degëve të caktura ekonomike, të cilat ndikojnë në nxitjen e zhvillimit ekonomik.

Shteti, për të nxitur zhvillimin ekonomik përmes politikës tatimore, vepron në drejtim të stimulimit të degëve propulsive ekonomike (shteti cakton degët ekonomike të cilat e nxisin ,shtyjnë përpara zhvillimin ekonomik),duke i liruar këto degë prej ngarkesës tatimore të cilat për shkak të lirimeve nga tatimi ,iu mbetet një pjesë më e madhe e fitimit që shërben si burim i rëndësishëm për investime që e nxisin zhvillimin ekonomik. Gjithashtu përmes normave të diferencura tatimore perkatësisht normave më të ulta tatimore për degët propulsive ekonomike në krahasim me degët tjera u mundëson këtyre degëve strategjike që gjatë aktivitetit të tyre ekonomik ,për shkak të normave më të ulta tatimore të realizojnë të ardhura më të mëdha,dhe një pjesë të këtyre të ardhurave ti përdorin për qëllime investive (teknologji të re),si faktori kryesor për stimulimin e zhvillimit ekonomik.

Efektet e tatimit në stabilizimin ekonomik- Tatimi ndikon në stabilizimin ekonomik dhe së bashku me faktorët e tjerë konsiderohet si instrument mjaft efikas në këtë drejtim.

Stabilizimi ekonomik dhe ekuilibri ekonomik nuk mund të arrihet vetëm përmes tatimeve dhe të politikës tatimore ,por në këtë proces ndikojnë edhe faktorë të tjerë të cilët mundësojnë arritjen dhe vendosjen e stabilitetit ekonomik. Prandaj tatimi përmes efekteve të tij vetëm e ndihmon dhe kontribuon në vendosjen e stabilitetit ekonomik.

Ekonomia gjendet në ekuilibër nëse oferta agregate është e barabartë me kërkesën agregate. Nëse oferta dhe kërkesa nuk pajtohen atëherë ekonomia gjendet në disekuilibër (joekuilibër).

Ekzistojnë dy forma të joekuilibrit ekonomike në ekonomin kombtare:

1. Forma e parë e disekuilibrit ekonomik në ekonomine kombetare është nëse kërkesa agregate është më e madhe se oferta agregate ($K > O$).
2. Forma e dytë e disekuilibrit ekonomik është nëse oferta agregate është më e madhe se kërkesa agregate ($O > K$).

Në këto dy forma të disekuilibrit me anë të tatimit përvec faktorëve dhe instrumentëve tjerë, bëhet përpjekje që të vendoset stabilizimi ekonomik respektivisht sjellja e ekuilibrit në mes të ofertes dhe kërkesës.

Në ekonomine kombetare kur kërkesa është më e madhe se oferta ($K > O$),përmes tatimit duhet të zvoglohet kërkesa ,që arrihet me anë të politikës tatimore restriktive.

Efeksi i politikës tatimore restriktive konsiston që përmes rritjes së normave tatimore ,aplikimit të llojeve të reja të tatimit si dhe heqjes së lehtësive të ndryshme tatimore të ndikohet në zvoglimin e konsumit .

Në këtë aspekt qëllimi i politikës tatimore restriktive respektivisht efekti stabilizues i saj është që të zvoglohet kërkesa dhe të afrohet në nivelin e ofertës me tendencë të vendosjes së stabilizimit ekonomik (ekuilibrit ekonomik). Nëse në ekonomine e kombetare oferta është më e madhe se sa kërkesa, urgjentisht përmes tatimit duhet të inkurajohet rritja e kërkesës, duke përdorur instrumentin e politikës tatimore ekspansive. Efeksi i politikës tatimore ekspansive me tendencë të rritjes së kërkesës, orientohet në zvoglimin e normave tatimore ,rritjes së lehtësive (benificionëve) tatimore në mënyrë që subjekteve ekonomike, për shkak të tatimeve më të ulta që pagujnë, u mbeten më shumë të ardhura të cilat i shpenzojnë duke ndikuar në rritjen e kërkesës.

Tatimi si instrument për stabilizimin ekonomik, duhet të përdoret së bashku me instrumentet e tjerë të stabilizimit.

Politika tatimore si instrument i stabilizimit ekonomik duhet të përdoret te tatimet e drejtëpërdrejta dhe tatimet indirekte varësisht nga burimi i shkakimit të disekuilibrit ekonomik.

Politika tatimore duhet të zgjedhe llojet e tatimit përmes të cilave do të arrihet efekti i stabilizimit ekonomik. Politika tatimore si instrument i stabilizimit ekonomik duhet të jetë e harmonizuar me politikën kreditore-monetare në të njëjtin drejtim.

Në situatat e joekuilibrit ekonomik, kur kërkesa është më e madhe se oferta, për vendosjen e stabilizimit ekonomik ,aplikohet politika tatimore restriktive e cila duhet të jetë e harmonizuar me politikën kreditore monetare restriktive keshtu së bashku ato do të ndikojnë në zvoglimin e kërkesës në nivelin e ofertes me tendencë të arritjes së ekuilibrit ekonomik. Gjithashtu kur oferta është më e madhe se kërkesa, duhet të aplikohet politika tatimore ekspansive, e cila duke qenë e harmonizuar me politikën monetare-kreditore ekspansive kontribuojnë së bashku në zvoglimin e ofertës në nivelin e kërkesës për të arritur ekuilibrin ekonomik.

4.4.5. Sistemet tatimore bashkëkohore në ekonominë e tregut

Sistemet tatimore bashkëkohore dallojnë shumë mes tyre dhe sot në botë nuk mund të gjesh dy sisteme unike tatimore.

Kjo ndodhë për faktin se në sistemin tatimor të një vendi ndikojnë një numër i caktuar faktorësh si: zhvillimi ekonomik, numri i banorëve, kultura, madhësia e territorit, të ardhurat për tokë të banorit , zhvillimi historik, niveli arsimor, përkatësia fetare, doket dhe zakonet e vendit etj..

Ekzistojnë dallime të mëdha ne mes të shteteve të zhvilluara – atyre në zhvillim dhe të pazhvilluara – posacërisht në kuptimin e të hyrave p.sh. derisa te vendet e zhvilluara si degë kryesore prej së cilës sigurohen të hyrat është industria, te vendet e pazhvilluara paraqitet bujqësia si degë kryesore. Ndryshime të mëdha në mes të sistemeve tatimore egzistojnë edhe në mes të shteteve të cilat kanë zhvillim të njëjtë ekonomik ose të përafërt.

Këtu dallon sidomos raporti në mes të hyrave direkte dhe indirekte. Sot sistemet bashkëkohore të ekonomisë në treg dallojnë me një numër të madh formash tatimore të cilat dallojnë sipas tyre qoftë për nga qëllimi që janë të destinuara qoftë për nga burimet e tatimit, për nga lloji i përqindjes tatimore, objekti i tatimit etj.

Format themelore të sistemit tatimorë në ekonominë bashkëkohore në treg janë:

1. Tatimi shoqëror
2. Tatimi në pasuri
3. Tatimi në trashëgimi dhe dhurata
4. Tatimi në të hyra nga bujqësia
5. Tatimi në të hyra nga ndërtesat
6. Tatimi në të hyra nga veprimtaritë ekonomike
7. Tatimi në fitim
8. Tatimi në rritjen e të ardhurave dhe pasurisë
9. Tatimet e posacëme në qarkullim
10. Tatimet e qarkullimit
11. Monopolet fiskale
12. Tatimi në shpenzime

Secila formë e tatimit e ka mundësinë e vet në mbushjen e arkës shtetërore ndaj edhe kërkon një analizë dhe studim të vecantë.

1. Tatimi shoqëror – kjo formë e tatimit është relativisht e re e cila prej gjysmës së dytë të shekullit XIX. Me këtë lloj të tatimit taten subjektet juridike, korporatat nacionale të ardhurat e tyre, të ardhurat e krijuara nga ndërmarrjet etj. Më konkretisht obliguesit e këtij tatimi janë: shoqëritë aksionare me përgjegjësi të pakufizuar dhe persona të tjerë fizike dhe juridike. Dhe ky lloj i tatimit paraqitet apo mund ta vërejmë të gjitha shtetet e zhvilluara.
2. Tatimi në pasuri – te ky lloj tatimi sic shihet edhe nga vetë emërtimi i tij objekt i tatimit është pasuria qoftë si e tërësishme apo e pjesëshme e personave fizike dhe juridike të cilët kanë vendbanimin ose selinë në një vend të caktuar. Tatimi në pasuri paguhet në neto-vlerë, si i tillë ky lloj i tatimi është e hyrë e njësisive më të ngushta politike-territoriale, zakonisht komunat të cilat më pas mjetet e mbledhura nga ky lloj tatimi kryesisht i angazhohen në infrastrukturë, për meremetimin ose ndërtimin e saj.
3. Tatimet në trashigimi dhe dhurata – edhe pse rëndësia e këtij tatimi në kuptimin e mbushjes së arkës së shtetit është e vogël perseri i kushtohet një vëmendje e vecantë nga sistemi tatimor i një vendi. Ky lloj i pasurisë zakonisht taten me përqindje shumë më të lartë deri në 80% në Britaninë e Madhe. Por është karakteristike se në përqindjen e gërgjithshme të buxhetit ky lloj tatimi merr pjesë me promila.
4. Tatimet nga bujqësia – Objekt tatimi është toka ndërsa madhësia e tatimi varet nga çmimi ose kualiteti i tokës së caktuar. Rëndësia e këtij lloj tatimi dikur ishte e pazëvendësueshme për arkën e shtetit por sot ka ndryshuar e sidomos të vendet e zhvilluara, ndërsa te vendet në zhvillim e posacërisht ato të pazhvilluara rëndësia e këtij lloj tatimi është shume e madhe.
5. Tatimi nga ndërtesat – në shumë vende kjo formë e tatimit nuk është e ndarë nga tatimi mbi tokat, por ka vende që kjo formë është e organizuar si e vecantë kurse rëndësia e saj nuk është për t'u nëncmuar. Me qëllim të ngritjes së standardit jetësor në shumë vende ky lloj tatimi është tatur me çmime shumë të ulëta përvec në raste të dhënjeve të ndëtesave me qira e cila është e tatur me nje përqindje më të lartë.
6. Tatimi në të hyra nga veprimtairë ekonomike – objekt tatimi janë të hyat e realizuara të subjekteve ekonomike. Ky është një burim i mirë për sistemin tatimor

të një vendi. Karakteristikë e këtij është se këtë lloj tatimi e karakterizon një vështirësi e caktuar gjatë përcaktimit të tij. Te ky lloj tatimi ,si bazë për tatim mund të merren jo të hyrat nga veprimtaria ekonomike por edhe shuma e kapitalit të investuar në të.

7. Tatimi në fitim – te ky lloj tatimi tatóhet vlëra e re e shtuar apo fitimi që realizohet gjatë një periudhe të caktuar e që është zakonisht një vit, nga ana e personave fizike dhe juridike. Ky lloj tatimi njihet me emra të ndryshme në sistemet e ndryshme tatimore por objekti i tatimit është i njëjtë, vlëra e re e shtuar apo fitimi.
8. Tatimi në rritjen e të ardhurave dhe pasurisë – objekt për tatimin është vlëra e shtuar e të ardhurave dhe e pasurisë . Këtu zakonisht për ta krijuar bazën për tatim merret si bazë dallimi në mes të ardhurave të vitit paraprak apo pasurisë dhe gjatë krahasimit gjendet vlëra e shtuar e cila është objekt tatimi. Te ky lloj tatimi duhet të kihet parasysh, sidomos në rastet e inflacionit në raste të tilla mund të krijohet përshtypje e gabuar mbi rritjen e pasurisë apo të ardhurave.
9. Tatimet e posacëme në qarkullim – tatimet e vecanta mund të paraqiten pavarësisht nga tatimet apo edhe krahas aplikimeve të tatimeve të tjera. Objekt të këtij lloj tatimi janë: duhani dhe fabrikatet e tij, pijet alkoholike, barërat, derivatet e naftës etj.. Ky lloj tatimi është i rëndësishëm së vecantë për buxhetin e çdo sistemi tatimor sepse në përqindjen e gjithëmbarrëshme të tij merr pjesë me një përqindje të lartë.
10. Tatimet e qarkullimit – edhe ky lloj i tatimit është i rëndësishëm së vecantë, këtu tatóhen faktet e qarkullimit ekonomiko-juridik, si shitblerja e sendeve të patundëshme (hipoteka) dhe sendeve të tundshme (pengu), qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve, letrave me vlerë, i pagesave, sigurimi i pasurisë, dhe personave fizike dhe të tjera.
11. Monopolet shtetërore (fiskale) – këtu flasim për monopolet e caktuara që i mban shteti për prodhimin e disa prodhimeve të caktuara me interes të vecantë, ose kur shet prodhime të caktuara me çmim të vecante që zakonisht i kalon shpenzimet e prodhimit të atij mallri që do të thotë se shteti e ruan monopolin mbi mallrat e caktuara.
12. Tatimi në shpenzime – ky lloj tatimi është instrument i jashtëzakonshëm i sistemit tatimor të një vendi, me anë të së cilit ndëshkohen shpenzimet dhe nxitet kursimi.

Këtë lloj të tatimit e ka aplikuar India për një kohë të caktuar dhe sipas tyre madhesia e tatimit është varur shumë nga madhesia e shpenzimeve që do të thotë sa më të mëdha që të jenë shpenzimet aq më të mëdha do të jenë shpenzimet mbi to. Te ky lloj tatimi, kryesisht aplikohet për qindje tatimore programuese. Idhtarët e këtij tatimi thonë se ky është i rëndësishëm për vendet në zhvillim sepse përmes tij rritet potenciali ekonomik i vendit apo rritet mundësia e investimeve.

4.5. DOGANAT, QËLLIMI DHE EFEKTI NË POLITIKËN FISKALE TË EKONOMISË VENDORE

Termi dogana në gjuhën shqipe është huazuar nga italishtja e do të thotë taksë shtetërore në të holla.

Doganat perfaqesojnë një taksë të cilën shteti e ka mbi sovranitetin e caktuar që e inkason prej mallrave në rastin e kalimit të kufirit të caktuar shtetëror ose doganor e që zakonisht këta kufij janë të njëjtë.

Doganat janë futur si të hyra për shkaqe kryesisht fiskale për të plotësuar nevojat sundimtareve në kohrat e hershme e më vonë shërbyer për plotësimin e nevojave të shtetit .

Në periudhën ndërmjet shekullit XV-XIII doganat kishin njëkohësisht edhe rolin e rregullatorit të shërbimit të tregtisë së shtetit.

Vlen të theksohet se në vitet tridhjetë gjatë krizës së madhe ekonomike 1929/ 33 shtohët dukshëm roli ekonomik i doganave.

Ndërsa më vonë, sidomos pas luftës së dytë botërore rëndësia e tyre në kuptimin e paraqitjes së përmbushjes së arkës shtetërore rënë vazhdimisht. Kjo rënie ka ndodhur për faktin se pas luftës së dytë botërore vendet e ndryshme, duke parë interesat e tyre të përbashkëta si politike ashtu edhe ekonomike, krijuan forma të ndryshme të integrimi duke përfshirë rajone të ndryshme në to. Ndërsa një masë kryesore e ndërmarrë në këto integrimi është zvoglimi dhe heqja e doganave dhe taksave të tjera doganore. Roli të vecante në shqyrtimin mbi doganat , ka luajtur Marrëveshja mbi doganat dhe tregetin (General Agreement on Tariffs and Trade) ose GATT, e cila është e lidhur me 1947 d.m.th. menjëherë pas luftës së dytë botërore, qëllimi i saj ishte që të nxitet tregtia e jashtme

dhe të përgatitet kufizimi i njëanshëm i këtij tregëtimi. Doganat në një vend të zhvillur në mbushjen e arkës së shtetit në shtetet e zhvilluara pjesëmarrja e tyre nuk kalon më shumë se 1-3% ndërsa te vendet në zhvillim dhe ato të pa zhvilluara roli i tyre është disa dhjetëra herë më i madh, ndaj edhe nevoja për një shqyrtim më serioz është e domosdoshme. Në rastin e aplikimit të doganave shteti sot dëshiron të arrijë ose realizojë disa qëllime .

- ✓ **Qëllimi fiskal-** i cili aplikohet për faktin se roli kryesor i doganave është rimbushja e arkës së shtetit. Realizimi i këtij qëllimi parashikohet në politikën ekonomike të shtetit, të cilën dogana është e obliguar që ta zbatojë. Me këtë politikë caktohen raportet që do të vendosen në vendet e caktuara më konkretisht masat ose letësimet ndaj vendeve të caktuara në një periudhë të caktuar.
- ✓ **Qëllimi tjetër** është ai mbrojtës me anë të së cilit mbrohen prodhuesit e brendshëm dhe ekonomia në tërësi. Se cili duhet të jetë çmimi që vendoset në dogana ajo varet nga politika e shtetit. Në ato të mirëfillta përmes takses doganore ndëshkohen prodhimet e huaja, importi, ndërsa stimulohen prodhimet e brendshme me qëllim të eksportimit në vendet tjera. Me një fjalë doganat përdoren për të stimuluar zhvillimin sa më të shpejtë të ekonomisë vendore. Doganat ekonomike mund të jenë me karakter edukativ, ushtarak strategjik, social mbrojtës. Përmes doganave antidamping mbrohen prodhuesit e vendit nga çmimet te lira të mallrave të huaja të cilat kanë synim pushtimin e tregut vendor. Ndërsa doganat janë kundërmasë të cilën e ndermer shteti ndaj një shteti të caktuar si përgjigje për masat negative që merr shteti tjetër. Dhe kjo masë zgjat varësisht nga masa e shtetit tjetër apo thënë më mirë mvarenga raportet ndërshtetërore. Gjithashtu përmes doganës realizohet edhe një qëllim tjetër tejet i rëndësishëm, mbrojtja e shëndetit nga depërtimi i sëmundjeve eventuale, të cilat mund të barten nga vendet tjera në vendin tonë d.m.th. mbrojtjen e një ekonomie të shëndoshe vendore.

KAITULLI V

5. QËNDRUESHMËRIA E FINANCAVE PUBLIKE DHE SISTEMI TATIMOR NË KOSOVË

5.1. QËNDRUESHMËRIA E FINANCAVE PUBLIKE

Qëndrueshmëria e financave publike dhe politikave të shëndosha fiskale ka qenë gjithmonë objektivi kryesor i Qeverisë së Kosovës. Me qëllim të ruajtës së qëndrueshmërisë së financave publike, Kosova ka miratuar një rregull fiskal i cili kufizon deficitin e përgjithshëm në 2% të GDP-së me qëllim që të paracakton trajektoren e borxhit shtetëror në nivelet stabilizuese nën pragun e përcaktuar me ligj. Për më tepër, në vitin 2010, Qeveria e ka vendosur kufirin bazuar në rregulla të borxhit në 40% të GDP-së dhe gjithashtu kohët e fundit e ka miratuar një rregull të pagave e cila vendos një prag mbi nivelin e pagave publike me qëllim të kufizimit të mundësisë për rritjen e pagave publike gjatë viteve të zgjedhjeve. Përveç kësaj, analiza e qëndrueshmërisë së borxhit e kryer në këtë seksion, vlerëson efektin e ndryshimeve në variablat makroekonomikë mbi nivelet e borxhit. Prandaj, analiza tregon se nuk ka rrezik të shqetësimit për borxhe të ardhshme, edhe pse kjo analizë është e bazuar vetëm në supozimin se niveli i deficitit do të kufizohet në 2% të GDP-së, pavarësisht nga ndryshimet e mundshme në strukturën e shpenzimeve buxhetore. Sipas parashikimeve demografike të kryera nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, struktura e popullsisë nuk është parashikuar që të ndryshojë në shkallë të konsiderueshme deri në vitin 2060. Aktualisht, popullsia në Kosovë është shumë e re, me një mesatare të moshës prej afro 28.2 vite në 2011 dhe me një popullatë ndërmjet 15-65 vite që e përbën më shumë se gjysmën e popullsisë. Projektionet e popullsisë tregojnë se në vitin 2060 struktura e popullsisë nuk do të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme me 58% duke u dominuar nga popullata brenda gamës prej meshës 15- 65 vjeçare dhe popullsia mbi moshën 65 vjeçare e përfaqëson 29% të populates. Sistemi pensional aktual në Kosovë funksionon përmes dy shtyllave:

Shtylla I ose skemën e pensioneve bazë të pleqërisë e cila është e financuar nga shteti dhe është paguar për çdo individ më të vjetër se 65 vjeç, dhe Shtylla II e cila është plotësisht e financuar nga skema pensionale e detyrueshme që i obligon të gjithë punëdhënësit dhe punëtorët të kontribuojnë secili me nga 5% të 46 pagës bruto. Ky fond menaxhohet nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) dhe këto pasuri janë investuar kryesisht jashtë vendit nga menaxherët e mirënjohur të Evropian të aseteve.

Duke marr parasysh se shtylla II financohet plotësisht, rreziku për qëndrueshmërinë e sistemit të pensioneve nuk është paraparë të jetë i madh. Fondet e përvetësuara në buxhetin 2016 për financimin e Shtyllës I të skemës së pensioneve e arrijnë shumën rreth 211 milionë euro ose rreth 3.5% të GDP-së. Në vitin 2014, parlamenti e miratoi ligjin e pensioneve ku u futën disa ndryshime në pensionit bazë për përfituesit që kanë kontribuar në ish skemën 'pay-as-you-go'. Për këtë qëllim, MPMS-ja ka lëshuar një udhëzim administrativ i cili i përshkruan kriteret e shkollimit dhe përvojës si bazë mbi të cilën do të përcaktohet shkalla e përfitimit pensional. Kostoja shtesë për buxhetin për këto ndryshime arrin në rreth 23 milionë euro një shumë që është përfshirë tashmë në ndarjet buxhetore 2016.

5.1.1. Analiza e qëndrueshmërisë së borxhit

Shkalla e Borxhit shtetëror të Kosovës mbetet relativisht e ulët nga shkalla maksimale e lejuar me ligj, prandaj rreziku i shqetësimit për borxhin mbetet i moderuar. Megjithatë, raporti aktual i borxhit është i ulët, pjesërisht, një rezultat i historisë së shkurtër të lëshimit borxhit dhe doemos nuk rezulton nga politikat e përshtatshme të borxhit të miratuar nga qeveria.

Megjithatë, për herë të parë, në vitin 2014 Qeveria e miratoi rregullin fiskal i cili kufizon deficitin e përgjithshëm në 2% të GDP-së me synimin të stabilizimit të shkallës së borxhit nën pragun e lejuar me ligj (p.sh. 40% e GDP-së). Duke pasur parasysh shkallën e ulët të borxhit ndaj GDP-së dhe bllokimet ekzistuese infrastrukturore me të cilat vendi vërtetë po përballet, gjatë vitit 2015 Qeveria e miratoi 'klauzolën e investimeve' që i lejon qeverisë të financojë në projekte shtesë për përmirësimin e rritje të financuara nga IFN. Për këtë qëllim, DSA (shpenzimet ditore për jetesë) e kryer në këtë seksion, i shtjellon dy skenarë kryesore, domethënë skenarin bazë dhe skenarin e klauzolës së investimeve. Qëllimet e

mëtejshme analizës synojnë të paraqesin analizën e ndjeshmërisë së borxhit me ndryshimet në treguesit themelor makroekonomikë. DSA e Kosovës është kryer duke përdorur mjetin e zhvilluar nga njësia makro në kuadër të Ministrisë së Financave. Për të kryer analizën, janë bërë disa supozime mbi treguesit bazë makroekonomik si dhe mbi treguesit e borxhit. Nivelet e borxhit janë shqyrtuar duke përdorur treguesit e rrezikut të hartuar nga Banka Botërore, FMN-ja për vendet në kategorinë mesme të zbatimit të politikave.⁸

Treguesit e borxhit dhe barra e pragjeve të borxhit e përpiluara nga BB-FMN dhe përqindja e borxhit të kufizuar me ligj janë si më poshtë:

- ✓ Vlera aktuale neto (VAN) e borxhit ndaj GDP-së – 40%
- ✓ VAN e borxhit për eksportin e mallrave dhe shërbimeve – 150%
- ✓ VAN i borxhit për të ardhurat buxhetore – 250%
- ✓ VAN e servisimit të borxhit për eksportin e mallrave dhe shërbimeve – 20%
- ✓ VAN e servisimit të borxhit për të ardhurat e buxhetit – 30%

Supozimet mbi treguesit makroekonomikë dhe të borxhit janë si më poshtë:

- ✓ Rritja Nominale e GDP prej 6.0% - Aksionet e eksportit ndaj GDP rriten me 0.2 p.p.
- ✓ Norma e interesit të kredisë komerciale është 5%
- ✓ Norma e re koncesionale e interesi të kredisë është 0.75% - Kredi komerciale maturohet pas 5 vitesh
- ✓ Kredi koncesionare maturohet pas 10 vitesh
- ✓ Pjesa e kredisë komerciale nga totali i huamarrjes së re rritet nga 50% në vitin 2015 në 70% në vitin pasues
- ✓ Bilanci bankar ndaj GDP-së është 4.5%
- ✓ Deficiti i përgjithshëm ndaj GDP është 2%
- ✓ Të ardhurat buxhetore në 24% të GDP-së

5.2. SISTEMI TATIMOR NË KOSOVË

Republika e Kosovës ka aplikuar një sistem tatimorë duke u orjentuar në praktikat më të avancuara nderkombetare, si orjentim i ndertimit të sistemit tatimore në Kosovë ishin ato te sitemeve si motra të vendeve të BE-së. Duke e ditur orjentimi tonë dhe synimet

⁸ ‘World Bank’s Country Policy and Institutional Assessment’ (CPIA)

strategjike dhe praktike qe Kosova ka për të u antarsuar në BE dhe institucionet e BE-se atëher edhe Politika fiskale e jonë në forme te njëanshme eshte pershtatur me bazen ligjore te BE-se. Ky orjentim rreth ndertimit te STK posaqerisht si bazë ka marrë tatimet dhe politikat doganore (Tatimet direkte dhe indirekte).

Sistemi Tatimor i Kosovës sikur se edhe sistemet e vendeve te zhvilluare është i ndertuar në një varge ligjesh dhe aktesh tjera nenligjore, STK e përbëjnë keto akte normative:

1. Tatimi në të Ardhurat Personale (TAP)
2. Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK)
3. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)
4. Detyrimeve Doganore
5. Shmangja e tatimit të dyfishtë
6. Dispozitat e Veçanta
7. Transferimi i Çmimeve
8. Akciza

Dokumenti bazohet në ligjet relevante në fuqi dhe zbatohen nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës.

5.2.1. Tatimi në të ardhurat e korporatave (TAK)

Bazuar në legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, Tatimi në të Ardhurat e Korporatave është tatim i obliguar dhe obligion të gjitha të ardhurat e korporatave që konsiderohen të tatueshme të i nenshtrohen. Të gjithë tatimpaguesit që realizojnë të ardhura bruto vjetore deri 50,000€ taten në masën 3 përqindë, ketu përfshinë veprimtarite si: tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme komerciale) Ndersa me masen 9 perqind për veprimtaritë shërbyese, profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme.

Tatimpaguesit me të ardhura bruto vjetore mbi 50,000€ taten me 10% në të ardhurat e tatueshme.

Të ardhura që taten, janë të hyrat apo ndryshimi në mes të të ardhurave bruto të pranuar apo të rrjedhura/akruara gjatë një periudhe tatimore dhe zbritjeve/lejimeve të lejueshme në lidhje me të ardhurat bruto të tilla.

- Për Tatimin në të Ardhura të Korporatave, periudhë tatimore është e barabartë me vitin kalendarik.

• Obliguese ndaj keti tatimi sipas Ligjit për Tatim në të Ardhura të Korporatave, janë, të gjitha organizimet biznesore të me poshtme:

- ✓ Korporata apo ndonjë ndërmarrje tjetër afariste që ka statusin e personit juridik sipas ligjit në fuqi në Kosovë, - Shoqëria tregtare që vepron me pasuri në pronësi shoqërore ose publike,
- ✓ Personi jo rezident me njësi të përhershme në Kosovë.
- ✓ Organizata e regjistruar si organizatë jo-qeveritare;

Objekti i tatimit Objekt i tatimit për tatimpaguesin rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë dhe jashtë Kosovës.

Objekt i tatimit për tatimpaguesin jo rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë.

Norma tatimore Tatimit në të Ardhura të Korporatave është dhjetë për qind (10%) e të ardhurave të tatueshme.

Të ardhurat e liruara nga masa tatimore apo nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave janë të renditura me poshtë:

Të ardhurat e OJQ-ve, të cilat organizata në bazë të ligjeve të Kosovës e kane siguruar Statutin e OJQ me beneficion publik dhe që kane si objektiv ofrimit e te mirave dhe shërbimeve ne interes të publikut. Zakonishte keto OJQ janë si: Per personat me nevoja te veçanta, Invalidet e Luftes, Organizatat humanitare vvendore e nderkombetare, grupett e ndryshem vullnetare etj.

Të ardhurat e BQK-së (Bankës Qendrore të Kosovës) por edhe të institucioneve shtetore financiare, kombetare e ndërkombëtare dhe që kanë leje dhe autorim për të vepruar në Kosovë dhe për interesa shtetore-qeveritare.

Interesi nga instrumentet financiare i lëshuar apo garantuar nga Autoriteti Publik i Kosovës;

Të ardhurat e Bashkësive fetare sipas Ligjit për Lirinë Fetare në Kosovë për ushtrimin e aktivitetit ekonomik të veçantë për vet mbështetjen e tyre.

Të ardhurat e kontraktorëve primare ose nën-kontraktorëve, që janë realizuar nga kontraktimi mbi furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të Kombeve të Bashkuara, agjencitë e veçanta të OKB, KFOR-it, dhe Agjencinë Ndërkombëtare për Energji Bërthamore. Ketu nuk lirohen nesë kontraktoret apo nen-kontaktoret jane vendorë.

Të ardhurat e realizuara nga perfituesit pare kontraktual ose nën-kontraktorëve, e që janë krijuar nga marrveshjet kontraktuale me qeveritë e huaja, organet e tyre dhe Agjencitë e ndryshem të Unionit Evropian, Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtarë dhe organizatave të tjera internacionale qeveritare e qee kanë qellim furnizimin me mallrave dhe shërbimeve të projekteve dhe programeve për Kosovën.

Të ardhurat e përfituara nga grantet, subvencionet dhe donacionet, në harmomi me rregullat dhe kushtet e përfitimit.

Dividendi e paguar apo pranuar për personin rezident dhe jo-rezident.

Humbja tatimore nenkupton shumën e humbjes tatimore e cila mund të evidentohet dhe kthehet deri në gjashtë (6) vite të vazhdueshme fiskale dhe e cila mund të zbritje ndaj te gjitha të ardhurave, të cilesdo forme të të ardhure për gjatë vitet e raportuara.

Nëse biznesi ka ndryshim në pronësi prej më shumë se pesëdhjetë përqind (50%) apo nëse një ndërmarrje personale afariste është ndryshuar në ndonjë formë tjetër biznesi (entitet juridik, ortakëri apo të ngjashme.) bartja e humbjes nuk do të lejohet.

Shpenzimet e përfaqësimit Shpenzimet e përfaqësimit do të jenë të kufizuar në një për qind (1%) të të ardhurave bruto vjetore.

Zhvlerësimi E gjithë prona e prekshme e tatimpaguesit që i nënshtrohet zhvlerësimit caktohet në njëren prej kategorive vijuese:

- Kategoria 1 – Norma e zhvlerësimit 5%, ku bëjnë pjesë: ndërtesat dhe strukturat tjera ndërtimore.

- Kategoria 2 – Norma e zhvlerësimit 20%, ku bëjnë pjesë: automobilat dhe kamionët e lehtë, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda, kompjuterët, pjesët shtesë për kompjutera dhe pajisjet tjera për përpunimin e të dhënave, mobiljet dhe pajisjet për zyra, instrumentet pajisjet e tjera shtesë, dhe bagëtitë e shfrytëzuara për prodhim ose për mbarështim;

- Kategoria 3 – Norma e zhvlerësimit 10%, ku bëjnë pjesë: uzinat dhe makineria; inventari i hekurudhës dhe lokomotivat që shfrytëzohen për transportin hekurudhor; aeroplanët; anijet dhe bimët shumë vjeçare dhe shkurret e shfrytëzuara për vreshtari ose për prodhimin e frutave si p.sh. mollët, dardhat, arrat, boronicat dhe të tjera; dhe të gjitha asetet e prekshme që nuk janë përfshirë në Kategorinë 1 apo Kategorinë 2.

Amortizimi Shpenzimet për mjetet e paprekshme, të cilat kanë afat të kufizuar përdorimi, përfshirë patentet, të drejtat e autorit, licencat për vizatime apo modele, kontratat

dhe të drejtat ekskluzive, zbriten në formë të detyrimeve të amortizimit sipas metodës lineare dhe lejimi bazohet në afatin e përdorimit të pasurisë të përcaktuar në marrëveshjen ligjore mbi përvetësimin dhe përdorimin e pasurisë së paprekshme (STK: MF:2014).

Zbritjet e posaçme për pasuritë e reja Lejohet zbritje e veçante prej dhjetë për qind (10%) të çmimit të përvetësimit të pasurisë në vitin në të cilin pasuria është vënë për herë të parë në shërbim. Zbritja prej dhjetë për qind (10%), bëhet përveç zbritjes normale të zhvlerësimit të lejueshëm. Zbritja lejohet vetëm nëse pasuria është e re ose është vënë për herë të parë në përdorim në Kosovë. Zbritja nuk lejohet nëse pasuria është bartur nga një biznes ekzistues ose një biznes i mëparshëm në Kosovë

Tatimi i mbajtur në burim në paga, pensione, interes, të drejtat pronësore dhe qira Punëdhënësi i cili është punëdhënësi kryesor i të punësuarit, mban në burim një shumë të tatimit për periudhën përkatëse të pagesave të pagave, në përputhje me normat e përcaktuara në nenin 6 të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.

Punëdhënësi i cili nuk është punëdhënës kryesor i të punësuarit, mban në burim shumën prej dhjetë për qind (10%) të pagave të tatueshme për periudhën tatimore.

Pensionet e paguara nga, apo për interes të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës apo nga një fond i autorizuar plotësues i pensioneve i rregulluar me legjislacionin mbi kontributet pensionale, si dhe sigurimet shëndetësore sipas Ligjit për Sigurimin Shëndetësor, i nënshtrohet mbajtjes së tatimit në burim nga paguesi i pensioneve apo i sigurimeve shëndetësore të tilla në shkallët e parapara në legjislacionin përkatës për Tatimin në të Ardhurat Personale.

Tatimpaguesi që paguan interes për kreditë e marra duke përfshirë huazimet apo të drejtat pronësore, personave rezidentë dhe jo rezidentë, mban tatimin në burim në shkallën dhjetë për qind (10%) në kohën e pagesës apo kreditimit në llogarinë e përfituesit dhe transferon tatimin e mbajtur në burim në llogarinë e përcaktuar nga ATK, në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

Tatimpaguesi që paguan qira mban tatimin në burim nëntë për qind (9%) në kohën e pagesës apo të kreditimit dhe transferon tatimin e mbajtur në burim në llogarinë e përcaktuar nga ATK, në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës (Ligjit Nr. 05/L-028).

Mbajtja e tatimit në burim për kategori të veçanta - Tatimpaguesi që bën pagesa për personat fizike jo-afariste, bujqit, fermerët, grumbulluesit e materialeve ricikluese, frutave

të malit, bimëve mjekësore dhe të ngjashme me to, në momentin e pagesës mban tatimin në burim në shkallën prej tre përqind (3%) në bruto pagesë.

Mbajtja në burim në pagesa të caktuara për jo-rezidentët - Të ardhurat që i atribuohen një jorezidenti për shërbimet e ofruara fizikisht në Kosovë, si një zbatimës, sikurse është teatri, figurat e lëvizshme, artistë, këngëtar apo muzikant, ose si një sportist, nga aktivitetet e tij apo saj, i nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim nga paguesi i të ardhurave, qoftë të paguara drejtpërdrejt apo tërthorazi personit jo rezident.

Po ashtu, të ardhurat e realizuara nga marrëveshjet apo kontratat, qofshin me shkrim apo me gojë, me personat apo entitetet e Kosovës, nga një person apo entitet jorezident, për shërbimet e kryera fizikisht në Kosovë, i nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim nga paguesi i të ardhurave, përderisa personi apo entiteti jo-rezident nuk ka njësi të përhershme në Kosovë.

Shuma e mbajtjes së tatimit në burim është pesë për qind (5%) e kompensimit bruto.

Trajtimi i aktiviteteve të sigurimit realizohet nga bizneset që mbuklojnë sigurimin e të cilat paguajnë 5% tatim në primet bruto të periudhës tatimore, kjoforë e tatimit e zavenëdeson TAK dhe e mbyll formen e tatimit si korporatë.

Kërkesa për libra dhe regjistrime Tatimpaguesi me të ardhura vjetore bruto prej pesëdhjetëmijë euro (50,000€) ose më tepër dhe ata me të ardhura vjetore bruto më të ulëta se pesëdhjetëmijë euro (50,000€) të cilët zgjedhin të taten në bazë të të ardhurave reale, mban librat dhe regjistrimet në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në nenin 35 të Ligjit për Tatim në të Ardhura të Korporatave dhe Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Pra, tatimpaguesi i tillë mban libra dhe regjistrime në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

Tatimpaguesi me të ardhura vjetore bruto deri në pesëdhjetëmijë euro (50,000€) të cilët nuk kanë zgjedhur të taten në bazë të të ardhurave reale, mban librat dhe regjistrimet në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit për Tatim në të Ardhura të Korporatave dhe Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat (Ligjit Nr. 05/L-028).

- Deklarata e tatimit Tatimpaguesi, nga i cili kërkohet apo ai i cili zgjedh t'i nënshtrohet tatuarjes në bazë të të ardhurave reale, është i obliguar të përgatis dhe deklaroj të ardhurat, duke përshtatur për qëllime tatimore, të ardhurat dhe shpenzimet e raportuara.

- Pagesat e tatimit Tatimpaguesi me të ardhura bruto vjetore deri në pesëdhjetëmijë euro (50,000€) i cili nuk kërkohet ose nuk ka zgjedhur për tatuarje në baza reale, bënë pagesat për tremujor, si në vijim:

Tre përqind (3%) të të ardhurave bruto të pranuar nga tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme komerciale të çdo tremujori, por jo më pak se 37.5€ për tremujor;

Nëntë përqind (9%) të të ardhurave bruto të pranuar, nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme të çdo tremujori, por jo më pak se 37.5€ për tremujor;

Dhjetë përqind (10%) të të ardhurave të tatueshme të qirasë për tremujor (të ardhurat bruto të qirasë të zvogëluara me zbritjet e lejueshme sipas nenit 9, paragrafit 4 të Ligjit për TAK), të zvogëluara nga çdo shumë e tatimit të mbajtur në burim gjatë atij tremujori në pajtim me nenin 30, paragrafin 3 të Ligjit për TAK;

Tatimpaguesi i cili nuk ka të ardhura në një periudhë tremujore, nuk kërkohet pagesë, por tatimpaguesi është i obliguar të dorëzojë formularin me obligim pagese zero.

Tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto mbi pesëdhjetëmijë euro (50,000€) dhe ata që zgjedhin vullnetarisht të taten në bazë të të ardhurave reale, janë të obliguar të bëjnë pagesa paradhënie tremujore për Tatimin në të Ardhura të Korporatave, si në vijim:

Një të katërtën (1/4) e detyrimit të përgjithshëm tatimor për periudhën tatimore në vijim, bazuar në të ardhurën e tatueshme të vlerësuar dhe të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit që lidhen me ato të ardhura, në përputhje me legjislacionin përkatës për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, apo

Për periudhën e dytë dhe periudhat vijuese tatimore për të cilat tatimpaguesi bën pagesën sipas këtij paragrafi, së paku një të katërtën (1/4) e njëqinddhjetë përqind (110%) të detyrimit të përgjithshëm tatimor të periudhës paraprake për periudhën aktuale të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit që lidhen me ato të ardhura, në përputhje me legjislacionin përkatës për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

Tatimpaguesi i cili bën pagesën tremujore paradhënie, obligohet të bëjë një deklaratë vjetore me rregullime përfundimtare të tatimeve dhe paguan shumën e duhur deri më 31 mars të vitit pas periudhës tatimore.

5.2.2. Tatimi në të ardhura personale (TAP)

Kjo formë e tatimit, aplikohet në të gjitha të ardhurat që fitohen si të hyra një person e që janë obligera të taten bazuar në ligjin në fuqi për këtë fushë, në Kosovë është Ligji për Tatimin në të Ardhura Personale që obligon punëdhësin dhe punëmarrsit të realizojnë, deklarojnë dhe paguajnë tatimet 5 % nga punëdhësi dhe 5 % nga punëmarrsi.

Tatimpagues sipas Ligjit janë të gjithë personat që janë banorë të përhershëm apo të përkohshëm në Kosovë, të gjitha format e organizimit të bizneseve, të cilët pranojnë apo realizojnë të hyra bruto nga cilado formë financimi, e këtu përfshihen: aktiviteti biznesor, qiratë, pagat, të ardhurat nga lotarit, interesat, fitimet kapitale, pasurisë e palujtshme, skema pensionale, pra çdo e hyrë që rrit të ardhurat neto të cilido tatimpagueses.

Për Tatimin në të Ardhura Personale, periudhë tatimore është viti kalendarik. Objekt i tatimit për tatimpaguesin rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë dhe jashtë Kosovës. Objekt i tatimit për tatimpaguesin jo rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë.

Të ardhurat bruto nënkuptojnë të gjitha të ardhurat e fituara ose të mbledhura nga cilado formë financimi, (prejastimisht të hyrat që lirohen nga tatimi me bazë ligjore) dhe çdo e ardhur tjetër që rrit vlerën neto të tatimpaguesit.

Normat e tatimit Tatimi në të Ardhura Personale aplikohet sipas shkallëve në vijim:

Tabela 2. Normat e tatimit Tatimi

Norma e tatimit	Të ardhurat mujore	Të ardhurat vjetore
0%	0-80 Euro	0-960 Euro
4%	80-250 Euro	960-3000 Euro
8%	250-450Euro	3000-5400 Euro
10%	Mbi 450 Euro	Mbi 5400 Euro

Burimi: Doktorantja

- Për të ardhurat e tatueshme nëntëqind e gjashtëdhjetë euro (960 €) ose më pak, zero për qind (0%);

- Për të ardhurat e tatueshme mbi nëntëqind e gjashtëdhjetë euro (960 €) deri në tremijë euro (3.000 €), duke përfshirë edhe shumën tremijë euro (3.000 €), katër për qind (4%) të shumës mbi nëntëqind e gjashtëdhjetë euro (960 €);

- Për të ardhurat e tatueshme mbi tremijë euro (3.000 €), deri në pesëmijë e katërqind (5.400 €), duke përfshirë edhe shumën pesëmijë e katërqind (5,400 €), Tetëdhjetë e një pikë gjashtë euro (81.6 €) plus tetë për qind (8%) të shumës mbi tremijë euro (3.000 €); dhe

- Për të ardhurat e tatueshme mbi pesëmijë e katërqind (5,400 €), dyqind e shtatëdhjetë e tre pikë gjashtë euro (273.6 €) plus dhjetë për qind (10%) të shumës mbi pesëmijë e katërqind (5,400 €).

Të ardhurat e përjashtuara -Nga Tatimi në të Ardhura Personale përjashtohen të ardhurat në vijim:

- a) Rrogat e përfaqësuesve të huaj diplomatike e konsullore dhe personeli i jashtëm i Ambasadave apo Zyrave të Ndërlidhjes së shteteve të huaja në Kosovë;
- b) Rrogat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm si dhe punonjësve të jashtëm të organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe organizatave joqeveritare ndërkombëtare;
- c) Rrogat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm si dhe punonjësve të jashtëm të agjencive donatore, të kontraktorëve të tyre apo të fondacioneve që realizojnë ndihmën humanitare, punën e rindërtimit, administratën civile apo ndihmën teknike në Kosovë;
- d) Rrogat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm dhe zyrtarëve të punësuar vendor të Kombeve të Bashkuara dhe të agjencive të saj të specializuara dhe Agjencia Ndërkombëtare për Energji Atomike. - Rrogat e personelit të jashtëm të KFOR-it dhe EULEX-it;
- e) Të ardhurat nga polisat e sigurimit të jetës që paguhen si rezultat i vdekjes së personit të siguruar;
- f) Të ardhurat e kontraktuesit primar ose nën-kontraktuesit, përveç personave vendor, që janë krijuar nga kontratat me qeveritë e huaja, organet e tyre dhe Agjencitë, Bashkimin Evropian, etj.
- g) Pagat e personave me nevoja të veçanta, siç parashihet me ligjet përkatëse për këto kategori; - Pagesat e pensioneve dhe asistencat sociale të paguara nga Qeveria e Kosovës;

- h) Shpenzimet edukative / arsimore të paguara nga një punëdhënës në interes të një të punësuarit;
- i) Asetet e marra apo vlera e aseteve të marra si rezultat i trashëgimisë
- j) Shpenzimet për ndjekje të programit të trajnimit të paguara nga një punëdhënës për një të punësuar për të marrë pjesë në programet zyrtare të trajnimit për të marrë shkathësitë që lidhen me punën - Bursat e marra nga një individ për të marrë pjesë në një institucion për mësim të lartë, shkollë zanati, apo shkollë profesionale, përderisa bursa është paguar drejtpërdrejtë në institucion;
- k) Përfitimet për dëmshpërblime të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore;
- l) Të ardhurat në formë shpërblimi nga institucionet shtetërore për arritje në shkencë, sport dhe kulturë;
- m) Të ardhurat e përfituara nga grantet, subvencionet dhe donacionet, në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit të tyre;
- n) Dividenda e pranuar nga personi rezident dhe jorezident

Në të ardhurat e përgjithshme nga pagat nuk përfshihen:

- a) Kompensimi i shpenzimeve reale të udhëtimeve të biznesit deri në shumën e përcaktuar me akt nënligjor nga Ministri, - Dëmshpërblimi për aksidentet në punë,
- b) Përfitimet në natyrë në formë të shujtave dhe transportit të ofruara nga punëdhënësi për punëtorin duke përjashtuar kompensimin në para, etj.
- c) Tatimpaguesit që pranojnë apo që realizojnë të ardhura prej vetëm një burimi si paga e cila ka qenë subjekt i mbajtjes në burim, nuk janë të detyruar të dorëzojnë deklaratë tatimore vjetore

Të ardhurat nga paga e dytë – Obligohet çdo kontraktues, si punëdhënës në i cili nuk është punëdhënësi kryesor i të punësuarit, që të ndal në burim shumën prej 10% të pagave të tatueshme për periudhën tatimore që raporton.

Mbajtja e tatimit në burim në paga dhe pensione -Secili punëdhënës është përgjegjës për mbajtjen në burim të tatimit në të ardhurat e tatueshme nga pagat e punonjësve të tij gjatë çdo periudhe të pagesës së pagave.

Punëdhënësi i cili është punëdhënësi kryesor i të punësuarit, mban në burim një shumë të tatimit për periudhën përkatëse të pagesave të pagave, në përputhje me normat si në vijim:

Tabela 3. Mbajtja e tatimit në burim në paga dhe pensione

Norma e tatimit	Të ardhurat mujore
0%	0-80 Euro
4%	80-250 Euro
8%	250-450Euro
10%	Mbi 450 Euro

Burimi : Doracaku i ATK-se, Prishtinë 2014

Punëdhënësi i cili nuk është punëdhënës kryesor i të punësuarit, mban në burim shumën prej dhjetë përqind (10%) të pagave të tatueshme për periudhën tatimore.

Punëdhënësi kryesor dhe ai sekondar kontribuon me pesë përqind (5%) mbi pagën bruto të të punësuarit në emër të kontributit pensional.

Punëdhënësi zbret pesë përqind (5%) nga paga bruto e të punësuarit, dhe i paguan në emër të kontributit pensional.

Secili punëdhënës, apo person që kërkohet të mbajë në burim tatimin në paga dhe kontributet pensionale, dorëzon pasqyrën e tatimit dhe kontributit pensional të mbajtur në burim dhe e transferon shumën e tatimit dhe kontributit pensinal të mbajtur në burim në llogarinë e caktuar nga ATK-ja në një bankë, apo institucion financiar, i licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik.

- Tatimi i mbajtur në burim në interes, të drejta pronësore, qira, kategori të veçanta dhe jo-rezidentë. Tatimi i mbajtur në burim në interes, të drejta pronësore, qira, kategori të veçanta dhe për jo-rezidentë aplikohet njësoj sikurse është sqaruar në pjesën e mësipërme tek Tatimi në të Ardhura të Korporatave.

- Deklarata e tatimit Tatimpaguesi, nga i cili kërkohet apo ai i cili zgjedh t'i nënshtrohet tatuarjes në bazë të të ardhurave reale, është i obliguar të përgatis dhe deklaroj të ardhurat, duke përshtatur për qëllime tatimore, të ardhurat dhe shpenzimet e raportuara.

5.2.3. Pagesat e tatimit nga veprimtaritë afariste

Tatimpaguesi me të ardhura bruto vjetore deri në pesëdhjetëmijë euro (50,000€) i cili nuk kërkohet ose nuk ka zgjedhur për tatuarje në baza reale, bën pagesat për tremujor, si në vijim:

Tre përqind (3%) të të ardhurave bruto të pranuar nga tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme komerciale të çdo tremujori, por jo më pak se 37.5€ për tremujor;

Nëntë përqind (9%) të të ardhurave bruto të pranuar, nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme të çdo tremujori, por jo më pak se 37.5€ për tremujor;

Tatimpaguesve te cilet nuk kane të ardhura në një periudhë tremujore, nuk u kërkohet pagesë, por tatimpaguesi është i obliguar të dorëzojë formularin me obligim pagese zero.

Tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto mbi pesëdhjetëmijë euro (50,000€) dhe ata që zgjedhin vullnetarisht të taten në bazë të të ardhurave reale, janë të obliguar të bëjnë pagesa paradhënie tremujore për Tatimin në të Ardhura Personale, si në vijim:

Një të katërtën (1/4) e detyrimit të përgjithshëm tatimor për periudhën tatimore në vijim, bazuar në të ardhurën e tatueshme të vlerësuar dhe të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit që lidhen me ato të ardhura, në përputhje me legjislacionin përkatës për Tatimin në të Ardhurat Personale, apo

Për periudhën e dytë dhe periudhat vijuese tatimore për të cilat tatimpaguesi bënë pagesën sipas këtij paragrafi, së paku një të katërtën (1/4) e njëqinddhjetë përqind (110%) të detyrimit të përgjithshëm tatimor të periudhës paraprake për periudhën aktuale të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit që lidhen me ato të ardhura, në përputhje me legjislacionin përkatës për Tatimin në të Ardhura Personale.

Vlera e importit të lëndës së parë të liruar nga dogana në periudhën janar-gusht 2016 është rreth 62.3 milionë euro apo 10.2 milionë euro ngarkesë e TVSH-së. Sa i përket pajisjeve të teknologjisë informative, 11 biznese janë liruar nga TVSH, ndërsa vlera e importit e liruar nga TVSH në dogana është 1 milionë euro.

Tabela 14. Lirimet nga TVSH nga Dogana e Kosovës janar-gusht 2016

Nr	Përshkrimi	Vlera e importit (€)	Lirim nga TVSH (€)
1	Linjat dhe makineritë e prodhimit	26,266,520	4,669,547
2	Lënda e parë për prodhim	62,455,649	10,191,187
3	Lirim qarkullim të lirë për prodhim	1,543,009	305,394
4	Pajisje të teknologjisë së informacionit	1,028,784	86,102
	Gjithsejte	91,293,962	15,252,230

Burimi: Dogana e Kosoves, punoj Doktorantja

Lirimi i këtyre produkteve nga TVSH nuk paraqet humbje për buxhetin, sepse në të kaluarën kjo shumë i'u është rimbursuar bizneseve. Mirëpo, tashmë bizneset nuk kanë nevojë të presin për rimbursim të TVSH-së deri sa të realizojnë shitjen e produkteve të tyre. Kjo e rrit likuiditetin e bizneseve kosovare dhe gjithashtu mund të ketë efekte në rritje të efijencës. Kjo, ngaqë bizneset janë në gjendje të sigurojnë sasi më të madhe të lëndës së parë në stok. Në mungesë të të dhënave të detajuara financiare për bizneset që kanë

përfituar nga lirimet nga TVSH, është vështirë të maten efektet në efikasitet apo kosto të bizneseve. Në bazë të të dhënave të ATK-së, qarkullimi i bizneseve që kanë përfituar nga lirimet në TVSH është rritur rreth 5%

Kërkesë tjetër e bizneseve sa i përket politikave fiskale që ndikojnë në kosto të prodhimit është largimi i taksës doganore në lëndën e parë dhe paraqitja e pushimeve tatimore për investimet e reja. Së fundmi, Qeveria e Kosovës ka liruar nga taksa doganore naftën e koksit që përdoret si lëndë e parë sidomos nga prodhuesit e materialit ndërtimor.

5.4.3. Ulja e pragut të regjistrimit

Duke pasur par bazë uljen e informalitetit dhe përfshirjes të sa më shumë bizneseve në kuadër të TVSH-së, në ligjin në fuqi për TVSH është ulur pragu i regjistrimit të bizneseve për TVSH. Në ligjin e kaluar, nëse një biznes ka realizuar furnizime më pak se 50,000 euro brenda një viti kalendarik, atëherë ka qenë i liruar nga regjistrimi për TVSH.

Me ndryshimet e pakos fiskale, një biznes duhet të regjistrohet për TVSH nëse tejkalon qarkullimin mbi 30,000 euro, ndërsa pjesa e qarkullimit e cila tejkalon këtë shumë do të tatohet për qëllime të TVSH-së.

Që nga hyrja në fuqi e reformes, numri i bizneseve të regjistruara për TVSH është rritur dukshëm. Para hyrjes së ligjit në fuqi, mesatarja mujore e bizneseve të reja të regjistruara për TVSH ka qenë 163, ndërsa pas hyrjes kjo mesatare është rritur në 326. Megjithatë ulja e pragut të regjistrimit për TVSH mund të rris burokracinë për bizneset e vogla, ky ndryshim është përkrahur nga përfaqësuesit e bizneseve për arsye se ul informalitetin, duke qenë se më shumë biznese përfshihen në kuadër të deklaratimit të TVSH-së.

Rimbursimi.

Me bazën ligjore (udhëzimin e ri administrative), nëse sipas vlerësimit të Administratës Tatimore, një biznes e mbidekalon kërkesën për rimbursim të TVSH-së, atëherë i njëjti detyrohet që të parashtrojë një kërkesë të re apo kërkesën për kreditimin ta bartë për periudhat vijuese. Kjo paraqet kërkesë shtesë ndaj asaj që është rregulluar me ligj. Po ashtu, ky kufizim paraqet problem për bizneset për arsye se procedura e rimbursimit mund të tejzgjatet. Kërkesa për rimbursim mund të marrë shumë kohë për shkak të shqyrtimit prej zyrtarëve rajonale dhe qendrore të ATK-së. Së fundmi, problem

për bizneset paraqet edhe fakti se një pagesë duhet të kryhet në periudhën e njëjtë të faturimit në mënyrë që të kërkohet rimbursim.

5.5. NDRYSHIMET TJERA FISKALE NË KOSOVË

Gjithmone, duke u bazuar ne Vendimin e Qeverise, në mbledhjen e njëjtë të datës 23 Mars 2015, Qeveria e Kosovës mori vendim edhe për ndryshimin e ligjit për Tatimin për të ardhurat e korporatave dhe tatimin për të ardhurat personale.

Nga Janari 2009, shkalla e tatimit në të ardhurat e korporatave në Kosovë është zbritur nga 20 në 10%.¹⁴

Nga 1 Janari 2010, Qeveria e Kosovës me anë të ligjit të ri për TAK ka larguar tatimin në dividend të marrë nga tatimpaguesit rezident dhe jo rezident, ndërkohë që shkalla e tatimit në të ardhurat e korporatave mbetet 10%.

Në ndryshimet apo reformen fiskale të 2015, Qeveria e Kosovës ka rikthyer tatimin në dividendë prej 10% për të Ardhurat e Korporatave TAK, ndërsa tatimi në të ardhurat e korporatave ka mbetur i pandryshueshëm nga ligji i vitit 2010 (10%).

Vlen të theksohet se tatimi në dividend vendoset në kohën e pagesës apo kreditimit. Pra në rast se nga ana e aksionarit vendoset që dividendi të riinvestohet atëherë subjekti juridik është i liruar nga tatimi.

Parimisht, kjo politikë nxit rritjen e investime kapitale dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës. Mirpo nëse i referohemi një studim të bërë nga UNDP me katër industritë më të mëdha prodhuese, është gjetur se përgjysmimi i tatimit në korporata në vitin 2009 nga 20 në 10% nuk ka pasur ndonjë efekt në rritjen e këtyre industrive.¹⁶ Rjedhimisht, as ky ndryshim nuk pritet të ketë ndonjë efekt të madh në rritjen e investimeve nga ana e korporatave të cilat veprojnë në Kosovë.

Edhe pse vendosja e tatimit në dividend mund të mos ketë ndonjë efekte tek bizneset, ky tatim siguron një barazi në mes të personave që realizojnë të hyra nga pagat dhe që taten në bazë të ligjit për TAP dhe atyre që do të realizojnë të hyra nga dividendat.

¹⁶ UNDP, Ndikimi i Regjimit të Taksave në Katër Sektorë Prodhuës, 2014, Burimi: <http://bit.ly/1QpOozr>

Ndersa si Pako fiskale e reformes kane patur ndikim edhe raportet rreth Ligjit për të Ardhurat Personale (TAP).

Ky ligj nuk ka ndonjë ndryshim thelbësor në shkallën e tatimit mirpo duhet të konsiderohen si ndryshime dhe risi keto ndryshime:

1. Është rritur maksimumi i shpenzimeve të përjashtuara për trajnim nga një mijë në tre mijë euro në rast se ato bëhen jashtë vendit;
2. Shpenzimet e lejuara për zbritje të përfaqësimit janë ulur nga dy në një përqind;
3. Zbritjet e lejuara për aktivitete bamirësie janë rritur në 10% etj.

Që të kemi një pergjigje se cili ishte efekti real i reformes fiskale në vitin 2015, mund të themi se:

1. Ulja e pragut për TVSH nga 50,000 në 30,000 euro pritet të rëndojë bizneset e vogla të cilat në masë të madhe janë gjeneruese të vendeve të punës.
2. Lirimi i TVSH-së në linjat e prodhimit dhe lëndën e parë mund të nxisë investimet në prodhim dhe t'i bëjë produktet vendore më të lira në tregun vendor dhe atë të jashtëm.
3. Megjithë ndikimet pozitive në uljen e çmimeve të disa produkteve, përshkallëzimi i TVSH-së pritet të rrise koston e jetës së qytetarëve të Kosovës.
4. Kjo rritje e koston së jetesës do të reflektojë në të hyra më të mëdha buxhetore me qëllim të balancimit të nevojave buxhetore, zhvillimit ekonomik dhe koston së jetës.

KAPITULLI VI

6. POLITIKA FISKALE NË KOSOVË DHE BASHKIMIN EUROPIAN

6.1. PERSPEKTIVA DHE STRATEGJIA E POLITIKËS FISKALE NË EKONOMINË E KOSOVËS

Vendet e zhvilluara u karakterizuan me zgjerim të aktivitetit ekonomik, ndersa vendet në zhvillim u përballën me ngadalësim të ritmit të rritjes ekonomike. Tendenca për një ekonomi globale është rikuperuar gjatë vitit 2015, megjithëse me diferenca të dukshme në mes të rajoneve.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) gjatë vitin 2015, ka vlerësuar se rritja mesatare e BPV-së në eurozonë ishte 1.5 përqind (0.9 përqind në vitin 2014), ndersa për vitin 2016, rritja ekonomike u projektua të jetë rreth 1.6 përqind. Gjatë vitit 2015, rritja ekonomike në eurozonë është mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme, që mund ti atribuohet kryesisht ndikimit pozitiv që kishin masat e programit të lehtësimit sasior të ndërmarra nga Banka Qendrore Evropiane (BQE). Gjithashtu, çmimet e ulëta të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare, që mbretëruan gjatë gjithë vitit 2015, janë përkthyer në rritjen e të ardhurave të disponueshme të konsumatorëve dhe rritjen e profitabilitetit të firmave, duke nxitur kështu rritjen graduale të investimeve në eurozonë. Përforcimi i kërkesës së brendshme në eurozonë gjatë vitit 2015 është reflektuar pozitivisht në zhvillimet ekonomike të vendeve në Ballkanin Perëndimor.

Në këtë periudhë, aktiviteti ekonomik në Ballkanin Perëndimor u karakterizua me rritje, mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme dhe përforcimi i kërkesës së jashtme. Në vitin 2015, rritja reale e BPV-së në Ballkanin Perëndimor vlerësohet të ketë qenë rreth 2.4 përqind, përderisa për vitin 2016, FMNja parashikoi një përshpejtim të rritjes mesatare të BPV-së në 3.2 përqind. Niveli i ulët i çmimeve të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare, si dhe dobësimi i kërkesës në vendet në zhvillim u reflektua në nivelin e përgjithshëm të çmimeve në nivel global. Sipas FMN-së, shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë në vitin 2015 ishte 0.2 përqind, ndërkohë që parashikimi për vitin 2016 qëndron

në 1.0 %. Ngjashëm me eurozonën, çmimet e ulëta të naftës, energjisë dhe ushqimit në tregjet ndërkombëtare ndikuan edhe në nivelin e çmimeve në vendet e Ballkanit Perëndimor, ku norma mesatare e inflacionit, vlerësohet të ketë qenë 0.9%. Për vitin 2016, për vendet në Ballkanin Perëndimor, FMN-ja u parashikua një rritje të normës mesatare të inflacionit në 1.7 %.

Ekonomia e Kosovës u karakterizua me zgjerim të aktivitetit gjatë vitit 2015 kundrejt vitit paraprak. Sipas vlerësimit të bërë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, vlera nominale e BPV-së në nëntë muajt e parë të vitit 2015 arriti në 4.25 miliard euro, që në terma real, përkon me një rritje mesatare vjetore prej 3.6 përqind. Aktiviteti i përgjithshëm në vend u mbështet kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme, ndersa neto eksportet ndikuan negativisht në normën e rritjes ekonomike. Në kuadër të kërkesës së brendshme, rritja reale e ekonomisë së vendit në nëntë muajt e parë të vitit 2015 vlerësohet të jetë rezultat i rritjes së konsumit dhe investimeve private, ndersa konsumi publik dhe investimet publike vlerësohet të kenë shënuar rënie.

Rritja e kreditimit bankar si dhe rritja e flukseve hyrëse të transfereve nga jashtë, në formë të remitencave dhe kompensimit të punëtorëve rezultuan në rritjen e konsumit privat gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2015. Gjithashtu, rritja e pagave dhe pensioneve të sektorit publik në vend kishte efekt të plotë në vitin 2015, gjë që rezultoi në rritjen e të ardhurave të disponueshme në ekonomi.

Në të njëjtën periudhë, rritja e IHD-ve dhe kredive të reja investuese ndikuan në përforcimin e pozicionit të investimeve private. Rritja ekonomike gjatë vitit 2015 ishte kryesisht rezultat i rritjes së vlerës së shtuar të aktivitetit në sektorin e ndërtimitarisë, bujqësisë dhe furnizimit me energji elektrike.

Për tërë vitin 2015, vlerësimet e BQK-së sugjerojnë se norma reale e rritjes së BPV-së ishte 3.0 përqind. Zhvillimet sektoriale gjatë vitit 2015 tregojnë për një përmirësim të performancës në sektorin e energjisë. Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, prodhimi i energjisë në termocentrale shënoi një rritje vjetore prej rreth 7 përqind, përderisa konsumi i energjisë shënoi një rritje vjetore prej rreth 6 përqind.

Niveli me rritje i shpenzimeve të energjisë elektrike në 2015 është perballuar kryesisht nga shtimi i kapaciteteve prodhuese të energjisë në vend, kurse importi i energjisë elektrike u evidentua se ka një masë rënie. Aktivitetet transportuese kryesisht kanë ecur në trendin e njëzës në prejashtim të sektorit të transportit me binare, pra, transporti

hekurudhor raportiohet se ka shënuar rënie, ketu duhet theksuar se perveq transportit te mallrave edhe transporti i qytetarvve permes sektorit hekurudhor ka shenuar renje, kjo eshte si poasoj e nje sistemi tejte te vjetruar te hekurudhave te Kosoves por edhe te nje kufizimi ne linjat hekurudhore. Momentalisht ne Kosove ekzistojne vetem tri linja hekurudhore ne sherbim te qytetarve dhe mallrave, si dhe nje linje q eeshte kryeshist e lidhur me Korporaten Feronikel nga Drenasi.

Në anën tjetër, transporti ajror është karakterizuar me rritje të numrit të udhëtarëve dhe numrit të fluturimeve në nëntë muajt e parë të vitit 2015. Sa i takone sektorit të industrisë, të dhënat e indeksit për qarkullimin industrial tregojnë për rënie të qarkullimit në sektorin e industrisë nxjerrëse, ndërsa kemi nje rritje të levizshmerise financiare në sektorin e industrisë përpunuese.

Në linjë me zhvillimet në tregjet e jashtme, e veçanërisht me nivelin e çmimeve në eurozonë dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, ekonomia e Kosovës u karakterizua me rënie të nivelit të çmimeve në nëntë muajt e parë të vitit 2015. Norma mesatare vjetore e inflacionit, shprehur përmes indeksit të çmimeve të konsumit, deri në shtator 2015 ishte - 0.6 përqind (0.5 përqind deri në shtator 2014).

Indikatorët tregojnë se kontribuesi kryesor në rënien e nivelit të përgjithshëm të çmimeve në Kosovë në këtë periudhë e kishte rënia e çmimeve të shërbimeve të transportit, që kryesisht është rrjedhojë e rënies së çmimeve të naftës. Shkalla e papunësisë në vend ka shënuar rritje në vitin 2014, duke arritur në 35.3 përqind nga 30 përqind në vitin 2013.

Gjatë vitit 2014, bazuar në të dhënat zyrtare, të rinjtë kishin dy herë më shumë gjasa të jenë të papunë krahasuar me të rriturit, përderisa rreth 61 përqind e popullsisë së re ishte e papunë. Përqindja e të rinjve (15-24 vjeç) të papunë në papunësinë e përgjithshme ishte 28.5 përqind në vitin 2014.

Po ashtu edhe zhvillimet në sektorin fiskal gjatë vitit 2015 tregojnë për një rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Rritja e të hyrave buxhetore për 7.9 përqind dhe rritja e shpenzimeve buxhetore për 6.1 përqind rezultuan në një suficit të përgjithshëm të Buxhetit të Kosovës prej rreth 0.8 milionë euro, krahasuar me deficitin prej 14.8 milionë euro të shënuar në periudhën e njëjtë të vitit paraparak. Sa i përket strukturës së të hyrave buxhetore, deri në shtator 2015, të hyrat tatimore u karakterizuan me rritje si rezultat i rritjes së të dy kategorive, të hyrave nga tatimet kufitare dhe të hyrave të mbledhura nga tatimet vendore.

Nisur nga fakti se shpenzimevet e përgjithshme buxhetore, shpenzimet rrjedhëse (pagat e mëditjet, mallrat e shërbimet dhe subvencionet e transferet) u karakterizuan me një rritje vjetore prej 9.1 përqind. Kurse, shpenzimet qeveritare për investime kapitale shënuan rënie vjetore prej 4.2 përqind. Duhet të jemi te vetedishem se ekonomia e Kosovës vazhdon të ballafaqohet me disekuilibër kundrejt sektorit të jashtëm. Përderisa vlera e shtuar nga sektorët prodhues në vend mbetet e ulët, rritja e kërkesës së brendshme çon në rritje të mëtejme të importit. Rritja e konsumit dhe investimeve në nëntë muajt e parë 2015 ka ndikuar në rritjen e importit në vend, gjë që është përkthyer në rritje të deficitit në llogarinë rrjedhëse. Poashtu, me rënie u karakterizuan edhe bilancet pozitive në llogarinë e shërbimeve dhe të ardhurave parësore, përderisa bilanci pozitiv i të ardhurave dytësore shënoi rritje. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka arritur në 308.2 milionë euro apo rreth 7 përqind të BPV-së deri në shtator 2015, nga rreth 6.7 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Pra, deficiti në llogarinë e mallrave shënoi rritje vjetore prej 2.5 %, duke arritur vlerën prej 1.7 miliard euro.

Realisht si tendence e zhvillimit ekonomik mund të kostatojnë se: vlera e eksportit të mallrave dhe shërbimeve në nëntë muajt e parë të vitit 2015 shënoi një rritje vjetore prej 5.3 përqind, përderisa vlera e gjithsej mallrave dhe shërbimeve të importuara shënoi një rritje prej rreth 2.6 përqind.

Dergesat e pranuar në Republikën e Kosovës, apo remitencat shprehin renditjen më me te laret ne rangun e te hyrave sekondare, ato ne shifra reale paraqesin shumen prej 568.8 mil euro në tremujorine tretë të vitit 2015, apo 12.5 % rritje të te hyrave ne baza vjetore.


Si ilustrim kam paraqitur dinamiten e zhvillimit te remitancave në Kosove me qellim të krijimit të nje pasqyre sa me te sakte te gjendjes ekonomike në vend.

Tabela 15. Analiza dinamike-trendit lineare për remitanca në Kosovë 2008-2013, (në milionë euro)

Përiudha kohore	Dergesat				
	y_i	x_i	$x y$	x_i^2	yc
2008	608.72	-2.5	6.25	-1521.8	595.14
2009	585.7	-1.5	2.25	-878.55	596.42
2010	584.33	-0.5	0.25	-292.17	597.7
2011	584.81	0.5	0.25	292.405	598.98
2012	605.63	1.5	2.25	908.445	600.26
2013	620.83	2.5	6.25	1514.08	601.54
	3590.02		17.5	22.41	3590.02

Burimi: Doktorantja

Figura 11. Paraqitja grafike e Analiza dinamike-trendit lineare për remitanca në Kosovë 2008-2013



Burimi: Doktorantja

Për të kompletuar dhe kalkuluar drejt llogarin financiare, IHD-të e pranuar në Kosovë u karakterizuan me një rritje të theksuar në nëntë muajt e parë të vitit 2015 kundrejt vitit paraprak. Deri në shtator 2015, IHD-të e pranuar në vend arritën vlerën prej 270.4 milionë euro, pra 148.6 milionë euro më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2014. Rritja e theksuar e pozicionit të IHD-ve gjatë vitit 2015 i atribuohet fluksit më të lartë hyrës të IHD-ve krahasuar me vitin paraprak, por edhe efektit të bazës duke qenë se viti 2014 ishte viti me nivelin më të ulët të IHD-ve të regjistruar në vitet e fundit.

Investimet e hua direkte në Kosovë janë kryesisht të përqendruara në sektorët e ekonomisë si patundshmëria, ndërtimtaria, shërbimet financiare, transport, komunikim, dhe energjetikë. Ndonse eurozone ndodhen në shumë sfida në Kosovë IHD shënuan rritje në vitin 2015, pothuajse të gjithë sektorët kanë shënuar rritje sa i përket pranimin të IHD-ve. Në vitin 2015, sektorët që shënuan rritjen më të lartë të IHD-ve të pranuar në vend ishin sektori i patundshmërisë, ai financiar, ndërtimi dhe industria.

Bazuar ne te dhnat e BQK-se shifet qarte se Zvicres paraqet vendin prej nga kanë ardhur më shume IHD gjate vitit 2015 rreth 100 milion € pasuar nga Turqia (49.4 milionë euro), Mbretëria e Bashkuar (32.7 milionë euro), Shqipëria (28.8 milionë euro), Sllovenia (25.3 milionë euro), Gjermania (20.8 milionë euro), Në vitet e fundit, është vënë re një rënie e investimeve portfolio jashtë ekonomisë së vendit, gjë që ndërlidhet me investimet e një pjese të kursimeve pensionale në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Në vazhdim po i paraqesim në tabelë këto të dhëna gjate peridhes qe une kam analizuar ndikimin e remitencave dhe IHD nëndikimin qe kishin ne ekonomi por edhe refleksonet e tyre ne nje administrim me te mire te IHD:


Si argumet ilustrimi po paraqes peridhen 2008-2013 qe te shohim se pavarsishte prolemeve ne suistin financiar te global, vendi yne vazhdimisht ka pasur trent progresiv. Ketu duhet konstatuar se ka shume mungesa ne te dhenat zyrtare pasi qe nje numer i madhe i te hyrave fare nukeshite evidentuar fare dhe kane hyre ne vija klandesiten ne Kosovë

Tabela 16. Levizje e Investimeve te Huaja Direkte në Kosovë 2008-2013

Përiudha kohore	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Republika e Kosovës	366.45	287.41	365.8	393.86	228.64	259.02

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës 2014

Figura 12. Paraqitja rafike e IHD në Kosovë 2008-2013



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës 2014

Bazuar nëargumentet shkencore nga statistika duke aplikuar metoden e trendit analizojme ecurin dhe dinamikën e dukurisë në një periudhë të caktuar kohore, pra, përmes kesaj ne përcjellim ndryshimet sasiore dhe cilësore në periudhës(2008-2013). Analiza Dinamike, konkretisht metoda e trendit $Y_i = Y_c$, ku $Y_i = a + bx$, tentohet të eliminohen apo të zbuten ndryshimet apo variacionet që luhaten në afate të gjate.

Tabela 17. Ndryshimi i IHD në Kosovë 2008-2013

Përiudha kohore	2008	2013	Ndryshimi
Republika e Kosovës	366.45	259.02	(107.43)

Burimi: Doktorantja

Duke përdorur metoden e trendit fitohen seri me të dhëna të reja të rregulluara nga seria faktike. Ndaj në baze të ekstrapolimit bëhet edhe parashikimi apo prognozimi i tendencës së dukurisë, e cila nuk posedon të dhëna origjinale (Nimani 227: 2012).


Në vijim paraqiten të dhënat e analizuar përmes metodës së trendit linear ($Y_c + Y_i$) dhe funksionit të tij $Y_c = a + b * x$

Tabela 18. Trendit Lineare IHD në Kosovë 2008-2013, Vlera në milionë euro

Përiudha kohore	E dhena (IHD) y_i	Periudha x_i	Raporti $y * x$	Ecuria x_i^2	Trendi y_c
2008	366.45	-2.5	6.25	-916.13	376.67
2009	287.41	-1.5	2.25	-431.12	352.75
2010	365.8	-0.5	0.25	-182.9	328.82
2011	393.86	0.5	0.25	196.93	304.9
2012	228.64	1.5	2.25	342.96	280.98
2013	259.02	2.5	6.25	571.6	257.06
	1901.18		17.5	-418.65	1901.18

Burimi: Doktorantja

Figura 13. Paraqitja grafike e trendit per IHD në Kosove 2008-2013 paraqitje në diagram



Burimi: BQK 2014, punoj Doktorantja

Deri në shtator 2015, borxhi i jashtëm i Kosovës (borxhi i jashtëm privat dhe borxhi i jashtëm publik), arriti në 1.9 miliardë euro, që është për 12.3 përqind më i lartë se sa në shtator 2014. Si përqindje e BPV-së, borxhi i jashtëm bruto arriti në 33.2 përqind.

Republika e Kosovës në shtator 2015 (koha kur është shkruar punimi) borxhin e jashtëm kishte në vlerën prej 436.8 milionë euro, një pjesëmarrje prej 22.8 përqind në gjithë borxhin e jashtëm bruto. Pjesa më e madhe e borxhit të jashtëm përbëhet nga huatë ndërmjet kompanive. "Në strukturën e borxhit të jashtëm, FMN ka një pjesëmarrje prej 10.3 përqind, pasuar nga Banka Botërore që ka një pjesëmarrje prej 10.9 përqind, si dhe kreditorët tjerë (më shumë se gjysma e borxhit ndaj kreditorëve tjerë është kreditim ndërmjet kompanive) që kanë një pjesëmarrje dominuese prej 78.9 përqind."¹⁷ Stoku i borxhit publik arriti vlerën prej 719.5 milionë euro në shtator 2015, një rritje kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak prej 30.6 përqind. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 12.5 përqind (10.2 përqind në shtator 2014), që tregon për një shkallë ende të ulët të borxhit publik në Kosovë kur kemi parasysh rregullën fiskale që përcakton kufirin maksimal të borxhit të përgjithshëm publik në 40 përqind të BPV-së. Në shtator 2015, rreth

¹⁷ Raporti vjetor i FMN-se për vitin 2016

51.0 përqind e gjithsej borxhit publik ishte borxh ndërkombëtar (FMN-së dhe Bankës Botërore). Pjesa tjetër prej 49.0 përqind e borxhit publik është borxh i brendshëm, që kryesisht përbëhet nga borxhi i qeverisë ndaj bankave komerciale dhe fondeve pensionale. Deri në shtator 2015, borxhi i brendshëm publik u karakterizua me një rritje vjetore prej 51 përqind, përderisa borxhi i jashtëm publik shënoi rritje vjetore prej 15.6 përqind

Po ashtu edhe sistemi financiar i Kosovës gjatë vitit 2015 është karakterizuar me zgjerim të aktivitetit dhe nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjithë sektorët përbërës të tij. Dinamika e aktivitetit kreditues në vend vlerësohet të ketë qenë në nivelin më të lartë në tri vitet e fundit. Në shtator të vitit 2015, vlera e gjithsej kredive arriti në 2.0 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 7.5 përqind. Ndikim të rëndësishëm në përshpejtimin e rritjes së aktivitetit kreditues ka pasur lehtësimi i standardeve kreditore dhe përmirësimi i kushteve të kreditimit nga ana e bankave. Gjithashtu duhet vlersuar se edhe kërkesat për kredi kane pasur nje ngritje te ndjeshme. Por kjo, edhe pse kishim rritje, si dhe te nje ritmit të përshpejtuar të rritjes së kërkesave kreditore, raporti në mes të kredive bankar dhe BPV-së për vitin 2015 nuk e kaloi masën 35 përqind, dhe si e tillë ishte më i ulët se sa mesatarja e vendeve të rajonit, e cila në mënyrë mesatare u evidentua në masën 48 përqind. Bazuar në këto të dhëna na sugjerojnë se, në raport me madhësinë e ekonomisë, vazhdon të ketë hapësirë për zgjerim të mëtejshëm të aktivitetit kreditor nga sektori bankar. Struktura e kredive vazhdon të dominohet nga kreditë për sektorin e tregtisë, ndërsa sektorë të rëndësishëm siç janë prodhimi dhe bujqësia kanë pjesëmarrje të ulët në strukturën e përgjithshme të portofolit kreditor të sektorit bankar. Sidoqoftë, me gjithë pjesëmarrjen e ulët në gjithsej kreditë, sektori i bujqësisë dhe prodhimit u karakterizuan me rritjen më të lartë të kredive prej 17.4 përkatësisht 10.1 përqind në nëntë muajt e parë të vitit 2015. Në këtë periudhë, rritje të kreditimit shënuan edhe sektori i tregtisë dhe energjetikës, ndërsa sektori i ndërtimit vazhdoi të karakterizohet me rënie të kreditimit për të tretin vit radhazi. Burimi kryesor i financimit për sektorin bankar vazhdojnë të jenë depozitat, që në shtator 2015 shënuan rritje vjetore prej 5.5 përqind. Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, përmirësimi i kushteve të kreditimit nga ana e bankave u realizua kryesisht përmes zvogëlimit të theksuar të normës së interesit, gjë që paraqet një lehtësim të rëndësishëm për qasjen individëve dhe ndërmarrjeve në financimin bankar. "Norma mesatare e interesit në kredi në shtator 2015 u zvogëlua në 7.9 përqind (10.7 përqind në shtator të vitit 2014). Zvogëlimi i normës së interesit ishte evident për kreditë e destinuar për të gjitha

veprimtaritë ekonomike. Rënia më e theksuar e normës mesatare të interesit është shënuar te kreditë për sektorin e shërbimeve (7.4 përqind në shtator 2015 nga 11.2 përqind në shtator 2014), kreditë e sektorit të industrisë (7.4 përqind në shtator 2015 nga 10.3 përqind sa ishte në shtator 2014) si dhe kreditë e sektorit të bujqësisë (9.8 përqind në shtator 2015 nga 11.5 përqind në shtator 2014). Për vitin 2016, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se ekonomia e Kosovës u karakterizua me një rritje reale të BPV-së prej 3.2 përqind."(Nimani 325-18). Rritja reale ekonomike u mbështet kryesisht në rritjen e konsumit privat, ndersa konsumi publik u mbetet i njëjtë me vitin 2015. Gjithashtu, rritjes së ekonomisë në vitin 2016 i kontribuojë edhe përforsimi i pozicionit të përgjithshëm të investimeve, si rezultat i rritjes së investimeve publike dhe private. Rritja e kërkesës së brendshme ndikoi në rritje të importit dhe, rrjedhimisht, në rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse, përkundër pritjeve për rritjen e vlerës së gjithsej eksporteve. Investimet e huaja direkte, si komponenta kryesore e llogarisë financiare në bilancin e pagesave, u karakterizuan me rritje edhe në vitin 2016. Sektori fiskal pritet të karakterizohet me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Ndersa sa i takon sektorit financiar, aktiviteti kredidhënës vazhdoi trendin e rritjes, duke shërbyer kështu si burim i rëndësishëm i financimit të rritjes ekonomike edhe në vitin 2016.

6.2. TRENDET NË EUROZONA

Rritja e aktivitetit ekonomik mbeti e koncentruar në ekonomitë qendrore të eurozonës, në Gjermani, Francë dhe Spanjë, ndersa vendet tjera të eurozonës vazhduan të karakterizohen me rritje të dobët ekonomike (tabela e më poshtme). Aktiviteti ekonomik në eurozonë gjatë vitit 2015 është rikuperuar gradualisht, mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme. Ndërkaq, presionet gjeopolitike dhe ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në vendet në zhvillim ndikuan në dobësimin e eksporteve të eurozonës. Pas më shumë se dy viteve të rritjes graduale të ekonomive të Eurozonës, norma e rritjes reale të BPV-së në eurozonë është përafëruar me rritjen e shënuar në tremujorin e parë të vitit 2008. Deri në shtator 2015, eurozona u karakterizua me një rritje mesatare vjetore prej 1.4 përqind, kundrejt rritjes më të dobët në periudhën e njëjtë të vitit paraprak prej 0.2 përqind.

Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, rikuperimi ekonomik në eurozonë vlerësohet të jetë përforcuar, duke u mbështetur nga rritja e kërkesës së brendshme si rezultat i rritjes së konsumit privat. Sektorët që kontribuuan më shumë në rritjen reale të ekonomisë në eurozonë gjatë vitit 2015 ishin sektori i prodhimit, sektori i shërbimeve tregtare, të transportit, akomodimit dhe ushqimit, si dhe sektori i shërbimeve profesionale dhe të biznesit. Për vitin 2016, FMN parashikon një rritje reale të ekonomisë së eurozonës prej 1.6 përqind.

Tabela 20. Rritja reale vjetore e BPV-së

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015
Eurozona	-0.8	-0.3	0.9	1.5
Gjermania	0.6	0.4	1.6	1.5
Franca	0.2	0.7	0.2	1.2
Italia	-2.8	-1.7	-0.4	0.8
Austria	0.8	0.3	0.4	0.8
Spanja	-2.1	-1.2	1.4	3.1
Greqia	-6.6	-3.9	0.8	-2.3

Burimi: WEO (2016)

Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka luajtur një rol të drejtpërdrejtë në rimkembjen e aktivitetit ekonomik në tere hapsiren e eurozonës, që nga fillimi i vitit 2015, ishte pakoja e masave të reja të lehtësimit sasior që u ndermorren per sektorin e ndërmorise. Gjegjesishte nëfillim të marsit te vitit 2015, Banka Europiane aplikoi programin e lehtësimit sasior, program nga i cili u mundesua blerje të obligacioneve të qeverive evropiane dhe letrave të tjera me vlerë të institucioneve evropiane në shumën prej 60 miliard euro në muaj.

Si argument plus ketu na paraqitet emetimi i parasë së re në ekonominë evropiane qe kishte kryesisht orjentim shmangjen e deflacionit dhe ri vendosjen e normës së inflacionit aty ku synionte BQE-së, dhe kete e beri duke mbeshtetur dhe lehtesuar skemen e kredive bankar për operatoret ekonomik. "Që nga tetori i vitit 2014 e deri në dhjetor të vitit 2015,

BQE ka blerë rreth 143 miliardë euro obligacione të mbështetura dhe rreth 15 miliard euro asete të mbështetura në letra me vlerë¹⁸.

Menjëherë pasi që BQE-ja beri aplikimin e programit të lehtësimit sasior është evidentuar një rishkrim i sistemit ekonomik në eurozonës,(kjo saktësishte vetetohet ne pjesen e pare te viti 2015 kur edhe paraqitet raportit per gjashtemujoruin e pare), ndersa zyrtarët e lartë të BQE-së kanë deklaruar se politikat e lehtësuara monetare në mënyrë të vazhdueshme janë plotësuar edhe me politika të planifikuara makroprudenciale për të siguruar mirëmbajtjen e stabilitetit financiar. Politika e lehtësuar monetare është përkthyer në lehtësim të kushteve për kreditim, duke përmirësuar kështu kushtet e të bërit biznes në eurozonë. Lehtësimi i standardeve kreditore, si dhe rritja e kërkesës për kredi ishte më e theksuar te ekonomitë familjare, megjithëse edhe kreditimi i ndërmarrjeve ka filluar rikuperimin gradual. Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, ekonomitë familjare u karakterizuan me një rritje mesatare të kreditimit prej 0.9 përqind (rënie mesatare vjetore prej 0.4 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2014), ku rritja më e lartë e kreditimit u shënuar në tremujorin e tretë të vitit (1.6 përqind). Në anën tjetër, në periudhën raportuese, kreditimi i sektorit privat u karakterizua me një rënie mesatare prej 0.2 përqind, që tregon për një përmirësim të lehtë të kreditimit të sektorit privat krahasuar me vitin paraprak kur sektori privat u karakterizua me rënie mesatare prej 2.5 përqind të kreditimit.

Investimeve në eurozonë vazhdoi të jetë dukshëm më i ulët krahasuar me nivelin që kishte para krizës financiare të vitit 2008. Megjithatë, në kuadër të pozicionit të investimeve, gjatë vitit 2015 është shënuar një rritje graduale e aktivitetit në sektorin e ndërtimit, sektor që u karakterizua me rënie që nga fillimi i krizës financiare, me rritje më te theksuar te shënuar në sektorin e makinerisë.

Kushtet e kreditimit, si dhe përforcimi i vazhdueshëm i kërkesës dhe rritja e mëtejme e profitabilitetit të firmave, si rezultat i çmimeve më të ulëta të naftës, si dhe përmirësimi i treguesve të tregut të punës, u reflektuan në rritje të investimeve në periudhat në vazhdim.

Edhe vendet në zhvillim u karakterizuan me ngadalësim të rritjes ekonomike në vitin 2015 kundrejt vitit paraprak (Kina), gjegjësisht rënie ekonomike (Rusia dhe Brazili). Dobësimi i kërkesës së jashtme, rritja e normave të interesit nga SHBA-të dhe rënia e

¹⁸ Raporti i BQE për vitin 2015

çmimeve të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare ka ndikuar negativisht në aktivitetin ekonomik të vendeve në zhvillim.

Kjo paraqiteje ishte një pengese shtese pasi eksportet e eurozonës u ndikuan negativisht nga zhvillimet ekonomike në Brazil, Kinë dhe Rusi. Duke qenë partner të rëndësishëm tregtar të eurozonës, zvogëlimi i kërkesës së jashtme nga këto vende shkaktoi dobësim të pozicionit të neto eksporteve të eurozonës.

Por, rritja e kërkesës nga vendet e zhvilluara si dhe dobësimi i monedhës së euros kundrejt valutave tjera ka neutralizuar deri në një masë ndikimin negativ nga vendet në zhvillim. Në linjë me pritjet, niveli i çmimeve të naftës gjatë vitit 2015 mbeti i ulët, duke mbështetur rritjen e mëtejme të konsumit privat dhe investimeve përmes rritjes së të ardhurave të disponueshme për ekonomitë familjare dhe rritjes së profitabilitetit të korporatave.

Niveli i ulët i çmimeve të naftës vazhdoi të reflektohet në nivelin e përgjithshëm të çmimeve në eurozonë ku, sipas BQE-së, shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë deri në shtator 2015 ishte -0.03 përqind, krahasuar me 0.5 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit 2014.

Pjese e dyte e vitit 2015 në eurozone u karakterizua me normë mesatare të inflacionit prej 0.2 përkatësisht 0.0 përqind. Sipas BQE-së, shkalla mesatare vjetore e inflacionit në eurozonë në vitin 2015 ishte 0.0 përqind, përderisa për vitin 2016, BQE u arrit një normë e inflacionit prej 1.0 përqind.

Bazuar në raportin e BQK-së thuhet se: "Ngjashëm me BQE-në, edhe FMN ka vlerësuar se shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë në vitin 2015 ka qenë 0.2 përqind ndërkohë që parashikimi për vitin 2016 ishte i njëjtë me eurozonën, gjegjësisht 1.0 përqind (shih figura 14).


Rënia e vazhdueshme e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare në pjesën e mbetur të vitit 2015 dhe fillimin e vitit 2016 ka neutralizuar deri në një masë ndikimin e programit të lehtësimit sasior, duke ndikuar kështu në presione të ulëta inflacioniste dhe rishikim potencial të parashikimeve si për vitin 2016 ashtu edhe për vitin 2017."¹⁹

Po ashtu edhe sistemi fiskal në eurozone, paraqete këte tendencë ku: në nëntë muajt e parë të vitit 2015, shkalla mesatare e borxhit publik në eurozonë u karakterizua me një rënie

¹⁹ Raporti i BQK-se mbi vlersimet në Eurozon për vitin 2016

tëpra kemi, mesatarisht 92.3 përqind të BPV-së (92.4 përqind e BPV-së në nëntë muajt e parë të vitit 2014).

Figura 14. BPV-së, nga 1.9 sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.



Burimi: BQK 2016

Greqia vazhdon të ketë shkallën më të lartë të borxhit publik në eurozonë (rreth 168 për ind të BPV-së), pasuar nga Italia dhe Portugalia (136 përkatësisht 130 përqind të BPV-së). Në nëntë muajt e parë të vitit 2016, shkalla e llogarisë rrjedhëse të vendeve në eurozonë arriti mesatarisht 2.7 përqind

Por, gjatë vitit 2015, eksportet e eurozonës u ndikuan negativisht deri në një masë nga zvogëlimi i kërkesës nga ekonomitë e mëdha në zhvillim. Në të njëjtën kohë, dobësimi i monedhës së euros u përkthye në rritje të konkurrueshmërisë të mallrave të eurozonës (veçanërisht të Gjermanisë) kundrejt vendeve tjera me të cilat tregton. Programi i lehtësimit sasior nga BQE dhe politika e lehtësuar monetare janë përkthyer në dobësimin e monedhës së euros kundrejt valutave kryesore.

Si përmbledhje e kesaj mund të vëjmë se përpos levizjeve tjera në tregun financiarë edhe levizjet në normat e këmbimit ishin relativisht të larta ku: ²⁰norma mesatare e këmbimit të euros ndaj dollarit amerikan deri në shtator 2015 u zhvlerësua për 17.9 përqind. Ndaj sterlinës britanike dhe ndaj frankës zvicerane, euro u zhvlerësua për 9.6 përkatësisht 12.9 përqind. Sa i përket valutave të vendeve të rajonit, deri në shtator 2015, euro është vlerësuar kundrejt dinarit serb dhe lekut shqiptar për mesatarisht 3.9 përkatësisht 0.1 përqind, përdërisa është zhvlerësuar kundrejt kunës kroate për 0.2 përqind.

²⁰ Raporti i BQK-se mbi vlerësimet në Eurozonë për vitin 2016

6.3. TRENDET E PËRGJITHËSHME EKONOMIKE, KOSOVA DHE RAJONI

Ecuria e zhvillimit ekonomik në vendet rajonale vlerësohet të jetë ringjallur dhe permirsuar gjatë vitit 2015 kundrejt vitit paraprak. Kjo ka çuar në një rritje reale të BPV-së në Ballkanin Perëndimor rreth 2.4 përqind (rreth 1 përqind në vitin 2014). Sipas FMN-së, me rritje më të lartë ekonomike gjatë vitit 2015 u karakterizuan Mali i Zi dhe Maqedonia (3.2 përqind), ndërsa Serbia kishte normën më të ulët të rritjes reale të BPV-së (0.5 përqind) (tabela 2). Përderisa në vitin 2014, rritja e ngadalshme e kërkesës së brendshme dhe përkeqësimi i pozicionit të neto eksporteve ndikuan në dobësimin e aktivitetit ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor, ishin pikërisht këta dy faktor që kontribuan në rikuperimin e aktivitetit të përgjithshëm gjatë vitit 2015 (WEO:2016).

Aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2015, në kuadër të kërkesës së brendshme, vlerësohet të jetë mbështetur si nga rritja e kërkesës, ashtu edhe investimeve, ndërsa ishin sektorët e ndërtimit, prodhimit, industrisë, dhe transportit që u karakterizuan me rritje. Për më tepër, rikuperimi i kërkesës së jashtme u përkthye në një rritje të eksporteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Sipas parashikimeve të FMN-së, vendet në Ballkanin Perëndimor shënuan një rritje mesatare të BPV-së prej 3.3 përqind në vitin 2016 (2.5 përqind në vitin 2015), ku Mali i Zi shënoi normën më të lartë të rritjes prej 4.9 përqind, ndërsa Serbia arriti normën më të ulët të rritjes së BPV-së prej 1.5 përqind.


Tabela 21. Rritja reale vjetore e BPV-së në vendet e Ballkanit Perëndimor

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015
Shqipëria	1.6	1.4	1.9	2.7
Bosnja dhe Hercegovina	-1.2	2.5	1.1	2.1
Kosova	2.8	3.4	1.2	3.0
Maqedonia	-0.5	2.7	3.8	3.2
Mali i Zi	-2.5	3.3	1.5	3.2
Serbia	-1.0	2.6	-1.8	0.5

Burimi: WEO (2016); për Kosovën: ASK dhe vlerësimi i BQK-së për 2015

Ngjashëm me vendet e eurozonës, vendet e Ballkanit Perëndimor janë karakterizuar me shkallë më të ulët të inflacionit në vitin 2015 kundrejt vitit paraprak, që i atribuohet kryesisht çmimeve të ulëta të naftës, energjisë dhe ushqimit në tregjet ndërkombëtare. Norma mesatare e inflacionit në vendet e rajonit në vitin 2015, sipas FMN-së, vlerësohet të ketë qenë 0.9 përqind (figura 3). Në kuadër të vendeve të rajonit, Shqipëria kishte shkallën më të lartë të inflacionit prej 2.2 përqind në vitin 2015, vetëm Kosova u karakterizua me deflacion prej 0.5 përqind.

Figura 45. Shkalla mesatare e inflacionit në Ballkanin Perëndimor, në përqindje



Burimi: World Economic Outlook (2016)

Për vitin 2016, për vendet në Ballkanin Perëndimor, FMN parashikoi një rritje të normës mesatare të inflacionit në 1.7 përqind. Gjendja në tregun e punës në vendet e Ballkanit Perëndimor vlerësohet të jetë përmirësuar në vitin 2015 kundrejt vitit paraprak. Sipas FMN-së, shkalla mesatare e papunësisë në vendet e Ballkanit Perëndimor në vitin 2015 pritej të ishte rreth 24 përqind, me Bosnje dhe Hercegovinën dhe Kosovën që kanë shkallën më të lartë të papunësisë (43.6 përkatësisht 30 përqind). Në kuadër të zhvillimeve në sektorin e jashtëm, vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizuan me përkeqësim të deficitit të llogarisë rrjedhëse në vitin 2015. Norma mesatare e deficitit të llogarisë rrjedhëse në vendet e rajonit në vitin 2015 pritej të ishte 8.9 përqind e BPV-së, që është për 0.3 pikë përqindje më e lartë krahasuar me vitin paraprak. Gjatë vitit 2015, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia raportuan ngushtim të deficitit të llogarisë rrjedhëse, kryesisht si rezultat i zvogëlimit të deficitit në mallra (rritjes më të shpejtë të eksporteve krahasuar me importet) dhe rritjes së fluksit të remitencave. Në anën tjetër, Maqedonia dhe

Kosova u karakterizuan me rritje të deficitit në llogarinë rrjedhëse kryesisht si rezultat i rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe zvogëlimit të bilancit pozitiv në llogarinë e shërbimeve.

Pra, bilanci i Investimeve të huaja direkte (IHD), i cili paraqet një komponentë shumë të rëndësishme për financimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse, është përmirësuar në vitin 2015. Me përmirësim të bilancit të IHD-ve në vitin 2015 u karakterizuan Shqipëria, Kosova dhe Serbia, përderisa me zvogëlim të vlerës së IHD-ve u karakterizua Maqedonia. Sektori bankar në vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizua me ecuri pozitive, e cila u reflektua në përmirësimin e indikatorëve kyç të shëndetit financiar.

6.4. KARAKTERISTIKAT E SISTEMIT BANKAR BALLKANIK

Vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizuan me nivel të kënaqshëm të kapitalizimit të sektorit bankar. Gjatë vitit të fundit shumica e vendeve në regjion përforcuan nivelin e kapitalizimit, ku mesatarja e kapitalit rregullator ndaj asetëve të peshura me rrezik deri në shtator 2015 ishte rreth 18.7 përqind (18.5 përqind në shtator 2014). Niveli i likuiditetit në sektorin bankar në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor shënoi rënie të lehtë krahasuar me vitin paraprak, duke zvogëluar mesataren e regjionit në 30.2 përqind në shtator 2015 (31.3 përqind në shtator 2014). Në kuadër të performancës së sektorit bankar, vendet në Ballkanin Perëndimor shënuan përmirësim edhe të kualitetit të portfolios kreditore, ku niveli i kredive jo performuese zbriti në 14.5 përqind mesatarisht në nëntë muajt e parë 2015 krahasuar me nivelin prej rreth 15 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Po ashtu edhe treguesit e profitabilitetit shënuan përmirësim krahasuar me periudhën paraprake, ku ROA e rajonit u përmirësua në 0.8 përqind në nëntë muajt e parë të vitit 2015 (0.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2014), kurse ROE u përmirësua në mesatarisht 5.9 përqind në nëntë muajt e parë 2015 (4.6 përqind në nëntë muajt e parë 2014).

6.4.1. Bruto Produkti Vendor në Kosovë

Duke u mbështetur në vlerësimet nga ASK, në nëntë muajt e parë të vitit 2015, Bruto Produkti Vendor (BPV) ka arritur vlerën nominale prej 4.25 miliard euro (4.12 miliard euro


në nëntë muajt e parë 2014).² Në terma real, gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2015, BPV vlerësohet të ketë shënuar një normë mesatare të rritjes prej 3.6 përqind. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik në këtë periudhë ishte kryesisht rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme, gjegjësisht konsumit dhe investimeve. Gjatë kësaj periudhe, neto eksportet ndikuan negativisht në normën e rritjes ekonomike. Sipas statistikave të publikuara nga ASK, në tremujorin e parë të vitit 2015, BPV shënoi një rritje vjetore prej 1.7 përqind, kundrejt rritjes prej 0.3 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Në tremujorin e dytë 2015, ekonomia e Kosovës u karakterizua me një rritje më të shpejtë vjetore prej 4.8 përqind (rënie vjetore prej 1.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2014), përderisa në tremujorin e tretë 2015 rritja reale e BPV-së ishte 4.0 përqind (2.9 përqind në tremujorin e njëjtë të vitit 2014). Vlerësimet fillestare të BQK-së për tërë vitin 2015 sugjeruan se vlera nominale e BPV-së kishte arritur në 5.76 miliard euro, që paraqet një normë reale të rritjes prej 3.5 përqind (1.2 përqind në vitin 2014) (figura poshte shënuar). Duke pasur parasysh zhvillimet në ekonominë e vendit gjatë tremujorit të katërt të vitit 2015, vlerësimet e BQK-së sugjerojnë se norma reale e rritjes së BPV-së në vitin 2015 ka qenë 3.0 përqind. Në tremujorin e katërt të vitit 2015 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit 2014, rrjedha e transferave të pranuar në vend nga sektori i jashtëm u karakterizua me rënie. Shuma e remitencave të pranuar në Kosovë dhe të hyrat nga kompenzimi i punëtoreve ishin për 2.4 përkatësisht 3.4 përqind më të ulëta në të tremujorin e katërt të vitit 2015 kundrejt tremujorit të katërt të vitit paraprak. Shuma e kredive të reja konsumuese të lëshuara gjatë këtij tremujori ishte për 19.5 përqind më e ulët krahasuar me shumën e kredive të reja konsumuese të lëshuara në tremujorin e katërt të vitit 2014.

Tremujori i katërt i vitit 2015 ishte më pak i favorshëm krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak edhe për sa i përket tregtisë së jashtme. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve gjatë tremujorit të katërt të vitit 2015 shënoi rënie vjetore prej 9.0 përqind, përderisa në të njëjtën periudhë, importi i mallrave dhe shërbimeve shënoi rënie vjetore prej 0.8 përqind.

Rrjedhimisht, deficitin në neto eksporte shënoi rritje prej 3.9 përqind në tremujorin e katërt të vitit 2015, duke ndikuar negativisht rritjen reale të ekonomisë së vendit

Figura 16. Norma reale e rritjes së BPV-së



Burimi: ASK 2016

Ecuria e aktivitetit ekonomik në vend në nëntë muajt e parë të vitit 2015 vlerësohet të jetë përshpejtuar kundrejt vitit paraprak, kryesisht si rezultat i rritjes së konsumit të përgjithshëm dhe investimeve për 1.5 përkatësisht 9.2 përqind. Në këtë periudhë, komponenta e konsumit kontribuoi në rritjen vjetore të BPV-së reale me rreth 1.7 pikë përqindje, përderisa investimet kontribuan me 2.5 pikë përqindje. Komponenta e neto eksporteve kontribuoi negativisht në rritjen vjetore ekonomike me 0.4 pikë përqindje në nëntë muajt e parë të vitit 2015.

Struktura e BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve dominohet nga konsumi, që në nëntë muajt e parë 2015 kishte një pjesëmarrje prej 101.8 përqind në gjithsej BPV-në (104.2 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2014). Në anën tjetër, pjesëmarrja e investimeve në BPV arriti në 27.5 përqind (26.0 përqind në nëntë muajt e parë 2014). Komponenta e neto eksporteve vazhdon të ketë pjesëmarrje negative në BPV me normë prej -29.3 përqind (-30.2 përqind në nëntë muajt e parë 2014). Duke analizuar konsumin e përgjithshëm, konsumi privat shënoi rritje vjetore prej 2.6 përqind në nëntë muajt e parë të vitit 2015. Rritja e konsumit privat gjatë kësaj periudhe është mbështetur nga rritja e kreditimit bankar si dhe nga flukset më të mëdha hyrëse të transfereve nga jashtë në formë të remitencave dhe kompensimit të punëtorëve.


Ndonse rritja e pagave dhe pensioneve të sektorit publik në vend kishte efekt të plotë në vitin 2015, duke ndikuar kështu në rritjen e mëtejme të të ardhurave të disponueshme në ekonomi. Megjithëte, përkundër rritjes nominale prej 4.2 përqind të konsumit publik në nëntë muajt e parë 2015, sipas ASK-së, në terma real kjo komponentë shënoi rënie vjetore prej 4.5 përqind në periudhën raportuese. Tendenca renese reale në konsumit publik ishte kryesisht pasojë e efektit të deflatimit që kishte rritja e pagave për punonjësit e sektorit

publik. Në kuadër të BPV-së, pozicioni i përgjithshëm i investimeve u karakterizua me rritje vjetore prej 9.2 përqind, mbështetur kryesisht në rritjen e investimeve të sektorit privat.

Trendet rritese në IHD-ve dhe kredive të reja investuese gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2015 ndikuan në përforcimin e pozicionit të investimeve private. Gjatë kësaj periudhe, investimet publike shënuan rënie.

Ndikimi i rritjes së eksporteve të mallrave dhe shërbimeve kosovare u mënjanua nga rritja më e shpejtë e importit, duke rezultuar kështu në zgjerimin e deficitit të pozicionit të neto eksporteve për 1.3% në nëntë muajt e parë të vitit 2015

Figura 57. Struktura e komponentëve të BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve, në përqindje per vitin 2014 dhe 2015




Burimi: ASK 2016

6.4.2. Qasja e prodhimit

Organogrami struktural i BPV-së në Kosovë dominohet nga sektorët e shërbimeve , që kanë një pjesëmarrje prej afërsisht 50 përqind në strukturën e përgjithshme të BPV-së. Në kuadër të gjithsej BPV-së, administrimi publik ka një pjesëmarrje prej 13.4 përqind, pasuar nga sektori i tregtisë dhe bujqësisë, që kanë pjesëmarrje prej 12.2 përkatësisht 11.3 përqind në gjithsej BPV-në. Nivel relativisht të konsiderueshme kanë edhe sektori i industrisë përpunuese (9.7 përqind) dhe afarizmi me pasuri të patundshme (8.8 përqind) (figura loshteshenuar). Për dallim nga nëntë muajt e parë të vitit 2014, kur rritja ekonomike ishte mbështetur kryesisht nga rritja e aktivitetit në sektorin e tregtisë, sektorin financiar dhe të sigurimit, si dhe në shërbime tjera, në nëntë muajt e parë të vitit 2015 rritja

ekonomike ishte kryesisht rezultat i rritjes së aktivitetit në sektorin e ndërtimtarisë, bujqësisë dhe furnizimit me energji elektrike.

Figura 6. Komponentët e BPV-së, sipas aktivitetit ekonomik, në miliard euro



Burimi: ASK 2016

Ndërtimtaria kontribuoi me 0.9 pikë përqindje në rritjen vjetore të BPV-së reale në nëntë muajt e parë të vitit 2015, pasuar nga furnizimi me energji elektrike (0.6 pikë përqindje). Rritja e vlerës së shtuar të aktivitetit ekonomik në sektorin e bujqësisë ndikoi që ky sektor të kontribuojë në rritjen e përgjithshme të BPV-së me 0.5 pikë përqindje.

Ecuri të mirë shfaqti edhe sektori i tregtisë, që kontribuoi me 0.5 pikë përqindje. Trendi rrites i BPV-së në vend është mbështetur edhe nga rritja në shërbimet e transportit dhe hotelet e restorantet, që kontribuan me 0.2 pikë përqindje. Në anën tjetër, ndikim negativ në rritjen vjetore të BPV-së deri në shtator 2015 kishin sektorët e administrimit publik dhe shërbimeve tjera që kontribuan me -0.7 përkatësisht -0.1 pikë përqindje. Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, me rritje më të shpejtë të vlerës së shtuar të aktivitetit u karakterizuan sektori i furnizimit me energji elektrike (16.1 përqind), pasuar nga sektori i ndërtimtarisë (13.6 përqind), sektori i transportit (5.8 përqind) dhe sektori i bujqësisë (4.0 përqind). Gjatë kësaj periudhe, me rënie vjetore u karakterizua vlera e shtuar në aktivitetin e administrimit publik (5.0 përqind), sektorit të shërbimeve tjera (1.2 përqind) dhe vlera e shtuar në aktivitetin e shërbimeve financiare dhe të sigurimit (0.9 përqind). Sa i përket zhvillimeve tremujore në aktivitetin ekonomik në vend, në tremujorin e parë të vitit 2015,

rritja ekonomike vlerësohet të jetë mbështetur kryesisht nga aktiviteti në sektorin e bujqësisë, që shënoi një rritje vjetore prej 3.5 përqind. Gjithashtu, gjatë tremujorit të parë 2015, me rritje u karakterizuan edhe sektorët si tregtia (3.9 përqind), transporti (9.0 përqind) dhe aktivitetet financiare (4.6 përqind). Aktiviteti ekonomik në tremujorin e dytë rezultoi të jetë mbështetur nga përmirësimi i mëtejshëm i aktivitetit në sektorin e bujqësisë, që shënoi një rritje vjetore prej 6.1 përqind, pasuar nga sektori i tregtisë dhe transportit që shënuan një rritje vjetore prej 6.9 përkatësisht 5.3 përqind

Në pjesën e parë, me rënie prej 7.5 përqind u karakterizua sektori i aktivitetëve financiarë dhe të sigurimit. Përderisa aktiviteti në sistemin financiar në nëntë muajt e parë 2015 është karakterizuar me rritje, vlera e shtuar në aktivitetet financiare dhe të sigurimit vlerësohet të ketë shënuar rënie kryesisht si pasojë e zvogëlimit të kostos së ndërmjetësimit financiar gjatë kësaj periudhe. Gjatë tremujorit të tretë, me performancë të mirë u karakterizuan sektorët si bujqësia, industria përpunuese, ndërtimtaria dhe tregtia. Në këtë periudhë, vlera e shtuar në aktivitetin bujqësor u karakterizua me një rritje vjetore prej 2.1 përqind, pasuar nga sektori i ndërtimit (25.8 përqind), industrisë përpunuese (1.3 përqind) dhe tregtisë (2.5 përqind). Në anën tjetër, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2015, vlera e shtuar në aktivitetin e sektorit të administrimit publik dhe vlera e shtuar në aktivitetin e shërbimeve tjera shënuan rënie prej 7.3 përkatësisht 0.3 përqind.

Tabela 23. Treguesit kryesor makroekonomik në Kosovë

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015 (v)	2016 (p)
	<i>Në milionë euro (vlera nominale)</i>				
Bruto Produkti Vendor (BPV)/1	5,058.8	5,326.6	5,567.5	5,706.8	5,939.1
Konsumi	5,320.4	5,539.4	5,855.3	5,928.9	6,094.6
Investimet	1,465.1	1,470.9	1,434.9	1,545.8	1,665.6
Neto Eksportet	-1,726.7	-1,683.6	-1,722.7	-1,767.9	-1,821.2
	<i>Ndryshimi në përqindje, në terma real</i>				
Rritja reale e BPV-së/1	2.8	3.4	1.2	3.0	3.2
Konsumi	2.6	2.2	3.7	1.8	2.1
Investimet	-12.9	-0.3	-5.0	8.3	8.6
Neto Eksportet	-12.1	-3.6	3.9	3.3	4.4
	<i>Në milionë euro (vlera nominale)</i>				
Llogaria Rrjedhëse/2	-380.2	-339.4	-437.6	-541.1	-594.1
Importi i Mallrave	-2,332.0	-2,287.0	-2,382.9	-2,431.8	-2,504.5
Eksporti i Mallrave	281.9	291.5	324.3	322.5	330.9
Importi i Shërbimeve	-317.6	-320.3	-431.3	-435.5	-447.4
Eksporti i Shërbimeve	641.4	632.5	767.2	776.9	799.9
Remitencat/2	605.1	620.8	693.8	752.4	775.0
	<i>Në milionë euro (vlera nominale)</i>				
Gjithsej kreditë e sektorit bankar për sektorin privat/2	1,739.5	1,785.7	1,881.3	2,018.4	2,149.7
Gjithsej depozitat e sektorit privat në sektorin bankar/2	2,115.8	2,285.9	2,377.9	2,550.4	2,701.9
	<i>Në milionë euro (vlera nominale)</i>				
Buxheti i Kosovës/3					
Gjithsej të hyrat primare dhe grantet	1,321.7	1,325.3	1,343.2	1,466.5	1,537.7
Gjithsej shpenzimet primare	1,441.0	1,485.2	1,477.3	1,565.6	1,648.1
Deficiti i përgjithshëm si % e BPV-së	-3	-3	-3	-2	-2
	<i>Ndryshimi në përqindje</i>				
Rritja ekonomike reale/4					
Globale	3.4	3.3	3.4	3.1	3.6
Eurozona	-0.8	-0.3	0.9	1.5	1.6
Vendet në zhvillim të Evropës	1.3	2.9	2.8	3.0	3.0

1/ Agjensia Statistikore e Kosovës për vitet 2012-2014

2/ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për vitet 2012-2014

3/ Ministria e Financave për vitet 2012-2014

4/ Fondi Monetar Ndërkombëtar për vitet 2012-2016 (

v) Vlerësim (p)

Parashikim Pjesët e hijezuara paraqesin vlerësime dhe parashikime të BQK-së

6.5. RREGULLAT DHE PROCEDURAT E STRUKTURA BUXHETORE

Bazuar në literaturën e fundit dhe autorët e njohur të kësaj fushe, varësisht prej vëndit buxhetet janë të ndërtuar në disa nivele dhe në disa mënyre me qëllim të funksionimit të mirë dhe sa më efikas:

Egzistojnë tre nivele të buxhetit:

- Buxheti qendror,
- Buxhetet e pavarura, dhe
- Buxheti i njësisve të qeverisjes vendore.

Të gjitha këto buxhete formojnë një të vetëm që quhet buxheti i përgjithshëm i shtetit. Ky Buxhet është i shumë i rëndësishëm, sepse përben një tregues të përgjithshëm se sa janë të ardhurat që qeveria ka mbledhur dhe çfarë është më jetike si i ka shpenzuar këto të ardhura.

Në Kosovë buxheti njihet me emrin Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Ky ndahet në disa kategori por në Kosovë është më specifik sepse ende nuk është i definuar statusi përfundimtar, mirëpo segmentet e Buxheti por edhe vet buxheti në teresi ekziston i pavarur nga ndonjë buxhet tjetër.

Buxheti i Kosovës miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, viti buxhetor është i njëjti me vitin kalendarik pra fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor, hyne në fuqi me nënshkrimin e Presidentit të vendit. Në rast ku ky buxhet nuk mund të aprovohet nga Kuvendi i Republikës atëher Presidenti i vendit, shpërben parlamentin dhe vendi shkon në zgjedhje të jashtëzakonshme. Financimi i vijave buxhetore baze bëhet sipas formules 1/12.

Deri në vitin 2008, kur Kosova nuk ishte shtet i pavarur ky buxhet nënshkruhej nga PSSP-ja (Përfaqësuesi Special i Sekretaritë të Përgjithshëm të OKB-së) mbështetur në Rezolutën 1244 të KS OKB-së, ka të drejtë që të mos e nënshkruaje dhe të riktheje në parlament për procedim të serishëm.

Si çdo buxhet i vendeve tjera edhe Buxheti i Republikës së Kosovës financon të gjitha operacionet e parapara me Ligjin e buxhetit duke u ndarë në forem të barabartë dhe sipas projeksioneve qeverisëse në vend.

Shteti, funksionon pothuajse sikur individi apo si familja ai është i interesuar për hyrjet dhe daljet e parave.

Për këtë arsye qeveria planifikon

Të ardhurat, që tregon sa para do të mbledhë gjatë vitit dhe si do ti mbledhë ato,

Shpenzimet, që tregon sa para do të shpenzoje dhe për çfarë.

Pra, me sa shihet është një plan, ose një përlllogaritje e të ardhurave, të hyrave dhe shpenzimeve që duhet të aprovohet nga Kuvendi. Ndërsa në Kosovë deri në vitin 2008 pas Kuvendit duhet që aprovimin final ta japë PSSP-ja i cili pavarësisht vendimit të Kuvendit të Kosovës mund të mos e nënshkruaj, apo edhe e kundërte nëse nuk miratohet në Kuvend ai e shfrytëzon të drejtë ta nënshkruajë. Ndërsa pas pavarësisht se vendit ligjin për buxhetin e nënshkruan presidenti i vendit.

Në Republiken e Kosovës. Republikën e Shqipërisë dhe po thuaj se në shumicën e vendeve të Botës viti buxhetor fillon më 1 janar dhe zgjat deri më 31 dhjetor pra që bazohet në kalendarin gregorian.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, viti buxhetor fillon në 1 Shtator deri në 31 Gusht të vitit të ardhshëm, ndërsa;

Në Angli viti buxhetor fillon në 1 Prill dhe vazhdon deri në 31 Mars të vitit në vazhdim.

Për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, anëtarësimi në Bashkimin Evropian do të sjellë shumë pasoja në fushën e zbatimit të politikave buxhetore dhe të menaxhimit të financave publike – pasoja për të cilat administratat shtetërore duhet të përgatiten.

Kjo nënvizon ndërlikimet kryesore që do të kenë financat publike nga zgjerimet e ardhshme. Duke patur parasysh kohën e mbetur deri në momentin që do ndodhë zgjerimi i Bashkimit Evropian, disa nga politikat dhe procedurat e përshkruara më poshtë mund të pësojnë një sërë ndryshimesh.

Zhvillimi i sistemit të përgatitjes së buxhetit të Bashkimit Evropian ka qenë rezultat i një procesi të gjatë, të ndërlikuar dhe ndonjëherë edhe të zhurmshëm; rezultati i këtij debati ishte krijimi i një grupi rregullash dhe procedurash që ndryshojnë shumë nga sistemi i përgatitjes së buxhetit të organizatave të tjera kombëtare apo shumëkombëshe.

Origjina e sistemit mund të zbulohet/gjendet po të kthehemi prapa në vitin 1951 – vit gjatë të cilit ECSC u krijua nga gjashtë shtete, të cilat iniciuan procesin e Integritimit Evropian; Gjermani, France, Itali, Belgjike, Holande dhe Luksemburg. Deri në vitin 1970,

ky sistem, i cili u ndërtua sipas Traktatit të Romës që i dha jetë Tregut të Përbashkët në vitin 1958, u financua nëpërmjet kontributeve të Vendeve Anëtare, sipas përqindjeve që u vendosen në traktat (MF & GTZ :2004).

Gjermania, Franca, dhe Italia duhet të financojnë secila 28% të buxhetit. Në të vërtetë, kjo është dhe mënyra se si financohen pjesa më e madhe e organizatave shumëkombëshe; traktatet dhe konventat e organizatave përcaktojnë norma fikse të kontributeve për të llogaritur kontributin vjetor që secili vend pjesëmarrës duhet t'i paguajë organizatës në fjale.

Në vitin 1970, kur i ashtuquajtur "vendimi i burimeve të veta" u miratua, sistemi i përgatitjes së buxhetit të Komunitetit Evropian, ndryshoi rrënjësisht që në momentin kur vendimi financoi Komunitetin evropian me burimet e veta dhe përfundoi varësinë e tij nga kontributet direkte të shteteve anëtare. Bashkë me shpërndarjen / alokimin direkt të taksave doganore dhe bujqësore, buxheti evropian përfitoi nga një pjesë e të ardhurave nga TVSH-ja, e cila u rezervua për t'u shpenzuar në politikën e Komunitetit.

Vendimi i burimeve të veta, ndonëse hodhi një hap vendimtar drejt autonomisë së buxhetit të Komunitetit, nuk shmangti zhvillimin e një krize buxhetore që filloi në mes të viteve 1970 dhe përfundoi në fund të viteve 1980. Kjo krizë u krijua nga një kombinim i tre faktorëve. Së pari, shpenzimet u rriten me shpejtësi si pasojë e rritjes që pati sektori bujqësor dhe krijimi i politikave të reja të Komunitetit (MF & GTZ:2004).

Në lidhje me fondet e akorduara, mbartjen dhe periudhat suplementare, buxheti i Komunitetit kryen rregullime të ngjashme për shumicën e buxheteve kombëtare në mënyrë që të shmange ndonjë shpërkulje administrative. E kushtëzuar nga faktorë të ndryshëm, një pjesë e buxhetit e caktuar për një vit të dhënë, mund mbartet në vitin pasues, veç kësaj, viti financiar nuk mbyllet me datë 31 Dhjetor, por në praktikë zgjatet me dy deri në katër javë, në varësi të llojit të veprimit.

6.5.1. Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

Në kuadër të Ministrisë së Financave funksionon Departamenti i Buxhetit , i cili është përgjegjës për:

- ✓ Hartimin e Propozimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës,
- ✓ Zbatimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës , si dhe

- ✓ Ushtrimin e të gjitha përgjegjësive të tjera të cilat i janë caktuar Departamentit të Buxhetit nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësité Buxheti paraqet një planifikim të hollsisshem financiar që përmbledh të ardhurat dhe shpenzimet qeveritare të parashikuara për vitin e ardhshëm dhe ka tre funksione kryesore:
 - ✓ Të parashikoj permbushje e projeksioneve të qeverisë gjatë vitit buxhetor,
 - ✓ Të jetë një instrument në doren e shtetit të mbaje kontrollin e plote mbi ekonomine dhe zhvillimin e saj në vend.
 - ✓ Është sistem kontrolli i akomolimit dhe shpërndarjështë hyrave buxhetore.

Buxheti i shtetit në fund të vitit buxhetor mund të jetë :

- ✓ **Buxhet i balancuar**-kur të ardhurat e parashikuara janë të barabarta me shpenzimet
- ✓ **Suficit**-kur të ardhurat janë më të mëdha se shpenzimet
- ✓ **Deficit**-kur shpenzimet janë më të mëdha se të ardhurat

6.6. PËRSPEKTIVA DHE STRATEGJIA E POLITIKËS FISKALE NË UNIONIN EVROPIAN

Peblemi kryesore i Unionit European, në kohën në të cilin ne po jetojme është pa dyshim unifikimi i sistemeve tatimore të vendeve të ndryshme me që secila prej vendeve anetare e ka sistemin e vet të vecante i cili dallon prej të tjerëve.

Kjo situatë lind si nevojë e kohës me që shtetet e ndryshme në kohën tone ndiejnë nevojë gjithnjë e më të madhe për të bashkpunuar .Një situatë e tillë i ka shtyrë shtetet e Unionit European që gradualisht të marrin vendime të përbashkëta me qëllim të kalimit sa më të shpejt të këtyre dallimeve. Edhe pse në të ardhmen politikat tatimore mund të shtrojnë nevojën për prioritete te tjera perseri doktrina qendrore e saj do të mbetet e njëjta. Me siguri edhe në të ardhmen do të aplikohen politika tatimore të ndryshme nga vendet e ndryshme por esenca e problemit e cila do vazhdoje të mbetet në fokus e që është politikat e vendeve të ndryshme nuk duhet kane efekte negative në sistemet tatimore të vendeve të tjera.

Bazat ligjore për politikën e Unionit European -Karakteristikë e Unionit është shumëllojshmëria e sistemeve tatimore të cilat funksionojnë brenda këtij sistemi si dhe tendencat për tejkalimin e këtyre dallimeve. Në këtë bashkësi të shteteve përgjegjësia për politikën tatimore bie mbi shtetet anetare, mbi secilin shtet vec e vec , ndërsa roli i UE-së është kryesisht ndihmës përmes tatimeve kontributeve si dhe sigurimeve sociale. Qëllimi i Unionit nuk është që të standardizojë sistemet kombetare të tatimeve dhe kontributeve të detyrueshme por të krijojë siguri të plotë se ato janë në pajtueshmëri me njëra tjetren si dhe me qëllimet e vendosura në bazë të marrëveshjes së komuniteti European. Më konkretisht kjo është e precizuar me nenin 269 marrëveshja e Komunitetit European kërkon buxhetet e komuniteteve të jenë plotësisht të financuara nga burimet vetiake.

Llojet e ndryshme të tatimeve dhe të Kontributeve të detyrueshme në UE - Kemi këto lloje të tatimeve dhe të kontributeve :

1. Tatimet direkte
2. Tatimet indirekte si dhe
3. Kontributet dhe sigurimet

Tatimet direkte - janë tatimet në të Ardhura, Tatimet e Korporatave ,Tatimet në Pasuri si dhe një sërë tatimesh të tjera të cilat vendosen në nivel lokal dhe të cilat dallojnë varesisht nga sistemet tatimore si dhe specifikat në kuader të sistemeve të caktuara.Këto tatime kërkojnë disa shkalle të harmonizimit sepse ato ndikojnë në lirinë e lëvizjes së të mirave materiale si dhe të shërbimeve.Jo të gjitha llojet e tatimeve direkte kërkohet që të jenë të harmonizuara por duhet të jenë të harmonizuara ato tatime efekti i të cilave ndikon direkt në katër liritë kryesore të sigurara nga marrëveshja kryesore e Komitetit European ,(lëvizja e lirë e të mirave materiale , personave ,shërbimeve dhe kapitalit).Pra ligji kombtar i tatimeve duhet të sigurojë respektimin e këtyre lirive fundamentale.

Ligjëvënja e komunitetit në tatimim po ashtu është miratuar nën dispozita të gjëra siq është neni 94 dhe neni 308 i marrëveshjes së Komunitetit European.

Tatim Indirekte – shembull të tatimeve indirekte kemi tatimet e Vleres së Shtuar si dhe taksat e ndryshme Indirekte.TVSH-ja është taksa e parë për të harmonizuar.Ajo është adaptuar edhe në vitin 1992 me qëllim që të i përmbushë më plotësisht nevojat e tregut European.Neni 90 i marrëveshjes së Komunitetit European ndalon çfarëdo diskriminimi të taksave të cilat në një mënyre apo tjetren do të u japin përparësi prodhimeve kombetare të një vendi në raport me atë të prodhimeve nga shtetet tjera, ndërsa neni 93 i marrëveshjes ben

thirrje për harmonizimin e tatimeve qarkulluese si dhe të gjitha format e tatimeve të tjera. Tregu mund të themi se është plotësisht efektiv vetëm në ato vende në të cilat harmonizimi është i kryer.

Kontributet dhe sigurimet social - Në këtë fushë nuk ka plane të harmonizimit të ligjvënjes. Kontributet e sigurimet nuk janë pjesë e sistemit të tatimeve bile edhe në ato raste kur ato vendosen në mënyre të detyrueshme në bazë të ligjeve kombetare. Këtë çështje komuniteti e ka koncentruar në koordinimin e sistemeve kombetare (Rregullorja EEC nr. 140/71) që të siguroje se të punesuarit apo të vetëpunesuarit duke lëvizur brenda komunitetit të mos paguajnë kontributet e sigurimit social. Në disa raste për të arritur efektet e tilla të parapara në rregullore ka vendosur gjykata.

Jo të vogla janë edhe rastet e ngaterruar në këte çështje ndërmjet subjekteve të shteteve të ndryshme. Këto raste i zgjidh gjykata e cila con drejtësinë në vend. Konceptet e nënvizuara të ligjvënjes së komunitetit në fushën e TVSH-së si (sfera , vendi i tatimit , shuma, baza e tatimit si dhe e drejta e zbritjes së TVSH-së) janë sqaruar në rastet e sistemit të përgjithshëm të TVSH-së.

6.6.1. TVSH-ja dhe roli i saj në UE

Tvsh-ja është paraqitur në UE në vitin 1970 si përpjekje për të zavendësuar tatimet e vëna në prodhim dhe konsum të cilat u aplikuan deri atehere në komunitet. Vendimi i marë në vitin 1970 për caktimin e proporcionit të ardhurave të TVSh-së të llogaritet në bazë të unifikuar për financimin e buxhetit të komunitetit (pjesë e resurseve vetiake të komunitetit) hapi rrugen për harmonizimin e TVSH-së.

Direktiva e 6-të e TVSH-së (77/388/EEC) siguroi që taksat të ishte e aplikuar për të njëjtat transaksione në të gjitha shtetet anetare. Kështu u formua baza unike për financimin e tërë komunitetit dhe paraqitet një bazë e llogaritjes. Direktiva e 6-të iu hapi rrugen gjithashtu masave pasuese duke punuar në drejtim të synimit të vënë aq heret sa edhe direktiva e parë e TVSH-së, heqja e ngarkesave kufitare. Duke punuar në këtë drejtim, në vitin 1987 komisioni propozojë një lëvizje të tatimit të bazës në origjinë (p.sh pagimi i taksës në shtetin që është shitur) duke u kthyer prap nga një sistem qartësues i bërë për të parandaluar një lëvizje dëmthënëse e burimeve të të ardhurave në mes të shteteve anetare. Lëvizja e lirë e të mirave materiale brenda komunitetit nënkupton tregti në mes të

shteteve antare të cilat nuk trajtoheshin ma si importe dhe eksporte. Duke iu falenderuar sistemit ekzistues kalimi i kufirit më nuk trajtohet si ngjarje tatimore.

Prej vitit 1993 individët private duke shkuar në vendet anetare janë në gjendje të blejnë të mira materiale për përdorim të tyre personal dhe të tatimohen në të njëjtën mënyrë si këmbtarët e vendit. Pastaj ata mund të kthehen në shtëpi me gjërat e blera pa u detyruar të paguajnë prapë taksë për to.

Blerja e automjetit të ri (më pak se 6-të muaj i vjetër ose me më pak se 6000 kilometra në instrumentin tregues) në një shtet tjetër anetar. Ky transaksion është tatuar në shtetin anetar të destinimit sipas shkallës së saj dhe në harmoni me rregullat e saj. Automjeti duhet të regjistrohet dhe të tatimohet në shtetin ku blerësi është banor i saj.

Shitjet e bëra me porosi me anë të postës nga një kompani që ndodhet në një shtet tjetër antar, ku shitësi merr përgjegjësinë për transportin e të mirave materiale të porositura, atehere TVSH-ja duhet të paguhet ose në shkallën e aplikimit të shtetit ku blerësi është banor apo sipas shkallës së shtetit, varsisht nga vëllimi vjetor i shitjeve të shitësit në shtetin e destinacionit.

Përderisa tatimi i origjinës mbetet një parim themelor i sistemit të TVSH-së së yakonshme për individët private, sistemi kalimtar ruajti metoda të ndryshme paralele të bayës së destinimit për kompanitë, qëllimi ishte se vënja e taksave të TVSH-së në secilin shtet antar ka reflektuar vëllimin e konsumimit atje.

Problemet shpejt u bënë të dukshme pastaj u miratuan dy direktiva të tjera më 1992 dhe 1995 për të bërë sistemin më efektiv dhe heqjen e shtrembërimeve të mëdha. Sidoqoftë, ishte e pamundur që të arrihet ndonjë thjeshtësim radikal , sepse regjimi i tatimit të origjinës paralele dhe destinacionit vazhdoi së aplikuari, ligjvenja e komunitetit nuk u aplikua në mënyrë dhe shkallë unike. Si rezultat i këtij sistemi ekzistues të TVSH-së është i pavolitshëm për tregtarët dhe tregun unik , pra është në një masë ende i coptuar. Me ligjin e komunitetit po ashtu janë edhe 2 skema të përhershme speciale, njëra për gjera të dorës së dytë, punimet nga arti, antika dhe gjerat embledhura si dhe tjetra për arin e blerë për qëllime investimi.

Programi i punës të një sistemi të përbashkët të TVSH-së u prezantua nga komisioni më 1996 me qëllim të përmirësimit të sistemit kalimtar dhe të i përmbush nevojat e tregut unik, sistemi i ri i TVSH-së :

- t'i japë fund ndarjes së tregut në zona "kombëtare" të tatimit;

- të jetë i thjeshtë dhe modern;
- të sigurojë tatime të barabarta për të gjitha transaksionet brenda komunitetit;
- të garantojë tatimim efektiv dhe kontrollet të ruajnë nivelin e të ardhurave të TVSH-së

Programinmi fokusohet në tri fushat e komunitetit;si aplikimi unik; modernizimi i TVSH-së si dhe një ndryshim të origjinës bazë të tatimit.

Sistemi i ri i propozuar i TVSH-së :- Secili tregëtar paraqet TVSH-në sipas shkallës vendore pa ndonjë formalitet tjetër, dhe secili tregëtar zbrit TVSH-në e paguar kudo në Unionon Europian në deklaratën e tij të TVSH-së normale.

Si veprohet me prodhimet e akcizes ne BE - Këto janë tatime të vecanta të cilat vendosen në disa prodhime të vecanta si duhani, kozmetika, alkoholi,vajrat e ndryshme etj.shkallët e aplikimit të tyre varen nga shteti në shtet.Kjo do të thotë se shtetet antare janë të lira në aplikimin e këtij tatimi i cili paraqet vështërsi të mdha në UN.

Tatimet Mashtruese- Njëra ndër problemet kryesore në komunitet është lufta ndaj tatimeve mashtruese. Masat për ti luftuar këto mashtrime tashmë formojnë një pjesë të vecante të politikës së përgjithshme të tatimeve në komunitet.Qëllimi është që të inkurajojë bashkpunimim në mes shteteve antare dhe të siguroj trajnime për zyrtarët për të njohur me llojet dhe format e ndryshme si dhe preventivat që duhen ndërmarre, metodat e zbulimit dhe të hulumtimit të bazuara në analizat e rrezikshme.

Mashtrimi ndërkombetar i TVSH-së vecanarisht në shitjet dhe dërgesat brenda UE-së ka rezultuar me humbje serioze të të ardhurave. Ajo po ashtu e prish tregtinë legjitime dhe shifrat e punësimit zyrtar dhe cka është më e keqja e humb besimin në tregun unik.

Për tejkalimin e kësaj gjendje administratat kombetare dhe komisionet duhet të bashkpunojnë dhe të këmbëjnë informata në një masë shumë më të madhe me qëllim që të arrihet një efikasitet edhe më i madh në luftën e përbashkët të kësaj dukurie tejet negative .Kur jemi te tatimet dhe taksat mashtruese ato të duhanit dhe mallrat e tjera të cilat jo rrall herë quhen ten e edhe si mallrat e akcizës kanë arritur rezultate shokuese në kuptimin e humbjes së të ardhurave të vendeve të Unionit në vitin 1996 kjo shifër ka arritur në vlerë 4.8 miliard euro.

Strategjia e re e UE-së - Ndryshimet në strukturen e sistemit tatimor si dhe nevoja për zhvillimin dhe kompletimin e tregut unik nxiti komisionin që në vitin 1996 të propozojen një strategji të re. Dokumenti i komisionit (SEC(96)487-tatimimi në Unionin

European) duke promovuar nevojën e promovimit të rritjes dhe punësimit, me qëllim që të stabilizojë sistemin tatimor si dhe të plotësojë konstruimin e tregut unik u pranua në mënyrë të favorshme nga Ministria e Ekonomisë dhe të Financave që u takuan në Verone më 13 prill 1996, të cilët vendosën të ndjekin diskutimet mbi këto baza. Në esencën ajo përballoi qasje të dyfishtë. Pengesë serioze për funksionim normal dhe unik mbesin ligjet kombetare të tatimeve dhe taksave, pasi sistemet e papërputhshme pengojnë tregtinë dhe ndajnë tregun e Unionin Europian. Këto anamali çuan drejt burimeve të dobëta të alokimeve dhe dobësuan garueshmërinë e firmave ndërkombetare në Unionin Europian. Paraqitja e Euros, transparenca më e madhe e tregut si dhe gara më e ashpër e kanë bërë shtrembërimin e krijuar të barrierave të tatimit edhe më të dukshme. Pakoja tatimore e 1 dhjetorit të vitit 1997- qasja pragmatike e UE-së u formulua pas shume diskutimeve në komisionin (COM (97)564). Kjo pako përmban një grumbull masash për të i luftuar dëmet që shkaktuan tatimet –sistemet tatimore të vendeve anetare.

Kjo pako e re përmban:

- a) kodin e administrimit për tatimet e bizneseve;
- b) masat e heqjes së devijimeve në tatim të të ardhurave nga kursimet;
- c) masat për shfuqizimin e tatimeve të fshehura në rastin e pagesave me kalimin kufitar në interes të privilegjeve në mes të kompanive.

Komisioni po ashtu ka përgatitur udhëzimet e ndihmës së shtetit fiskal dhe pajtueshmëria e tyre me rregullat ndihmëse të shtetit në Unionin Europian (komunikata 98/C384/03).

Mund të themi se lidhjet në mes të politikave tatimore dhe atyre të fushave të tjera të Unionit Europian janë duke u qartësuar me vazhdimin e integritit Europian. Tani për tani ekzistojnë një numër i konsiderueshëm të ligjeve të UE-së qytetarët e ndonjë vendi të cilët i kanë të paqarta mund të kërkojnë sqarimet e nevojshme.

KAPITULLI VII

7. ANALIZA E NDIKIMIT TË POLITIKËS FISKALE NË EKONOMIN E KOSOVËS

7.1. VARIABLAT E PERDORURA NË STUDIM

Ne kete punim doktoral kam ndërtuar dy pyetsorë, qe jane te ndare nga njeri tjetri dhe jane te orientuar ne dy komponente kryesore qe ndertojne dhe zbatojme politiken fiskale.

Pyetësori i pare i është drejtuar tatim-paguesve për të evidentuar faktorët ndikues në përqindjen e deklarimit për efekte tatimore dhe problematikat e politikës fiskale.

Pyetësori i dytë i drejtohet bizneseve, konkretisht menaxhereve të tyre për të ballafaquar mendimet e (tatimpaguesve) në lidhje me politiken fiskale dhe bizneseve si faktorë ndikues në ndertimin e nje politike te mirefillte fiskale.

Siç e dime nje teoria shkencore variablat e marrë në konsideratë në një studim mund të jenë të varur, të pavarur, zbutës, ndërmjetësues ose variabla kontrolli.

Bazuar ne modelin e parë të shqyrtuar: - variabli i pavarur i marrë në studim është përqindja e deklarimit të të ardhurave nga ana e tatimpaguesve dhe është e shprehur në përqindje (nga totali 100% i të ardhurave të realizuara). - variablat e varur të marrë në konsideratë janë: norma tatimore (TF, TAP, TVSH dhe Kontributet e pensionale)), numri i kontrolleve, penaltitet e vendosura nga kontrolli tatimor, besimi në qeveri, madhësia e bizneseve, statusi ligjor, aftësia paguese e bizneseve dhe aftësitë e inspektorit të kontrollit tatimor.

Pothuaj se shumica e variablave (përveç numrit të kontrolleve, madhësisë së biznesit dhe statusit ligjor) janë pohime të shprehura në shkallën Likert nga 1-shumë dakord deri në 5- nuk jam aspak dakord.

Pyetjet dhe komentet e ndërtuara me shkallë Likert tentojnë të pasqyrojnë opinionet e të anketuarëve lidhur me një pohim.

Ndersa sipas modelit të dytë të shqyrtuar: - variabli i varur i marrë në studim është efikasiteti mbi menaxhimin e biznesit dhe raportime tek autoritetet, - variablat e pavarur të përfshirë në model janë objektiviteti i administratës tatimore, sistemi informatik i

administratës tatimore, cilësia e kontrollit tatimor, transparenca kundrejt tatimpaguesve, trajtimi i punonjësve dhe kultura e tatimpaguesve.

Gjithashtu edhe pyetjet kerkimore në formen e pohimeve janë ndërtuar duke u bazuar në shkallën Likert. Formulimi i pyetësorit është bazuar në një nga studimet e fuundit shkencore të argumentuara në vitet e fundit.

Ndërsa përveç të dhënave primare për realizimin e studimit janë marrë dhe të dhëna dytësore. Burimi kryesor i këtyre të dhënave janë kryesisht: te dhenat zyrtare nga Vjetaret statistikore të ASK, BQK, ATK dhe Ministria e Financave , Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar.

7.1.2. Të dhënat e grumbulluara dhe perpunimi i tyre

Duke u bazuar ne analiza përshkruese kemi siguruar një përmbledhje të shkurtër të të dhënave të grumbulluara statistikore. Ne pjesën e parë të kerkimit, në pyetësorin e parë analiza përshkruese është përdorur për të evidentuar problematikat e politikës fiskale aktuale në lidhje me TVSH-në (qëndrueshmëria e bazës ligjore, rimbursimi, llogaritja e TVSH-së në doganë dhe parapagimi); TA (qëndrueshmëria, parapagesa, shpenzimet e panjohura, përcaktimi i kësteve dhe gjobat për parapagimet); Politika fiskale (niveli i besimit në qeveri, konkurrenca e pandershme dhe ndikimi në efikasitetin e biznesit).

Nderkaq për informacionet e mbledhura ne pyetësorin e dytë analiza përshkruese është përdorur për të pasqyruar mendimin e administratës biznesore në lidhje me politiken fiskale të ndjekur. Gjithashtu, analiza evidenton problemet në lidhje me eficiencën, objektivitetin, sistemin informatik të administratës tatimore, cilësinë e kontrollit tatimor, transparençën kundrejt tatimpaguesve, trajtimin e punonjësve dhe kulturen e tatimpaguesve

7.1.3. Analiza regressive multivariable

Mbeshtetur ne analizen e regresionit, regresioni i multivariabel, është asgjë tjetër vetëm një zgjerim i analizës së thjeshtë të regresionit; megjithëse, nëse ne zgjerojmë modelin nga një variabël të pavarur në dy ose më shumë, shfaqen disa fakte të reja.

Duke u bazuar ne literaturën shkencore supozimet në lidhje me kete model janë:

Gabimet individuale të modelit, ϵ , janë statistikisht të pavarur nga njëri tjetri, dhe këto vlera paraqesin një kampion të rastit nga popullimi i gabimeve të mundshme për secilen vlerë të x .

Kur një vlerë të dhënë të x mund të ekzistojnë disa vlera të y , dhe kështu mund të ekzistojnë shumë vlera të mundshme për ε . Saktësisht, shpërndarja e mundshme e gabimeve të modelit për çdo vlerë të x është shpërndarje normale.

Shpërndarjet e vlerave të mundshme të ε kanë varianca të njëjta në secilin vlerë të x .

Mesatarisht variabit të varur, y , për gjitha vlerat specifike të x , mund të lidhen me një vijë që quhet modeli i regresionit të popullimit.

Ndaj nëse dëshirojme të masim deklarimit e të ardhurave për efekte tatimore, MODELI paraqitet si më poshtë:

$$Y = \alpha_0 + \alpha_1 NT + \alpha_2 NK + \alpha_3 GJK + \alpha_4 BQ + \alpha_5 MB + \alpha_6 SL + \alpha_7 AP + \alpha_8 AI + \varepsilon$$

Y: Deklarimi i Të Ardhurave për Efekte Tatimore

NT: Norma Tatimore (TVSH, TF, TAP, Kontribute)

NK: Numri i Kontrolleve

KGJ: Kontrolli Tatimor dhe Gjobat

BQ: Besimi në Qeveri

MF: Madhësia e Bizneseve

SL: Statusi Legal

AP: Aftësia Paguese e Bizneseve

AI: Aftësitë e Inspektuese

Kontrollit Modeli i efikasitetit të administratës tatimore paraqitet si më poshtë:

$$Y = \alpha_0 + \alpha_1 PA + \alpha_2 SI + \alpha_3 CK + \alpha_4 TT + \alpha_5 TP + \alpha_6 KT + \varepsilon$$

Y: Efikasiteti i Administratës Tatimore të Kosovës

PA: Pavarësia e Administratës Tatimore

SI: Sistemi Informatik

CK: Cilësia e Kontrollit Tatimor

TkT: Transparenca kundrejt Tatimpaguesve

TP: Trajtimi i Punonjësve

KT: Kultura e Tatimpaguesve

Për modelet e regresionit janë realizuar testet e mëposhtme:

- testi normalitetit
- testi White i heteroskedasticitetit
- testi Breusch – Godfrey Serial Correlation LM
- testi Ramsey Reset

7.1.4. Analiza e regresion - kuantil

Po ashtu edhe regresioni kuantil është një nga modelet e analizës së regresionit. Në një ekuacion regresionit linear, koeficientet e regresionit paraqesin rritjen në variablin e varur si rezultat i rritjes me një njësi në variablin e pavarur që e shoqëron atë koeficient. Regresioni kuantil pasqyron lidhjen mes një grupi variablash të pavarur dhe kuantileve specifike të variablit të varur. Parametri i regresionit kuantil vlerëson ndryshimin në një kuantil specifik të një variabli të varur si rezultat i ndryshimit me një njësi në variablin e pavarur (Despa, 2012). Nëse mbështesemi tek ky model atëherë themi se jep vlerat e pritshme për shembull të medianës së pjesës së variablit të varur në funksion të nivelit të vlerësimit për variablat e pavarur. Për modelin e parë është realizuar një model regresionit kuantil për të parashikuar medianën e pritshme të përqindjes së deklarimit të të ardhurave për efekte tatimore nga ana e tatimpaguesve.

7.1.5. Rast studimor i kontrollit tatimor dhe ndikimit në efikasitet

Një rast studimor është një kërkim empirik që shqyrton një fenomen të caktuar, veçanërisht kur kufiri mes fenomenit dhe kontekstit nuk është i qartë (Yin, 1994).

Rasti studimor përdor të dhëna të shumta duke përfshirë dy ose më shumë nga: vëzhgime direkte të detajuara, intervista dhe dokumente të ndryshme (Rowley, 2002). Në rastin studimor të marrë në konsideratë është trajtuar një ndikim i politikave markofiskale në biznese dhe është vëzhguar çfarë ndikimi ka të ardhurat tatimore të realizuara nga kjo në Kosovë gjatë viteve 2008-2015, duke u ndalur specifikisht me ndryshimet e pakëve fiskale dhe impati i këtij ndryshimi tek e hyra e përgjithshme dhe zhvillimi i vendit.

7.1.6. Përpunimi i të dhënave me EVIEWS 7

Përpunimi i të dhënave është realizuar me Eviews 7, një paketë statistikore e përdorur për analiza ekonometrike. Eviews është një program i përshtatshëm për analizimin e të dhënave, interpretimin e rezultateve dhe nxjerrjen e konkluzioneve.

Fushat ku Eviews përdoret fuqishëm janë:

- a) parashikimi i shitjeve,
- b) analiza e kostos dhe parashikimi,
- c) analiza financiare,
- d) parashikimi makroekonomik,

e) simulimi ,

f) analiza e të dhënave shkencore dhe vlerësimi

Përdorimi i Eviews mundësoi lehtësi në përpunimin, kuptimin dhe interpretimin e rezultateve

Pyetjet kerkimore që tentojme të verifikojme hipotezen në këtë punim janë:

P1. Cilat janë objektivat e politikës fiskale që po ndjek Qeveria e Kosovës?

P3. Çfarë politikash fiskale duhet të ndërtojme që të jemi në hap me BE-në dhe vendet tjera të interesit tonë nacional?

P4. Si reflekton pako aktuale e parapagimit të tatimit mbi vlerën e shtuar për bizneset?

P5. Çfarë orientimi duhet t'u japim politikave fiskale, me qëllim të tërheqjes së investimeve të huaja dhe njëkohësisht rritjes së punësimit?

P6. Politikat tatimore në Kosove, a janë të drejta dhe si ndikon tek bizneset?

P7. Si dhe sa ndikon parapagimi i detyrimeve tatimore (TVSH,TF) para inkasimit të të hyrave nga transaksionet biznesore?

P8. A ndikon rritja e pagave në sektorin publik në rritjen e çmimeve dhe inflacion?

Ketu kemi të bëjmë me verifikimin e tri hipotezave :

H1: Harmonizimi i politikave fiskale të Kosovës me ato të BE do sjell rritjen e të ardhurave tatimore.

H2: Hartimi i politikave fiskale të konsoliduara do rrisë rolin e sektorit publik në ekonomine e Kosovës.

H3: Rritja e pagave në sektorin publik do ndikojë në rritjen e inflacionit në ekonomine kosovare.

Dhe rrejdhimisht kemi hulumtuar tri segmente kyçe të ndikimit të politikave fiskale në Kosovë. Kemi intervistuar biznese, qytetare dhe institucione relevante që lidhen me këto fushe. Për realizimin e punimit janë shpërndarë 130 pyetësore ku janë mbledhur vetëm 105 prej tyre.

Modeli i përqindjes së deklarimit të të ardhurave për efekte tatimore është si më poshtë:

$$Y = a_0 + a_1 NT + a_2 NK + a_3 GJK + a_4 BQ + a_5 MF + a_6 SL + a_7 AP + a_8 AI + \varepsilon$$

Variabli varur:

Y: Përqindja e Deklarimit të të Ardhurave për Efekte Tatimore

Variabli pavarur:

NT: Norma Tatimore
 NK: Numri i Kontrolleve
 KGJ: Kontrolli Tatimor dhe gjobat
 BQ: Besimi në Qeveri
 MF: Madhësia e Firmave
 SL: Statusi Ligjor
 AP: Aftësia e Biznesit për të Paguar
 AI: Niveli i Aftësive Profesionale të Inspektorit

Nga përpunimi statistikor me programin Eview 7 i të dhënave të grumbulluara nga pyetësorët e shpërndarë rezultoi:

Tabela 24. Rezultatet e analizës së regresionit për modelin të pare

Dependent Variable: Y

Method: Least Squares

Sample: 1 105

Included observations: 105

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	129.4750	13.38298	9.674600	0.0000
XHIRO	0.051732	0.019581	2.641932	0.0096
TF	-3.937639	1.585876	-2.482943	0.0147
TAP	-8.987413	2.098632	-4.282511	0.0000
Aft. Insp	-5.366760	2.413969	-2.223210	0.0285
Aftësia Pag.	-4.293262	2.451176	-1.751511	0.0830
R-squared	0.317718	Mean dependent var		76.81905
Adjusted R-squared	0.283260	S.D. dependent var		22.50674
S.E. of regression	19.05432	Akaike info criterion		8.787910
Sum squared resid	35943.66	Schwarz criterion		8.939565
Log likelihood	-455.3653	F-statistic		9.220278
Durbin-Watson stat	1.732278	Prob(F-statistic)		0

Harmonizimi i politikave fiskale të Kosovës me ato të BE do sjell rritjen e të ardhurave tatimore.

Nese e marrim për baze harmonizimin e politikave fiskale me vendet e BE-se shihet qarte se nese kemi nje rritje, përqindja e deklarimit për efekte tatimore rritet, për rrjedhojë fshehja e të ardhurave ulet. Saktësishte, nëse qarkullimi rritet me një shkallë në vlerësim variabli i varur rritet me 0.05 përqindje.

Nëse vlerësimi për gjendjen e biznesit të paguajë në kohë detyrimet rritet (pra, biznesi nuk është në gjendje të paguajë në kohë detyrimet tatimore) përqindja e deklarimit për efekte tatimore ulet dhe fshehja e të ardhurave rritet. Në vendet e BE-se është shumë qarte e rregulluar puna e deklarimit dhe pageses së tatimeve, por njëkosisht edhe masat ndeshkuse janë aq të ashpera sa që asnjë biznesë nuk merr guximin të hyjë në rrugën e rrezikshme të fshehjes së tatimit siq ndodhe tek ne.

Nëse vlerësimi për Gjendjen e Biznesit të paguajë në kohë detyrimet rritet me një shkallë (pra, biznesi nuk është në gjendje të paguajë në kohë detyrimet tatimore) përqindja e deklarimit për efekte tatimore ulet me 4.29 pikë përqindje.


Faktorët e tjerë si: numri i kontrolleve, gjobat, besimi në qeveri, statusi ligjor etj kanë rezultuar si të parëndësishëm nga analiza.

Koeficienti i përcaktueshmërisë (R²) tregon që 32% e ndryshimeve që pëson përqindja e deklarimit të të ardhurave për efekte tatimore shpjegohet nga faktorët e përzgjedhur si të rëndësishëm. Pjesa tjetër shpjegohet nga faktorë të tjerë që nuk janë marrë në konsideratë në studim. Secili nga probabilitetet e variablave të pavarur janë më të ultë se 0.05 (niveli i rëndësisë) përveç variablit të Aftësisë Paguese të Biznesit i cili merret në konsideratë duke u krahasuar me nivelin e rëndësisë 0.1. Ky variabël është pjesërisht i rëndësishëm.

Përveç testimit të secilit variabël, testojmë edhe rëndësinë e përgjithshme të regresionit të shumëfishtë duke përdorur testin F. Probabiliteti i statistikës F është 0.000000 shumë e vogël pra mundësia që të pranohet hipoteza alternative është e papërfillshme.

Perfundimisht si konkluzim mund të themi që modeli është i rëndësishëm.

Figura 19. Testi i normalitetit për modelin e parë



Pra, kjo mund te thuhet se:

1: Mbetjet kanë shpërndarje normale (Termi i gabimit e shpërndahe normalisht)

2: Mbetjet nuk kanë shpërndarje normale (Termi i gabimit e nuk shpërndahe normalisht)

Statistika Jarque-Bera është 25.46297 dhe vlera korresponduese e p është 0.000003. Meqë vlera e p (0.000003) < 0.05 atëherë hidhet poshtë hipoteza bazë.

Sipas Green, (2003), normaliteti shikohet shpesh kusht i regresionit i panevojshëm dhe i papërshtatshëm.

7.2. NDIKIMI I POLITIKËSE FISKALE NË BIZNES

Më qëllim që të kuptuar me qartë sjelljen e bizneseve në një tranzicion të shoqërisë, efektet e saja dhe masen e ndikimit kam realizuar një hulumtim i cili ka për qëllim që të nxjerr ne pah se si dhe sa ndikojnë politikat financiare në një proces tranzicioni ekonomiko-politik. Identifikimi i aktiviteteteve konkrete që menaxheret e operatoreve ekonomik kanë ndermarr më qëllim që të lehtësojnë problemet me tranzicionin dhe të harmonizojnë sa me mire politikat fiskale me bizneset e tyre.

Hulumtimi është realizuar duke aplikuar metodën e intervistave gjysmë të strukturuar, komunikimin direkt (ballë për ballë), bazuar në pyetësorin e përgatitur duke respektuar standardet bazë e të njohura nga kjo fushë.

Të gjeturat dhe rezultatet nga hulumtimi janë paraqitur në këtë punimi dhe besoj që është rezultat modest për të ndertuar një pikpamje rreth këtë çështje në të ardhmen nga hulumtuesit tjerë.

Hulumtimi kishte si target bizneset në Kosovë të cilat duke u bazuar ne fuqisë ekonomike te tyre mbulojen rreth 50 % te tersise se bizneseve en republiken e Kosoves, pra kompanitë më te fuqishme bazuar në qarkullimin vjetor.

Pas hulumtimit, mbledhjes së të dhenave kam ndertuar nje DATA duke u mbeshtetë në metodën likert të Microsoft Office Excel,.

7.3.1. Të dhënat bazë nga hulumtimi

Duke pasur për bazë orjentuese se hulumtimi duhet të ketë që informacione e sa më kualitative, kam targetuar nivelet e larta menaxhuese të ketyre bizneseve. Hulumtimi është bërë duke përdorur metodën e intervistat saktësisht modelin sy me sy me drejtuesit e bizneseve.

Nga dhjetë bizneset e anketuara, 4 ishin në pozitën: Menaxher financiar, gjashtë ishin kryeshef ekzekutiv të buiznesit ndersa 190 të tjerë mbanin pozita në nivele me te ulta. Arsyja e intervistimit të tyre ishte që kam një mostër reprezentative, kur e kemi parasysh se këta operatore ekonomike paraqesin rreth 50 përqind të fuqisë ekonomike në Republikën e Kosovës, shikuar në kendeveshtrimin të qarkullimit të tyre.

Po ashtu, në këto hulumtim përmes metodës gjysem të strukturuar kam intervistuar gjithsejt 200 respondent që të gjithë zyrtarë të ketyre 10 kompanive të mëdha.

Në bazë të grafikut të nxjerre nga Hulumtimi del se bizneset e anketuara janë mirë të përgatitura sa i takon përgatitje shkollore dhe kjo jep me tepër besim se hulumtimi ynë është kredibil.

PYETJA 1: A besoni se një menaxhim i mirë i politikave fiskale ndikon në zhvillimin ekonomik?

Po, gjithmonë

Po, ndonjëherë

Jo, asnjëherë


Permbledhja e Pytjes : A besoni se një menaxhim i mirë i resurseve njerëzore, politikave fiskale ndikon në zhvillimin ekonomik?

Tabela 27. Ndikimi i menaxhimit në politika fiskale

Nr	Sa besoni që Republika e Kosova ka një menaxhim të drejtë dhe zhvillimor të politikave fiskale?	Nr I respondentëve	Përqindja
1	Po, gjithmonë	3	26
2	Po, ndonjëherë	133	67
3	Jo, asnjëherë	14	7
		200	100

Burimi: Pyetsori nga Doktorantja

Figura 22. Sa besoni që Republika e Kosova ka një menaxhimte drejte dhe zhvillimore të politikave fiskale?



Burimi: Doktorantja

Bazuar në rezultatet e intervistës del se, 26. % prej tyre mendojnë se Po gjithmonë ka një menaxhim të mirë në Politikave fiskale në Kosovë, 67% mendojnë se Po ndonjëherë kemi menaxhim efikas e kjo varet nga qeverisja dhe partit që janë në pushtet kurse vetëm 7 % nga të anketuarit mendojnë se Asnjëherë nuk ka një menaxhim të drejtë dhe të besuar të politikave fiskale

PYETJA 2: A besoni se Kosova ka një menaxhim të duhur të politikave fiskale? Kësaj pyetje ju është dhënë 4 opsione dhe nga kjo na del se Kosova nuk ka një menaxhim të mirë të politikave fiskale, ku 37% e respondentëve mendojnë se nuk ka politika të mira të menaxhimit dhe kësaj nëse i shtojmë edhe opsionin e 4 që është Mungon transparencja dhe llogaridhenja kjo të jep idene se 23.5% të respondentëve mendojnë se nuk ka transparencë, kjo do të shihet më poshtë:


Tabela 28. Kosova dhe politikat fiskale

A mendoni se Kosova ka një menaxhim të duhur të politikave fiskale?	Pergjigja e respondentëve	Perqindja
1. Po, ka të mirë	38	19

1. Jo, nuk ka	74	37
2. Pjesërisht ka	41	20.5
3. Mungon transparenca dhe llogaridhenja	47	23.5
Total	200	100

Burimi: Doktorantja

Figura 23. A mendoni se Kosova ka një menaxhim adekuat të duhur të politikave fiskale?



Burimi: Doktorantja

PYETJA 3: Roli pozitiv apo negativ i misioneve të BE-së në Kosovë

D1 A kanë luajtur pozitiv apo negativ misionet e Bashkimit Europian në Kosovë në menaxhimin dhe hartimin të politikave efikase fiskale?

1. Jo asnjëherë
2. Po ndonjëherë
3. Po Gjithmone

Tabela 29. Përmbledhja nga pyetja:


A kanë luajtur pozitiv apo negativ misionet e Bashkimit Europian në Kosovë në menaxhimin dhe hartimin të politikave efikase fiskale?

Nr	A kanë luajtur pozitiv apo negativ misionet e Bashkimit Europian në Kosovë në menaxhimin dhe hartimin të politikave efikase fiskale?	Nr I respodenteve	Perqindja
1	Jo, asnjëherë	17	8.5
2	Po, ndonjëherë	119	59.5

3	Po, gjithmonë	64	32
		200	100

Burimi: Pyetesori i Doktorantës

Figura 24: Roli pozitiv apo negativ misionet e BE-së në Kosovë



Burimi : Doktorantja

PYETJA 4: A i shton vlerë biznesit sistemi i qeverisjes së kompanisë dhe hamonizimi i politikave fiskal?

Po

Jo, nuk ka ndikuar


Pak

Tabela 30. A i shton vlerë biznesit sistemi i qeverisjes së kompanisë dhe hamonizimi i politikave fiskale

Nr	A i shton vlerë biznesit sistemi i qeverisjes së kompanisë dhe hamonizimi i politikave fiskal	Nr I respodenteve	Perqindja
1	Po, gjithmonë	70	35
2	Jo nuk ka ndikuar	56	28
3	Pak	74	37
		200	100

Burimi: Pyetesori i Doktorantit

Figura 25. Si ka ndikuar qeverisja korporative ne menaxhime efikas te politikave fiskale?



Burimi : Doktorantja


Në pyetjen se: Si ka ndikuar qeverisja korporative ne menaxhime efikas te politikave fiskale, nga 200 te intervistuarit, 35 % e tyre kanë vërejtur Po, gjithmonë ndikon qeverisa e drejte ne politikat financiare 28% mendojë se nuk ndikojne ne biznese ndersa 37 % mendoj se pak ndikojnë ne biznese e tyre.

7.3. RITJA E PAGAVE NE SEKTORIN PUBLIK DHE RITJA E INFLACIONIT NE EKONOMINE KOSOVARE.

Më qellim te verifikimit te hipotezes së trete: Rritja e pagave ne sektorin publik do ndikojne ne rritjen e inflacionit ne ekonomine kosovare. Kam analizuar me vemendje levizjet e inflacionit bazuar ne cmimet botrore sin ë ndikimin e tyre ne ekonomin e Kosovës. Po ashtu rritja e pagave sektorin publik vetem në vitin 2011 deri 50% absolutyisht ka ndikuar në krijimin e një realiteti të ri në ekonomin e Kosoves. Ndonëse vendi përjetonte rritje të qëndrueshme të të hyrave, për të ruajtur nivelin e shpenzimit kapital, rritja e pagave

deri në një masë u kompensua duke i rritur tatimet në akcizë për duhan dhe duke aplikuar akcizë në një numër mallrash tjera. Këto masa gjeneruan të hyra të mjaftueshme për të ruajtur strukturën e shpenzimeve në atë kohë, ndonëse të hyrat e njehershme kontribuuan në masë të konsiderueshme në mbajtjen e nivelit të ulët të deficitit. Pas tre vitesh, në 2014 (vitin kur u miratua rregulli fiskal), Qeveria mori vendim që të rrisë pagat në sektorin publik dhe pensionet prej 25%. Kjo rritje rezultoi në ndryshim në strukturën e shpenzimeve, duke ulur shpenzimet kapitale prej 11% të BPV-së në vitin 2011 në 7.4% në vitin 2014. Ky ndryshim në strukturën e shpenzimeve, i kombinuar me hapësirën e limituar për shkurtim shpenzimesh në interes të ruajtjes së deficitit, i bëri presion Qeverisë të ndër marr masa shtesë të të hyrave, siç është rritja e akcizave ekzistuese.


Grafiku 21: Shpenzimet qeveritare për paga dhe shpenzimet kapitale, në miliona euro




Rritja e pagave e vitit 2014 ka rastisur me presione inflacioniste si pasojë e rënies së çmimeve ndërkombëtare të mallrave. Duke marrë parasysh pjesën e madhe të importeve në ekonominë kosovare, çmimet kryesisht ndikohen nga lëvizjet e çmimeve ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, rënia e çmimeve ndërkombëtare pritej të ndikonte nivelin e përgjithshëm të çmimeve në Kosovë, ndonëse në parashikimet e mëhershme supozohej se kishte një palëvizshmëri të fortë asimetrike të çmimeve ndaj ndikimit të çmimeve ndërkombëtare (d.m.th. e madhe në përgjigje ndaj rritjeve në çmimet e mallrave botërore meqë firmat rrisnin çmimet për të siguruar marxhinat e fitimit; por të vogla në përgjigje ndaj zvogëlimeve në çmimet e mallrave botërore meqë firmat qëndrojnë tek ato çmime në interes të ruajtjes së marxhinave në fjalë).

Përveç kësaj, inflacioni për shtyrje të kërkesës supozohet se ishte tepër i vogël, meqë në ekonomitë e vogla, të hapura, me bazë shumë të ultë të prodhimit, presionet për kërkesa kanë më shumë gjasa të ngritin importet se sa të ushtrojnë presion në nivelin e çmimeve.

Grafiku 22. Paraqitja grafike e IÇK, paga mesatare dhe çmimet botërorë të mallrave



Graph 22.a. Paraqitja grafike e diferencës së parë për IÇK, pagën mesatare dhe çmimet botërorë të mallrave



Duke marrë parasysh përcaktuesit e nivelit të çmimeve në Kosovë (që nuk janë testuar ndonjë herë), rritja e pagave nxiti debat mbi ndikimin që rritja kishte në nivelin e përgjithshëm të çmimeve. Në interes të ofrimit të një analize relevante mbi të cilën të

bazohet ky debat në të ardhmen, kjo pjesë e analizon efektin e kombinuar të rritjes së pagave dhe ndryshimin e çmimit botëror të mallrave si variabla ekzogjene në nivelin e përgjithshëm të çmimeve në Kosovë. Ky testim përdor dy qasje: e para, modelim me një ekuacion; dhe e dyta, përmes vlerësimit të sistemi në formë të modelit ‘vector-error’ korrigjues (VECM). Janë përdorur të dhënat tre mujore mbi IÇK në Kosovë (kcpi), paga mesatare (total_wages) dhe çmimet botërore të mallrave (worldcomm), paraqitja grafike e të cilave është ofruar në grafikun 22 dhe 22a, për periudhën TM1 2003 deri TM 2015.

Të dhënat janë përshtatur për sezonalitet dhe për të mundësuar krahasueshmërinë, janë ri-indeksohen dhe çmimet botërore të mallrave janë kthyer në euro. Testimi i ‘unit root’ sugjeroi se të tri variablat në diferencat e para gjenerohen nga procesi stacionar (prandaj ato janë I(1) në nivele) dhe rezultatet e gjeneruara nga testet diagnostikuese sugjerojnë një model me një ‘vonesë’, që konsiderohet i arsyeshëm duke marrë parasysh kohën e shkurtë të serive në dispozicion për këta tregues. Për më tepër, testet diagnostikuese sugjerojnë se ka një shkëputje në serinë e IÇK në 2007TM2, që me gjasë paraqet fillimin e krizës financiare globale. Për këtë arsye, një variabël impuls ‘dummy’ për vitin 2007TM2 është përfshirë në model.

Për të testuar asimetrinë e çmimeve në Kosovë në raport me çmimet ndërkombëtare, modeli gjithashtu përfshin një variabël ndërvperuese (ku variabli ‘dummy’ ‘DLncommDV’, i cili merr vlerën prej ‘1’ për ndryshimet negative në inflacionin e çmimeve botërore të mallrave dhe ‘0’ kur nuk ka ndryshime dhe/apo rritje, shumëzohet me variablin e inflacionit të çmimeve botërore të mallrave ‘DLnCDVbyDlnC’).

Hipotezat e testuara janë si në vijim:

Fillimisht, u zhvillua specifikimi i modelit VAR i cili formon bazën e testit të sistemit kointegrues. Duke i përdorur kriteret e informacionit dhe një varg testesh diagnostikuese është përcaktuar gjatësia e ‘vonesës’ së specifikimit tonë VAR, përfshirë një konstante dhe një variabël ‘dummy’ zhvendosëse për shkëputjen strukturore në 2007TM2. Siç tregohet në tabelën 29, testet diagnostikuese rekomandojnë VAR (2) ndonëse informacioni sugjeron probleme me normalitet.

Tabela 29. Testet Diagnostike për VAR me (p) specifikime

Lags	Q (16)	Q* (16)	FLM (5)	LJB (4)	MARCH (5)
p = 3	37.05 [0.94]	47.64 [0.65]	1.53 [0.10]	14.76 [0.00]	47.22 [0.38]
p = 2	38.75 [0.96]	50.09 [0.70]	1.04 [0.43]	18.96 [0.00]	46.23 [0.42]
p = 1	65.18 [0.30]	75.77 [0.08]	1.95 [0.02]	8.08 [0.08]	55.91 [0.12]

Burimi: Doktorantja bazuar në *Kalkulimet e Njesisë së Makroekonomisë, JMulti Time Series Analysis Software Package, Lütkepohl & Krätzig*

Çmimet botërore të mallrave dhe variabli ‘dummy’ ndërveprues janë përfshirë si variabla ekzogjene, duke marrë parasysh se nivelet e çmimeve në Kosovë ndikohen nga lëvizjet në çmimet ndërkombëtarë por jo anasjelltas. Si rezultat, testi për ekzistencën e vektorit ko-integrues është realizuar vetëm për këto dy variabla; përkatësisht çmimet në Kosovë dhe nivelin e pagave. Rezultatet e testit të ko-integrimit janë dhënë në tabelën poshtë.

Tabela 30. Testet e ko-integrimit (që lejon një konstantë të kufizuar në vektorin ko-integrues dhe një shkëputje strukturore në 2007TM2)

Johansen Trace Test					
(e ri-specifikuar me VECM-in përfundimtar)					
r0	LR	P-val	90%	95%	99%
0	48.05	0.0000	22.75	24.87	29.20
1	10.57	0.1118	10.87	12.69	16.60
Saikkonen & Lütkepohl Test					
(në prezencën e një shkëputjeje strukturore të përcaktuar nga përdoruesi)					
r0	LR	P-val	90%	95%	99%
0	21.95	0.0007	10.47	12.26	16.1
1	0.55	0.5176	2.98	4.13	6.93

Burimi: *Kalkulimet e Njesisë së Makroekonomisë, JMulti Time Series Analysis Software Package, Lütkepohl & Krätzig*

Evidenca e raportuar në tabelën 30 sugjeron qartë se ka marrëdhënie ko-integruese në mes të inflacionit të çmimit dhe pagës. Kështu që, VECM-i është vlerësuar sipas specifikimit të VAR (2) dhe rangut të ko-integrimit në vlerë 1. Testi i proporcionit të mundësisë (Likelihood Ratio) që u zhvillua me qëllim të krahasimit të modelit të kufizuar kundrejt atij të pakufizuar rekomandoi përdorimin e modelit të kufizuar, përkatësisht modelin vetëm me konstantë dhe variablën zhvendosëse në vektorin ko-integrues. Formula e mëposhtme tregon vlerësimin e Johansen ML të marrëdhënies së ko-integrimit β , ku është normalizuar koeficienti i ‘k_{cp1}’ në një, koeficienti ‘loading’ për k_{cp1} dhe termet përcaktuese dhe variablat ekzogjene.

$$\begin{aligned}
 \begin{bmatrix} \Delta kcpit \\ \Delta totalwages_t \end{bmatrix} &= \begin{bmatrix} -0.166 \\ (-4.226) \\ \dots \\ 0.355 & -0.183 \\ (3.651) & (-3.407) \\ \dots & -0.311 \\ & (-2.118) \end{bmatrix} \begin{bmatrix} kcpit_{t-1} \\ totalwages_{t-1} \end{bmatrix} + \begin{bmatrix} -0.047 & 0.068 \\ (-1.351) & (2.341) \\ -0.329 & 0.289 \\ (-4.166) & (4.605) \end{bmatrix} \begin{bmatrix} DLnCDVbyDLnC_t \\ \Delta commodity_Euroindex_log_t \end{bmatrix} + \begin{bmatrix} \dots \\ \dots \\ 0.015 \\ (1.949) \end{bmatrix} [DLncommDV_t] + \begin{bmatrix} u_{1,t} \\ u_{2,t} \end{bmatrix} \quad (1)
 \end{aligned}$$

...ku vlerat t janë dhënë në kllapa.


Kcpi paraqet logaritmin natyral të IÇK-se ne Kosove, i raportuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës, variabli i pagave totale paraqet logaritmin natyror të pagave mesatare totale në Kosovë, shift07q2 është variabli ‘dummy’ zhvendosës për shkëputjen strukturore në 2007q2, DLnCDVbyDLnC paraqet variablin ndërveprues dhe DLncommDV është variabli ‘dummy’ për çmimet botërore të mallrave, të shpjeguara më lart. Shenja negative dhe madhësia e vogël e koeficientit ‘loading’ shpalos një reagim të ekuilibruar të inflacionit të çmimeve aktuale në mungesën e ekuilibrit paraprak në marrëdhënien afatgjate në mes të nivele të çmimeve dhe pagave. Koeficienti i vlerësuar i përshtatjes sugjeron që inflacioni i çmimeve përshtatet për të përmirësuar 16.6% të largësisë nga ekuilibri paraprak për tre mujor. Në anën tjetër, koeficienti ‘loading’ i inflacionit aktual të pagave nuk shfaqë ndryshim statistikisht domethënës nga 0, duke sugjeruar se inflacioni i çmimit nuk përshtatet për t’u kthyer në mos-ekuilibrin paraprak, një e gjetur që sugjeron palëvizshmëri të konsiderueshme të pagës nominale. Barazimi (2) më poshtë paraqet termin e ri-shkruar të korigjimit të gabimit që del nga barazimi (1). Nga kjo, marrëdhënia afat gjate e ekuilibrit tregon se në afata-gjatë ka një kalim substancial (0.27%) të pagave në çmime.

$$kcpit = 0.274 totalwages_t + 0.086shift_07q2_t + 3.105c + ec_t \quad (2)$$

Marrëdhënia e ekuilibrit afatgjatë vlerësohet në varësi të shkëputjes strukturore, e cila rezulton siqifikante duke i shtuar kështu vlefshmërinë kësaj të gjeture. Vlerësimet e marrëdhënieve afat shkurta në mes të variableve të diferencuara (inflacioni i çmimit dhe pagës) shpalosin se efekti i vlerësuar i inflacionit paraprak të çmimit në atë aktual është pozitiv. Megjithatë, efekti i vlerësuar i inflacionit paraprak në atë aktual (-0.183) sugjeron ndikim pervers negative afat shkurtë. Kjo e gjetur përkrah hipotezën e dytë që firmat kanë tendencë që fillimisht t’i zvogëlojnë çmimet për ta marrë hisen e tregut kur presin rritje të

pagave të sektorit publik. Siç është vlerësuar paraprakisht (por nuk është testuar), kur janë pozitive, çmimet botërore të mallrave kanë një kalim direkt, pozitiv në inflacionin e çmimit vendor (0.068); megjithatë, ky efekt në masë të madhe zhduket kur inflacioni i çmimit botëror të mallrave është negativ (-0.047). Analiza ‘impulse response’ shpalos këtë marrëdhënie afat shkurte dhe afat gjate në mes të pagave dhe inflacionit të çmimit. Parashikimi nga kjo analizë përdoret për të treguar efektet gjatë 20 tremujoreve të një shoku prej një njësie në logaritmin e indeksit të pagës tek logaritmi i indeksit të çmimit. Janë përdorur 1,000 replikime ‘bootstrap’ dhe intervalet e besimit prej 95%.

Grafiku 23. Efektet e mbi 20 tremujorëve e një njësie të goditjes në logaritmin e indeksit të pagës në logaritmin e indeksit të çmimit



Rezultatet e analizës ‘impulse-response’ janë efektet e vlerësuara të diskutuara më lartë. Efekti pervers negativ afat shkurtë i rritjes së pagës identifikohet qartë; për tremujorin e parë, efekti është negativ dhe statistikisht signifikant (d.m.th. të dy shkallët e vetëbesimit - më e larta dhe më e ultë- nën 0). Megjithatë, efekti i një njësie të ngritjes së pagës në çmime shpejtë kthehet pozitiv dhe pas rreth dy vitesh bëhet dhe mbetet pozitiv (d.m.th. të dy shkallët e vetëbesimit më e larta dhe më e ultë mbi 0).

Kjo analizë sinjalizon se inflacioni i çmimit botëror të mallrave në IÇK-ne vendore transmetohet direkt në inflacionin e çmimit dhe indirekt përmes efektit të inflacionit të pagës. Efektet janë të forta dhe shpalosen në raport të zhdrejtë, duke sugjeruar palëvizshmëri të konsiderueshme asimetrike të çmimeve.

KAPITULLI VIII

8. DISKUTIME, PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

8.1. DISKUTIM MBI GJETJET KRYESORE DHE KONKLuzionET

Gjatë trajtimit të kësaj teme une jam përqëndruar dhe kam dhenë një kontribut modest duke u përpjekur të përshkruaj dhe të nderlidh Politiken fiskale me, konceptin, filozofinë, strategjine deri të faktoret e tjerë jo të drejtëpërdrejte që kanë të bëjnë me politikat fiskale.

“Politikat fiskale në vendet e tranzicionit dhe Kosova” është temë e trajtuar në disa dimensione dhe ka argumente të bollshme në këndëveshtimin e financave dhe strategjise se tyre në hartimin e politikave fiskale.

Vendet në tranzicion, tranzicionin si koncept dhe ndikimin e tij në politikat fiskale është shtylla tjetër që une kam dizajnuar në këtë temë ku kam përshkruar edhe faktoret dhe ecurite e kësaj sfare, duke e sqaruar edhe privatizimin si një prej çështjeve kryesore të kalimit nga koncepti shoqëror e ekonomine e tregut dhe kalimi i përgjegjesis dhe prones nga shoqëria tek individi. Ekonomina e Kosovës edhe sot, përballë më një norme e lartë papunësisë, e cila paraqet një sfidë për një rimëkëmbje ekonomike dhe zhvillim ekonomik. Krijimi i vendeve të reja të punës në Kosovë do të jenë edhe për pak kohë teme dhe perokopim i politikës vendore dhe mendoj se politikat financiare të Kosovës duhet të orjentoohen në këtë fushë.

Harmonizimi i politikave fiskale që ndikojnë në zhvillimin ekonomik ka dalë edhe si rekomandim bazë i këtij punimi, pasi që vendi ynë ende nuk ka mundur të tejkaloj problematikën e tranzicionit, kur dihet se sistemi i privatizimit nuk ka sjellë pothuajse asgjë në procesin zhvillimor.

Kosova duhet të ndërtojë një sistem ekonomik që të ketë një ambient të favorshëm për investitorët vendas dhe posaqërisht ata të huaj me qëllim që të kemi një për integrimin ekonomik në rajon e më gjerë, ku do të bazohet zhvillimi ekonomik nga inkurajimi i partnerëve nga bota ekonomike dhe zhvilluar.

Deficitit buxhetor dhe potencialet për mbulimi i tij janë sfida direkte të qeverisjese dhe si të tilla duhat pasur parasyshe që ndikojnë në rritjen e inflacionit e që ky i fundit ndikon negativisht në rritjen e ekonomisë vendore duke çorjentuar tregun dhe indeksin e çmimeve, dhe kështu do të prishe balancet në mes të ofertes dhe kërkesës.

8.2. PËRFUNDIME

Politikat fiskale, ndërtohen në atë form që shteti të mund të realizojë intereset e tij duke u bazuar në fuqinë e të hyrave të përgjithshme që planifikon dhe mundëti të realizon, ku si objektive primare ka mirëqenjen e qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik. Duke qenë të vetedishëm se shpenzimet dhe taksat ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të një vendi dhe së parqesin fuqinë reale të ekonomisë kombëtare të tij. Formulimi i politikës fiskale kryesishtë bazohet nga instrumentet politike që përcaktojnë rregullat standard të politikës fiskale duke u mbështetur në harmonizimin e saj me nevojat kombëtare dhe duke u harmonizuar edhe me politikat fiskale të Bashkimit Europian, por shpesh herë ato ndërtohen nga subjektet politik qeverisëse në raste të fitores në zgjedhje. Pra shikuar nga aspekti praktik politika fiskale është mekanizëm i realizimit të objektivave me qëllim të përmbushjes së detyrimeve fiskale dhe nevojave publike. Përdorimi i instrumenteve të politikës fiskale nuk bazohet vetëm në rrjedhat afatshkurtra por edhe në përdhat afatgjata që kryesishtë orjentojnë në të ardhurat për kapita, ku edhe përcaktohet apo thënë me mirë orjentohet norma zhvillimore si synim baze i çdo qeverisje.

Aspekti makroekonomik i teorive në politikat fiskale është trajtuar në detaje dhe si përfundim kam konstatuar ekonomia e Kosovës duhet të orjentojë në forcimin institucioneve demokratike, në rend dhe ligj për të garantuar një ekonomi të lirë të tregut në të harmonizojë politikat fiskale me nevojat zhvillimore dhe garantojë një stabilitet dhe siguri për investitorët e jashtëm.

Po ashtu pas hulumtimeve të bëra mund të konkludojmë se: tri segmente kyçe duke filluar nga aspekti makroekonomik i teorive në politikat fiskale, teoritë më të rëndësishme të mbledhjes së tatimeve në politikën fiskale, sistemet e politikave fiskale në ndarjen e tatimeve, problemi i zgjedhjes së obliguesit tatimorë në sistemet tatimore bashkëkohore, janë fushat që Qeveria duhet të nderhujë dhe të japë një zgjidhje me të pranueshme e ma

pdoduktive, posaqerishte ne sigurimin e nje ambiejtje te te berit biznese dhe kalimin e te hyrave kyqe nga doganat ne te hgyrat vendore.

Hipoteza e parë: Harmonizimi i politikave fiskale te Kosoves me ato te BE do sjelle rritjen e te ardhurave tatimore

Kjo hipotezë është verifikuar dhe ekziston një lidhje e fortë mes politikës fiskale vendore dhe harmonizimit të sajë më vendet e BE-së, kësaj duhet shtuar edhe argumentin se Kosova është shfrytëzues e monedhes europiane –EURO, kjo e mundeson një edhe një hap para në domosdoshmerine e harmonizimit.

Hipoteza 2: Hartimi i politikave fiskale të konsoliduara do rrise rolin e sektorit publik në ekonomine e Kosoves..

Ekonomia e diversifikuar e Kosovës, me përqindje më të madhe të sektorit privat ndaj sektorit publik, do të mundësojë rritje më të shpejtë dhe më të qëndrueshme se rritja e tanishme, nese ndertojme politika te mirfillta fiskale. Ketu duke aplikuar metodat e grumbullimit te te dhenave dhe testimi të tyre vijme ne perfundim se vertetohet hipoteza dhe argumetohet në dy segmente kyqe, e para së numeri i te punesuarve në sekrorin privat është me i madhe se ne sektorin publik dhe se orjentimi edhe i politikave shtetore është të ofrohet subvencione dhe mbeshtetje çdo biznesi që hap vende të reja pune, së dyti: Bizneset private në Kosove janë tash me me te fuqishme se sa nderrmarrejt e njejta me pronesi publike. Ketu e argumentoj edhe në punim ku kam inervistuar kompani të sherbimeve të njejte ne sy sektoret dhe rezultatet e kanë konfirmuar këtë hipotezë.

Metodat e përcaktimit të bazës tatimore, parimet e tatimit dhe evolucioni i tyre në shtetet bashkëkohore, parimet financiare-politike të tatimit, parimet ekonomike-politike të tatimit, parimet socio-politike të tatimit, parimet tatimore-teknike të tatimit, qëllimet, masat dhe efektet tatimore, sistemet tatimore bashkëkohore në ekonominë e tregut dhe deri tek institucionet që më së shumti realizojne të hyra në vendin tonë doganat, qëllimi dhe efekti në politikën fiskale të ekonomisë vendore. Politika fiskale është një segment kyçi politikës ekonomike e që shteti e perdore me qellim të rregullimit te aspekteve të produktivitetit nivelit të punesimeve dhe kontrollit të çmimeve.

Hipoteza e tretë: Rritja e pagave ne sektorin publik do ndikojte ne rritjen e inflacionit ne ekonomine kosovare.

Më qelli të verifikimit te hipotezave mund te perfundojme se: Qeveria mori vendim që të rrisë pagat në sektorin publik dhe pensionet prej 25%. Kjo rritje rezultoi në ndryshim në

strukturën e shpenzimeve, duke ulur shpenzimet kapitale prej 11% të BPV-së në vitin 2011 në 7.4% në vitin 2014. Ky ndryshim në strukturën e shpenzimeve, i kombinuar me hapësirën e limituar për shkurtim shpenzimesh në interes të ruajtjes së deficitit, i bëri presion Qeverisë të ndërmarr masa shtesë të të hyrave, siç është rritja e akcizave ekzistuese. Duke marrë parasysh pjesën e madhe të importeve në ekonominë kosovare, çmimet kryesisht ndikohen nga lëvizjet e çmimeve ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, rënia e çmimeve ndërkombëtare pritej të ndikonte nivelin e përgjithshëm të çmimeve në Kosovë, ndonëse në parashikimet e mëhershme supozohej se kishte një palëvizshmëri të fortë asimetrike të çmimeve ndaj ndikimit të çmimeve ndërkombëtare (d.m.th. e madhe në përgjigje ndaj rritjeve në çmimet e mallrave botërore meqë firmat rrisnin çmimet për të siguruar marxhinat e fitimit; por të vogla në përgjigje ndaj zvogëlimeve në çmimet e mallrave botërore meqë firmat qëndrojnë tek ato çmime në interes të ruajtjes së marxhinave në fjalë). Në interes të ofrimit të një analize relevante mbi të cilën të bazohet ky debat në të ardhmen, kjo pjesë e analizon efektin e kombinuar të rritjes së pagave dhe ndryshimin e çmimit botëror të mallrave si variabla ekzogjene në nivelin e përgjithshëm të çmimeve në Kosovë. Ky testim përdor dy qasje: e para, modelim me një ekuacion; dhe e dyta, përmes vlerësimit të sistemi në formë të modelit ‘vector-error’ korrigjues (VECM). Janë përdorur të dhënat tre mujore mbi IÇK në Kosovë (kcpi), paga mesatare (total_wages) dhe çmimet botërore të mallrave (worldcomm), paraqitja grafike e të cilave është ofruar në grafikun 22 dhe 22a, për periudhën TM1 2003 deri TM 2015. Për më tepër, testet diagnostikuese sugjerojnë se ka një shkëputje në serinë e IÇK në 2007TM2, që me gjasë paraqet fillimin e krizës financiare globale. Për këtë arsye, një variabël impulsive ‘dummy’ për vitin 2007TM2 është përfshirë në model. Evidenca e raportuar në tabelën 30 sugjeron qartë se ka marrëdhënie ko-integruese në mes të inflacionit të çmimit dhe pagës. Kështu që, VECM-i është vlerësuar sipas specifikimit të VAR (2) dhe rangut të ko-integrimit në vlerë 1. Kjo e gjetur përkrah hipotezën e dytë që firmat kanë tendencë që fillimisht t’i zvogëlojnë çmimet për ta marrë hisen e tregut kur presin rritje të pagave të sektorit publik.

8.3. KONKLUZIONE

1. Shteti përmes politikës fiskale nderhyne në rrjedhat ekonomike më qellim të mënjanimin të dukurive që janë pengesa për rritjen e mirëqenies, rritjen e te hyrave, nivelin e punsimeve dhe te trendeve të pergjithme te ekonomise. Shteti duke palikuar politike te drejte fiskale ka si synim që të mbrojë e shtresat e varfëra, të favorizoj politika që mundesojnë krijimin e vendeve të reja të punës, ekonomin e lire të tregut, duke luftuar monoplet dhe hapur mundesin per nje konkurrence reale.
2. Rritja e kapaciteteve të Administratës Tatimore të Kosovës dhe dixhitalizimi i saj është një prioritet tjetër i cili do mundesojë që bizneset, qytetarët e vecmas investitorët e jashtëm të dinë dhe të kenë qasje online mbi detyrimet dhe lehtësimet.
3. Të harmonizohen politikat fiskale me qeverisjen e mirë si çelës dhe burimi i së mirës së përbashkët.
4. Të hyrat e drejteperdrejta buxhetore të cilat realizohen nga privatizimi i Ndërmarrjeve Publike të jenë burim i mjeteve për buxhetin e shtetit. Këto mjete gjatë menaxhimit të orientohen për investime kapitale, zhvillimin e ekonomisë. Mirepo se pari Qeveria duhet të realizojë hapa konkrete ligjore që mjetet e grumbulluara deri tani nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore të kthehen në buxhetin e shtetit dhe të dedikohen për sektorët e caktuar të ekonomisë.
5. Zvoglimi i potencialit ekonomik të obliguesit me rastin e pagimit të tatimit e cila paraqitet si barrë, kjo shtron nevojën e gjetjes së rrugëve të ndryshme për të ikur kësaj barre.
6. Kjo analizë sinjalizon se inflacioni i çmimit botëror të mallrave në IÇK-ne vendore transmetohet direkt në inflacionin e çmimit dhe indirekt përmes efektit të inflacionit të pagës. Efektet janë të forta dhe shpalosen në raport të zhdrejtë, duke sugjeruar palëvizshmëri të konsiderueshme asimetrike të çmimeve.

8.4. REKOMANDIMET

1. Reformat të cilat janë bërë në fushën e financave publike duhet të jenë në funksion të harmonizimit me ligjet e aplikueshme si dhe reformimit të mëtejshme të tyre, me qëllim të shtimit më të madh të transparencës dhe plotësimin e nevojave të tyre.
2. Shteti duhet urgjent të bashkojë të gjitha agjencionet e të hyrave në një institucion qendror që mbledhe dhe korrдиноjë të hyrat, pra të themelojë Agjencin e Qendrore të Hyrave
3. Të ndërtojë politika fiskale që të nxisë investimet dhe zhvillimin ekonomik.
4. Të zhvillojë një luftë pakompromis në zvoglimin e evazionit fiskal dhe ekonomine joformale, duke fiskalizuar bizneset dhe duke krijuar stimulime për bizneset dhe qytetaret e ndershem që paguajn dhe marrin kupon fiskal.
5. Institucionet e Kosovës duhet ta bëjnë përshkallëzimin e TVSH-së për produkte ushqimore siç janë: vaji, buka, mielli, sheqeri, kripa, etj, pra shporta e përditshme familjare.
6. Rekomandoj që qeveria dhe agjensite e saj të angazhohen që në emer të borxhit publik të marrin mjete nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare dhe nga qeveritë e vendeve të ndryshme, ndersa në emer të borxhit të brendshëm të bëjnë emetimin e letrave me vlerë me qëllim të rritjes se të ardhurave për buxhetin, keto mjete të dedikohen për t'i financuar projektet strategjike të cilat kanë ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit
7. Normat e TVSH-së, rekomandoj që të përshtaten në harmoni me normat e reduktuara të TVSH-së, se vendeve fqinje, pra të aplikohen norma të reduktuara të TVSH-së, të cilat do të kenë një ndikim pozitiv drejtpërdrejt në konsumatorin, uljen e çmimeve të disa produkteve.
8. Norma e reduktuar duhet të vendoset për produktet e rëndësise jetike si p.sh. buka, qumështi, pijet jo alkoloike, produktet farmaceutike, pra produktet bazike për jetesë.
9. Rekomandoj që një normë standarde e reduktuar do të ishte e arsyeshme të aplikohet në shkallën rreth 5%.
10. Limiti i pragut të regjistrimit në TVSH që është qarkullimi 50,000.00 Euro, të ndryshohet në 30,000.00 Euro sepse mendoj se do të ketë një efekt pozitiv si në rritjen e të hyrave nga TVSH-ja, sepse do të rritet numri i subjekteve që regjistrohen dhe paguajn TVSH, krijimi i një konkurrence më të fortë, më të drejtën në aspektin e çmimeve sepse nuk do të ketë diferencim të çmimeve.
11. Zgjerimi i bazës tatimore krahas rishqyrtimit të ngarkesave tatimore me qëllim që këto ngarkesa të jenë në harmoni me aftësitë e taksapaguesve për përmbushjen e obligimeve të

tyre fiskale. Në mënyrë që të sigurohet barazia në treg në mes të bizneseve, ATK duhet të sigurohet që për produkte të njëjta të konsumit, norma e aplikuar e TVSH-së të jete e njëjtë.

12. Ministria e Financave të fillojë lirim gradual nga taksa doganore të lëndës së parë duke filluar me lëndët të cilët mund të kenë efekt më të lartë në uljen e kostos së prodhimit. Kjo masë ul koston e prodhimit për bizneset kosovare dhe i mundëson atyre që të bëhen më konkurrues me produktet e importit

13. ATK duhet të sigurohet që inspektorët kanë aftësitë e duhura dhe njohuritë e mjaftueshme të bazës ligjore, në mënyrë që bizneseve të ju lehtësohet bashkëpunimi me ATK-në. Për këtë arsye, ATK duhet të organizojë trajnime dhe testime të rregullta të stafit

BIBLIOGRAFIA

1. Literatura bazë

- **Ahmeti, S.** (2014) "Kontabiliteti Financiar I" Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2014
- **Asllanaj, Rr.** (2010), "Kontabiliteti Financiar" Universiteti i Prishtinës Prishtinë 2010.
- **Badivuku, M. dhe Alishani, A.** (2015) "Historia e Krizes financiare globale" Prishtine
- **Binaj A. dhe Kalem, F.** (2016) Kontabiliteti-koncepte, metoda dhe perdorime,Tiranë
- **Binaj A, (2012):** Sistemet e informacionit kontabel, ShB Ilar,Tiranë
- **Bundo, Sh & Cane, G.**(2003), Financë ,Tiranë.
- **Civici, A.** (2010): Kriza financiare apo globale, Botim nga UET Press, Tiranë
- **Civici, A. dhe Xhepa, S.:** Liberalizimi ekonomik, UET Press & MAPO Editions Tiranë
- **Ebrill, Keen, Bodin, dhe Summers** (2001): TVSH moderne, IMF, 2001
- **Easterly, W.** (1999) "Iluzioni fiskal" Politika ekonomike, 1999
- **Engle dhe Granger** (1987): Bashkëpunimi dhe korrigjimi i gabimeve: Përfaqësimi, Vlerësimi dhe Testimi, Ekonometria.
- **Fabozz F. , Modigliani, F.** (2013) Tregjet e kapitaleve. Institucionet dhe Instrumentet, Tirane 2015
- **Fisher, I.** (2011): Borxhi - Teoria e Deflacionit të depresionit të madh, SHBA 2011
- **Shaorshadze, I. & Sachiko M.** (2010), Remitancat e huaja dhe reduktimi i varfërisë në Kosovë, 2010.
- **Harvey S. R.** (2010): Public Finance, UET Pres, Tirana
- **Hansen Don R.** (2008) Menaxhimi i Kostos, Cengage 2008
- **HYMAN, David N.** (2010): Financat publike, aplikimi bashkëkohor i teorisë së politikës, mësimi i cengazhit. SHBA
- **HENDERSON,David** (2007): Klasikët e mendimit ekonomik, nga fillimet deri në ditët tona
- **Govori, F. dhe Nimani, A.** (2011): Financa, IFK Prishtinë
- **Kalem, F. (2006)** "Drejtimi Financiarë", SH.B. Geer , Tiranë
- **Komoni, S.** (2012) "Financat Publike" Universiteti I Prishtines, Peishtinë
- **Komoni, S.** (2010) "Financat" Prishtinë.
- **Kugler, M., dhe Rapoport H.** (2006): Fluksi Ndërkombëtar i Punës dhe i Kapitalit

- **Keen, M. dhe Baunsgaard T.** (2010): Të ardhurat tatimore dhe Liberalizimi i Tregtisë, Gazeta e Ekonomisë Publike
- **Luboteni, G.** (2007): Financat e Korporatave, Prishtinë
- **Matthew, P.** (2011), Knightian Uncertainty and Interbank Lending, 2011
- **Mustafa, I.** (2012): Menaxhmet Financiar , Universiteti i Prishtinës, Prishtinë
- **Meka, E.** (2010): Kriza Financiare, përmbledhje analizash dhe ese, Tiranë
- **Merovci, S.** (2008): Tregjet financiare, Prishtinë, Botimi i dytë
- **Nimani, A.** (2018): Analiza Kunantitative në Biznes, UPz, Prizreni
- **Newstrom, Rief & Monczka** (1976): Motivimi i punonjësit publik: Fakt kundër fiksionit. Menaxhimi i Personelit Publik,
- **Nimani, A.** (2010): Menaxhimi i financave publike, KUB Prishtinë
- **Salko, D.** (2015): Bazat e Financës, Pegi , Tiranë
- **Selmanaj, S.** (2006): Globalizimi dhe Tranzicioni, Prishtinë, 2006.
- **Stiglitz, J.** (2000) Edicioni i trete “The Economics of the Public Sector”, NY. SHBA
- **Kellough, E. K., & Selden, S. L. (1997).** Pay for performance systems in state government.
- **Puka Ll.** (2015) Hyrje në statistiken e zbatuar, mediaprint Tirane 2015
- **Xhafa, H.** (2014) Analiza e pasqyrave financiare, Urtesia Bektashiane Tiranë
- **Xhafa, H. Dhe Ciceri, B.** Drejtimi Financiar, Alb Piper, Tiranë
- **Xhepa, S. , Agolli, M.,** (2004), Zhvillimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, ISB & ACIT, Tiranë

2. Publikime shkencore dhe raporte

- **Agjencia e Statistikave të Kosovës,** Raporte të rregullta periodike
- **Banka Botrore,** Raporte të rregullta periodike
- **Beqirllari, B.** UET - (DIPLOMA.2003.doc, 10/12/2015)
- **Bogit, H** (2001) Politikanët dhe vlerësimi i performancës së orientuar drejt outputit në komuna., The European Accounting Review.
- **BQK** (2007-2016): Raporte të rregullta periodike

- **Complements or Substitutes**, Economic Letters 94, 155-162
- **CPSS/World Bank** - Raporte të rregullta periodike
- **Doracak** mbi zbatimin e tatimit në fitim ,Prishtinë 2001.
- **Doracaku mbi tatimin në të ardhurat e korporatave në Kosovë** , Prishtinë 2005.
- **Fondi Monetar Nderkombetar** (2013): Kosovo, Country Report No. 223, 2013
- **Fondi Monetar Nderkombetar** (2011): Kosova: Reform Proposals Towards a More Balanced and Revenue - Productive Tax System,” FAD Technical Assistance Report, 2011
- **IMF (2012): Republika e Kosovës: Financial System Stability Assessment**, IMF Country Report No. 13/99, April
- **Johansen, Soren** (1991): Estimation and Hypothesis Testing of Cointegration Vectors in Gaussian Vector Autoregressive Models a , Econometrica, 59, 1551–1580.
- **Korridori i remitancës Itali-Shqipëri**, 2006, Bari, Itali
- **Krasniqi, M.** (2016) UET – Tema e Doktorates.-M.K e komplet me format te ri.docx, 04/26/2016)
- **Ligji, Nr. 2004/48**, Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Prishtinë 2005.
- **Ligji, Nr.2004/48**, (2005) Për Administratën Tatimore dhe Procedurat,Prishtinë.
- **MDA** (2014): Vlerësim bazë i rajonit ekonomik jug, UNDP dhe Ministria për Punë të Jashtme e Finlandës, Prishtinë
- **MEF-i**, Pasqyrat financiare për vitin 2005-2016
- **Ministria e Ekonomis dhe Financave** ,Buxheti i vitit 2005-2016
- **Mustafa, I.** (2010): Konferenca e nëntë ndërkombëtare “Biznesi dhe punësimi”, Prishtinë
- **Nimani, A** (2014): After world global crisis, IJARR, Vol. 3, No. 1, 2014, ISSN 2309-0405
- **OBEZH, Zyra Statistikore e Komuniteteve Europiane** (Eurostat) (2005-2018)
- **Pasojat ekonomike të krizës në Kosovë** (1999) Vlerësim i përditësuar FMN / BB
- **Rregullorja 2004/51**, Mbi tatimin në të ardhurat e korporatave, Prishtinë 2004.
- **Rregullorja 2004/52**, Mbi tatimin në të ardhurat personale në Kosovë, Prishtinë 2004.
- **Rregullorja Nr.2000/29** „Mbi vendosjen e tatimit të paragjykuar” Prishtinë 2000.
- **Rregullorja Nr.2002/4**,Për tatimin në të ardhurat personale,Prishtinë.

- **Smajli, Remzi** - UET "Punimi final i Doktoratures 2015 UET.pdf, 03/17/201
- **Udhëzim Administrativ 02/2005**, Për zbatimin e tatimit në të ardhurat personale në Kosovë, Prishtinë 2005.
- **Udhëzim Administrativ 1/2003**, Mbi përcaktimin e vlerës së tregut të pronës, Prishtinë 2003.
- **Udhëzim Administrativ 3/2004**, Mbi detyrimin e pagesës së tatimit në pronë, Prishtinë 2004.
- **Udhëzim Administrativ Nr.3/2000**, Mbi zbatimin e tatimit të paragjykuar, Prishtinë 2000.
- **Udhëzime Administrative 2001-2017**, Për zbatimin e tatimit mbi vlerën e shtuar, Prishtinë.
- **UNDP** (2007-16)
- **United Nations Kosovo Team (UNKT)**: Njerëzit pas shifrave, 2012.
- **World Bank WB** (2010): Kosova-Rishikim i shpenzimeve publike, Raport Nr. 53709
- **World Economic Forum** (2009): Zhvillimi financiar dhe Reporte 2009.


ANEKSI 1:

ANALIZA E NDJESHMËRISË SË TË HYRAVE TATIMORE DHE E BORXHIT PUBLIK

1. Analiza e ndjeshmërisë së të hyrave tatimore

Duke u nisur nga fakti se ekonomia e Kosovës është e lloit kryesisht konsumuese (thith më shumë sesa prodhon), prandaj ajo është shumë e varur nga importet. Prandaj kjo strukturë e ekonomisë është reflektuar në strukturën e të ardhurave të buxhetit me të hyrat e inkasuara në kufi, të cilat përbëjnë afër 70% të të hyrave tatimore (shih grafikun poshte). Shumica e importeve kanë ndjekur një trend në rritje që prej pas periudhës së luftës duke ndjekur trendin e kërkesës agregate. Shikuar nga ana tjetër, ka i krijuar mundësi agjencie për të mbledhur më shumë të hyra në kufi dhe për ruajtur kështu një pjesëmarrje të lartë të të hyrave nga të kufirit deri tek ato tatimore.


Grafiku A 1: Struktura e të hyrave tatimore, 2006-2013



Duke pasur parasysh këtë tipar themelor të ekonomisë, është kryer një analizë për të vlerësuar efektin që ndryshimet në importe kanë ndaj totalit të të hyrave tatimore.

Analiza është kryer duke përdorur një VECM thjeshtë bi-variate dhe qëllimi i saj është të tregojë marrëdhëniet në mes të këtyre dy variablave dhe efektin e një shoku të importeve në të hyrat e buxhetit.

Grafiku A2: Seritë kohore të importeve dhe totali i të hyrave nga tatimet



Modeli është ndërtuar duke përdorur të dhëna mujore të importeve (Im_log) dhe librave të të hyrave tatimore (tr_log), të cilat duket që ndjekin një trend pozitiv determinist dhe kanë një komponent sezonal.

Varjacionet e para të variablave lekunden rreth një mesatare konstante dhe nuk ka variabilitet në kohë. Prandaj, Grafiku A 2 tregon se seritë në diferencat e para janë të krijuara nga një proces stacionar.


Për këtë arsye, analiza e co-integrimit e marrëdhënies afatgjatë të ekuilibrit mes variablave është testuar, duke përfshirë edhe trendin deterministik, „dummy“ sezonal dhe mesataren konstante.

Ashtu siç edhe pritej, rezultatet tregojnë se ka një marrëdhënie afatgjatë pozitive mes të hyrave tatimore dhe importeve. Për të vlerësuar efektin e tronditjes së importeve në të ardhurat tatimore, është bërë analiza „impulse response“.

Përgjigjet e impulsit raportohen me 95% intervale të besimit, e përlogaritur në mënyrë empirike me 10,000 përsëritje të vijave të grafikut të pulsit.

Ndikimi i një shoku është prezantuar në Grafikon A3 më poshtë, i cili tregon se një rënie prej 1% në importe do të ndikojë në të hyrat tatimore me rreth 0.2% në afat të mesëm.

Grafiku A3: „Impulse response” funksioni i një shoku në importe ndaj të hyrave tatimore



Burimi: Doktorantja

2. Analiza e qëndrueshmërisë së borxhit

Rreziku i shqetësimit për borxhin në Kosovë është ende i moderuar në sajë të raportit të ulët borxh / BPV dhe rregullës fiskale e miratuar kohëve të fundit, e cila është e detyrueshme ligjërish dhe kufizon deficitin në një nivel stabilizues të borxhit në afatin e gjatë. Megjithatë, rreziqet mund të lindin nga presionet e mundshme të shpenzimeve buxhetore që lidhen me nivel të ulët të vazhdueshëm të eksportit. DSA vlerëson borxhin mbi bazën e qëndrueshmërisë së rregullës fiskale duke krahasuar treguesit e borxhit dhe pragjet e barrës së borxhit nën skenarin bazë dhe ato alternative për periudhën 2012-2060. DSA e Kosovës është kryer duke përdorur Modelin DSA të zhvilluar nga MF. Analiza përdor tregues të rrezikut të hartuara nga Banka Botërore - FMN për vendet e mesmes (Politika e Bankës Botërore dhe Vlerësimi institucional (CPIA)). Duke filluar nga 2014, Qeveria e Kosovës miratoi një rregull fiskal, i cili kufizon deficitin e përgjithshëm ndaj BPV-së në 2%. Kjo kufizon aftësinë e Qeverisë për të siguruar shpenzime shtesë, duke zgjeruar ose politikat sociale ose projektet e infrastrukturës në kornizën ekzistuese buxhetore. Treguesit e borxhit dhe pragjet e barrës së borxhit të përpiluara nga BB-FMN-së dhe raporti i borxhit të kufizuar me ligj janë si më poshtë:

- Vlera e Tanishme Neto (VTN) e borxhit ndaj BPV – 40%
- VTN e borxhit ndaj eksporteve të mallrave dhe shërbimeve – 150%
- VTN e borxhit ndaj të hyrave buxhetore – 250%
- VTN e shlyerjes së borxhit ndaj eksporteve të mallrave dhe shërbimeve – 20%


- VTN e shlyerjes së borxhit ndaj të hyrave buxhetore – 30%

Parashikimet kryesorë bazë në skenarin e hulumtuar bazohen tek rritja e BPV-së nominale prej 5.5% mesatarisht për horizontin e projektuar, rritja prej 0.5 pikë përqindjeje në raportin e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve në BPV duke arritur në 27% në fund të periudhës së projeksionit, bilanci bankar i Qeverisë prej 2% të BPV-së dhe deficitin e përgjithshëm ndaj BPV në 2%. Përveç kësaj, meqenëse Kosova është ende në fazën e zhvillimit të saj ajo ende mund të ngrejë kreditë koncensionare apo ato të buta. Por, kur kjo e fundit të arrijë pragun më të lartë të të hyrave, raporti i kredive koncensionare do të bjerë në favor të më shumë kredive komerciale. Si rezultat, DSA supozon që duke filluar nga 2016 kreditë koncensionare do të përbëjnë 60% të borxhit të përgjithshëm publik dhe për huamarrjen e re do të ketë element të kufizuar granti.

Grafiku A4 tregon ndryshimet në përbërjen e deficitit dhe nevojën e financimit gjatë horizontit të parashikimit. Meqenëse se niveli aktual i borxhit është i ulët, shpenzimet e interesit përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të deficitit të përgjithshëm dhe, me rritjen e nivelit të borxhit, pagesat e interesit do të formojnë një pjesë të madhe të deficitit.

Deficiti i përgjithshëm përbën vetëm një pjesë të vogël të nevojës së financimit, ndërsa ripagimi i kryegjësë merr pjesën më të madhe të periudhës së projektuar.

Grafiku A 4: Përbërja e deficitit të përgjithshëm dhe nevoja për financim



Sipas skenarit bazë, të dy grupet e treguesve, përkatësisht aftësia paguese dhe treguesi i likuiditetit, janë nën nivelet e pragut (shih grafikun A5). Në skenarin bazë, raporti i borxhit me BPV-në stabilizohet menjëherë nën pragun e 40%, ndërsa borxhi ndaj eksporteve të mallrave dhe shërbimeve arrin pragun duke reflektuar bazën e ngushtë dhe të paqëndrueshme të eksporteve.


Skenari i Parë. Ky skenar është i ndërtuar mbi supozimin se rritja nominale e PBB-së do të jetë më e ulët me 1.5 pikë përqindjeje në krahasim me skenarin bazë. Në këtë skenar, VT e borxhit ndaj BPV-së është vazhdimisht në rritje dhe shkel pragun në 2048. Në mënyrë të ngjashme, për shkak të bazës ende të ulët të eksporteve, VT e borxhit të eksporteve shkel pragun në 2035 dhe shlyerja e borxhit ndaj eksporteve stabilizohet menjëherë nën pragun. Implikimi i politikës së këtij ushtrimi është që rritja nominale e BPV-së dhe nivelet e eksportit duhet të monitorohet vazhdimisht për të përshtatur politikatat drejt zhvillimit të sektorit privat dhe rritjes së eksportit dhe diversifikimit

Skenari i Dytë. Ky skenar simulon një situatë ku rregulla fiskale ligjrisht e detyrueshme është ndryshuar për të rritur kufizimin e deficitit në 3% të BPV-së duke filluar nga 2017. Si rezultat, aftësia paguese dhe treguesit e likuiditetit që kanë lidhje me eksportet shkelin pragun përgjithmonë.

Ky ndryshim do të rrisë raportin e borxhit ndaj BPV-së përtej pragut me një diferencë të madhe, duke sugjeruar se çdo rritje e deficitit ndaj BPV-së duhet të shoqërohet me rritjen e BPV-së dhe me rritje më të lartë dhe të qëndrueshme të eksportit).

Mirëpo, në të gjitha skenarët, raportet relative të të ardhurave mbeten nën pragun, duke sugjeruar përsëri se të ardhurat e buxhetit ose duhet të rriten në përqindje të BPV-së ose të mbeten konstante nëse këto ndryshime duhet të zhvilloheshin.

Grafiku A 5: Indikatorët e borxhit publik sipas skenarëve bazë dhe atyre alternativë



Burimi: MF. Perpunoj Doktorantja

ANEKSI 2

PYETSOR - ROLI DHE NDIKIMI I POLITIKAVE FISKALE TEK BIZNESET

Data _____

Qëllimi i këtij pyetëtori është të marrë informacion rreth “**Roli i politikave makrofikale në vendet në tranzicion dhe Kosova**”.

Për mua është shumë e rëndësishëm që ju të përgjigjeni sa më korrekte pasi që keto rezultate do i marr si baze për punën time të disertacionit në Universitetin Europian të Tiranës.

Ju jam shumë mirnjohës dhe falënderuar që edhe ju jeni pjesë e këtij punimi.

Pjesa A: Në këtë seksion synohet të merret informacion i përgjithshëm mbi kompaninë tuaj dhe aktivitetin e saj.

A1. Lokaliteti/Komuna:

A2. Emri i Biznesit

A3. Nr i punonjese:

A4. Jetëgjatësia e biznesit tuaj: _____

A5. Lloji i aktivitetit që ushtron biznesi juaj?

- a) Prodhuese b) Tregtare c) Shërbyese

A6. Çfare pozicioni menaxherial keni në biznesin tuaj?

1. Menaxher financiar
2. Menaxher i përgjithshëm
3. Zyrtar tjetër

A7. Shkalla e arsimimit tuaj (rretho)

- b) Shkolla e Mesme b) Bachelor c) Master d) Doktorate

A8. Xhiro vjetore e biznesit (nëse dëshironi)

_____ .00 €

Sqarim:

Pjesa A dhe B janë për Biznese, ndërsa C dhe D për institucione dhe qytetare

Pjesa B: Mbikqyrja e menaxhmentit**B1: Mendimi juaj mbi politikat fiskale** (shënoni me X në kuadratin përkatës)

Sa besoni që Republika e Kosova ka një menaxhimte drejte dhe zhvillimore të politikave fiskale?	Absolutish pajtohem(1)	Pajtohem (2)	Nuk e di (3)	Nuk pajtohem (4)	Pjeserisht pajtohem (5)
1. Po ka të mire					
1. Jo nuk ka					
2. Pjeserishte ka					
3. Mungon transparenca dhe llogaridhenja					

B2: A i shton vlerë biznesit tuaj mirëqeverisjes e kompanisë dhe hamonizimi i politikave fiskale?

A i shton vlerë biznesit tuaj mirëqeverisjes e kompanisë dhe hamonizimi i politikave fiskale?	Pajtohem plotësisht (1)	Pajtohem (2)	Neutral (3)	Nuk Pajtohem (4)	Nuk Pajtohem Plotësisht (5)
5. Biznesi duhet te kordinohet tersisht ne politiken fiskale					
6. Biznesi duhet te luftoje qe te krijon nje klim te pershtatshme dhe te ndikoj te Qeveria per harmonizim te politikave					
7. Biznesi të mireqeveriset dhe te jete i afte ti perbaslloj ndryshimet fiskale					

Pjesa C: Reformimi i Politikaver Fiskale**C1: A mendon i se jane te reformuar politikat fiskale ne Kosove**(shënoni me X në kuadratin përkatës)

A mendoni se politikat fiskale të Kosovës po reformohen sipas standardeve Evropiane?	Pajtohem plotësisht(1)	Pajtohem (2)	Neutral (3)	Nuk pajtohem (4)	Nuk Pajtohem plotësisht (5)
8. Duhet nje shtytje me e madhe					
9. Aspekti juridike dhe ai praktik nuk jane te harmonizuera					
10. Mbikqyrja financiuare shtetrorre nuk eshte e nivelit te duheur					
11. Informaliteti dhe keqadministrimi jane faktoret qe nuk kemi nje reformim te mirfillt					
12. Sa besoni se një menaxhim i mirë i resurseve njerëzore, politikave fiskale ndikon në zhvillimin ekonomik					

C2: Sa besoni se një menaxhim i mirë i resurseve njerëzore, politikave fiskale ndikon në zhvillimin ekonomik (shënoni me X në kuadratin përkatës)

A mendoni se menaxhim i mirë i politikave fiskale ndikon në zhvillimin ekonomik?	Pajtohem plotësisht (1)	Pajtohem (2)	Neutrale (3)	Nuk pajtohem (4)	Nuk pajtohem plotësisht (5)
13. MF dhe MRNJ është i domosdoshëm për një sukses të tillë					
14. Menaxherët të jenë më të kujdesshëm në përgjegjësi të stafit					
15. Institucionet publike dhe private të kenë një harmonizim të politikave që lidhen me PF dhe mirëadministrimin e tyre					
16. Anëtarët e bordit kundër anëtarëve të bordit					

C3: Pengesa e reformimit dhe harmonizimit të Politikave makro-fiskale në Kosovë me BE-në (shënoni me X në kuadratin përkatës)

A mendoni se paragrafët e mëposhtëm flasin për tre pengesa tipike në harmonizimin e PF me vendet e BE-së?	Pajtohem plotësisht (1)	Pajtohem (2)	Neutrale (3)	Nuk pajtohem (4)	Nuk pajtohem plotësisht (5)
17. Pengesat politike					
18. Pengesat e organizimit					
19. Pengesat psikologjike					
20. Pengesat nderetnike					

Pjesa D Roli pozitiv apo negativ misionet e BE-së në Kosovë

D1: A kanë luajtur pozitiv apo negativ misionet e Bashkimit Europian në Kosovë në menaxhimin dhe hartimin të politikave efektive fiskale?

Sa kanë luajtur dhe po luajnë rol misionet e BE-së në Kosovë në ofrimin e ndihmës së menaxhimit të politikave fiskale	Pajtohem plotësisht (1)	Pajtohem (2)	Neutrale (3)	Nuk pajtohem (4)	Nuk pajtohem plotësisht (5)
25. Po BE ka pasur rol vendimtar					
26. Ndonjëherë ka ndikuar por me shumë duke mbrojtur interesat e veta					
27. BE e ka demtuar harmonizimin e PF dhe ka pasur impakt negativ në Kosovë					
28. BE dhe misionet e sajë ishin vendimtare në hartimin e PF dhe gjithë sistemit financiar në vend					

